



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe



Liria e Shprehjes dhe Marrëdhënia e saj me të Drejtën për Respektimin e Jetës Private dhe të Drejtën për një Proces të Rregullt

GUIDË MBI JURISPRUDENCËN E
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT

Për gjyqtarë, ligjvënës dhe profesionistë të së drejtës

**Liria e Shprehjes dhe
Marrëdhënia e saj me të
Drejtën për Respektimin e
Jetës Private dhe të Drejtën për
një Proces të Rregullt**

**GUIDË MBI JURISPRUDENCËN E
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT**

Për gjyqtarë, ligjvënës dhe profesionistë të së drejtës

Editor

Biljana Braithwaite

Menaxhere Programi për Ballkanin Perëndimor, AIRE Centre

Catharina Harby

Konsulente Ligjore e Lartë, AIRE Centre

Goran Miletic

Drejtor Programi për Ballkanin Perëndimor, Civil Rights Defenders

Kontribues Kryesorë

Sarah Maguire

Studiuese ligji, AIRE Centre

Ishaani Shrivastava

Avokate e Lartë Devereux Chambers, Londër

Falenderime të veçanta për:

Ana Vilfan Vospernik

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

James Reynolds

ISLP-UK

Përgatiti në shqip: Ina Xhepa, Qendra Evropiane

Përgatitur nga AIRE Centre

© 2017 AIRE Centre

Dizajni Kliker Dizajn

Shtyp Dual Mode

Printuar 300

Forum i Katërt mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore - që synon nxitjen e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe procesin e integritimit në BE - do të fokusohet në çështjen shumë të rëndësishme të lirisë së shprehjes.

E drejta e lirisë së shprehjes, “përbën një nga themelet bazë të një shoqërie [demokratike]¹. Ajo është çelësi për zhvillimin, dinjitetin dhe përmbushjen e individëve, është një komponent thelbësor i një vendi, që vlerëson shtetin e së drejtës dhe themeli i një shoqërie të hapur dhe gjithpërfshirëse. Kjo e drejtë njihet edhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Vlera e kësaj të drejte shprehet qartë edhe nga interpretimi i gjerë i nenit 10, i bërë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat të Njeriut. Si rezultat i kësaj, e drejta e një personi për lirinë e shprehjes ka të ngjarë të ndikojë në gëzimin e të drejtave të Konventës për persona të tjerë dhe për këtë arsye, neni 10 nuk është një e drejtë absolute. Në rastet e ndërveprimit mes të drejtave të Konventës, nevojtet një ekuilibrim mes tyre. Kjo situatë ndodh shpesh në kontekstin e nenit 6 “e drejta për një proces të rregullt” dhe nenit 8 “e drejta për respektimin e jetës private”.

Rëndësia themelore e nenit 10, por edhe marrëdhëniet dhe ndërveprimi shpesh i diskutueshëm i tij me të drejta të tjera është arsyeja, përse kemi zgjedhur këtë temë për Forumin e këtij viti. Ne do të shqyrtojmë se si e drejta e lirisë së shprehjes, mund të ushtrohet nga anëtarët e gjyqësorit dhe profesionistët e ligjit.


Përmes analizimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përmbledhjes së një sërë vendimesh të rëndësishme, ne shpresojmë se ky publikim, së bashku me materialet e tjera të Forumit, do të ndihmojnë në një kuptim më të mirë të marrëdhënies ndërmjet të drejtës së lirisë së shprehjes me të drejtën për respektimin e jetës private dhe të drejtën për një proces të rregullt.

Ne kemi dëshirë, që të gjithë pjesëmarrësit në përmbyllje të Forumit, pasi të jenë pajisur me materialet e përgatitura për këtë qëllim, të kenë marrë pjesë aktivisht në diskutime dhe të jenë aftësuar më tepër në hulumtimin e jurisprudencës së Gjykatës së Strasbugurt, për të kapërcyer sfidat me të cilat ballafaqohet aktualisht zbatimi i Konventës në rajon.

1 *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 5493/72, vendim i 7 dhejtorit 1976, paragrafi 49.

Ne ju urojmë të gjithëve diskutime dhe Forum të suksesshëm.

Biljana Braithwaite



AIRE Centre

Goran Miletić



Civil Rights Defenders

Tiranë, Mars 2017

Një Guidë mbi Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	9
[I] <u>Neni 10: Vështrim i Përgjithshëm</u>	9
(a) Neni 10 KEDNJ	9
(b) Qëllimi i Nenit 10	9
(c) Fusha e Veprimit të Nenit 10.....	10
(d) Kualifikimi Ligjor i të Drejtës.....	11
(i) ‘E parashikuar me ligj’	12
(ii) Qëllimet legjitime të parashikuara në nenin 10(2).....	13
(iii) ‘E domosdoshme në një shoqëri demokratike’ (proporcionale me qëllimin e ndjekur)	13
(e) Përgjegjësia e Shtetit në Kuadër të Nenit 10 dhe të Konventës.....	15
(f) Diskurset e Pambrojtura: Gjuha e Urrejtjes.....	16
[II] <u>Liria e shprehjes dhe Media</u>	18
(a) Mbrojtja e Garantuar për Mediat në Kuadër të Nenit 10	18
(b) Detyrat dhe Përgjegjësitë e Medias	19
(c) Faktorë të Rëndësishëm në Ekuilibrimin e të Drejtave Konkuruese	19
(i) Kontributi në një Debat me Interes Publik	20
(ii) Një Figurë Publike apo Private?	21
(iii) Forma, Përmbajtja dhe Pasojat e Publikimit	21
(iv) Rrethanat në të Cilat janë bërë Fotografitë	22
(d) Dy Tipologji Çështjesh.....	22
(e) Natyra e Sanksioneve	24
[III] <u>Neni 10 dhe Neni 8: Ekuilibrimi i të Drejtës për Jetë Private me të Drejtën e Lirisë së Shprehjes</u>	25
(a) Neni 8 KEDNJ.....	25
(b) Qëllimi i Nenit 8	26
(c) Fusha e Veprimit e “jetës private”	26
(d) Kualifikimi Ligjor i të Drejtës.....	27
(e) Ndërveprimi me Nenin 10	28
[IV] <u>Neni 10 dhe Neni 6: Ndërveprimi i Lirisë së Shprehjes me të Drejtën për një Proces të Rregullt në kuadër të Konventës</u>	29
(a) Neni 6 KEDNJ	30
(b) Ekuilibrimi i Dy të Drejtave	30
(c) Ankimet në kuadër të Nenit 10 në Lidhje me Proceset Gjyqësore	32
(d) Ankimet në kuadër të Nenit 6 në Lidhje me Lirinë e Shprehjes	35

[V] <u>Liria e shprehjes dhe Profesionet e Ligjit</u>	36
(a) Kufijtë e Kritikës ndaj Gjyqësorit: “Garantimi i autoritetit dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor”	37
(b) Liria e Shprehjes së Gjyqësorit dhe Avokatët	38
[VI] <u>Përfundime: Liria e Shprehjes në Evropë</u>	
- <u>Përsa është në Rend të Ditës?</u>	40

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Përmbledhje Vendimesh..... 42

Liria e Shprehjes dhe Interneti

Delfi AS k. Estonisë,

Kërkesa nr. 64569/09, 16 qershor 2015 42

Ahmet Yildirim k. Turqisë,

Kërkesa nr. 3111/10, 18 dhjetor 2012 45

Gjuha e Urrejtjes

Vejdeland dhe Të Tjerët k. Suedisë,

Kërkesa nr. 1813/07, 9 shkurt 2012 48

Fatullayev k. Azerbaxhanit,

Kërkesa nr. 40984/07, 22 prill 2010 50

Feret k. Belgjikës,

Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009..... 54

Bodrožić k. Serbisë,

Kërkesa nr. 32550/05, 23 qershor 2009 56

Neni 10 dhe Neni 8 E drejta për një Jetë të Qetë Private

Satakunnan Markkinaporssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës,

Kërkesa nr. 931/13, 21 korrik 2015 59

Axel Springer k. Gjermanisë dhe Von Hannover k. Gjermanisë,

Kërkesat nr. 39954/08, 40660/08 dhe 60641/08, 7 shkurt 2012 62

Couderc & Hachette Filipacchi Associés k. Francës,

Kërkesa nr. 40454/07, 10 nëntor 2015 66

Mbulimi Negativ Mediatik, Prezumimi i Pafajësisë & Ndërhyrja e Autoriteteve në Lirinë e Raportimit të Medias

Bédat k. Zvicrës,

Kërkesa nr. 56925/08, 29 mars 2016 69

Khuzhin dhe Të Tjerët k. Ruisë,

Kërkesa nr. 13470/02, 23 tetor 2008 73

Touranbeau dhe July k. Francës,

Kërkesa nr. 53886/00, 24 nëntor 2005 76

<i>Craxi k. Italisë (no.2),</i> Kërkesa nr. 34896/97, 5 dhjetor 2002	79
<i>Du Roy dhe Malaurie k. Francës,</i> Kërkesa nr. 34000/96, 3 tetor 2000	82
<i>News Verlags GmbH & Co.KG k. Austrisë,</i> Kërkesa nr. 31457/96, 11 janar 2000	84
<i>Worm k. Austrisë,</i> Kërkesa nr. 22714/93, 29 gusht 1997	86

Liria e Shprehjes dhe Profesionet e Ligjit

<i>Baka k. Hungarisë,</i> Kërkesa nr. 20261/12, 23 qershor 2016	90
<i>Radobuljac k. Kroacisë,</i> Kërkesa nr. 51000/11, 28 qershor 2016	94
<i>Kyprianou k. Qipros,</i> Kërkesa nr. 73797/01, 15 dhjetor 2005	97
<i>Salov k. Ukrainës,</i> Kërkesa nr. 65518/01, 6 shtator 2005	101
<i>Amihalachioaie k. Moldavisë,</i> Kërkesa nr. 60115/00, 20 prill 2004	104
<i>Steur k. Holandës,</i> Kërkesa nr. 39657/98, 28 tetor 2003	106
<i>Nikula k. Finlandës,</i> Kërkesa nr. 31611/96, 21 mars 2002	108
<i>Morice k. Francës,</i> Kërkesa nr. 29369/10, 23 prill 2015	112
<i>Fuchs k. Gjermanisë,</i> Kërkesat nr. 29222/11 & 64345/11, 27 janar 2015	118
<i>Mustafa Erdogan dhe Të Tjerët k. Turqisë,</i> Kërkesa nr. 346/04 dhe 39779/04, 27 maj 2014.....	121
<i>Harabin k. Slovakiomor,</i> Kërkesa nr. 58688/11, 20 nëntor 2012	124
<i>Hrico k. Sllovakisë,</i> Kërkesa nr. 49418/99, 20 korrik 2004	128
<i>Barfod k Danimarkës,</i> Kërkesa nr. 11508/85, 22 shkurt 1989	131
<i>Prager dhe Oberschlick k. Austrisë,</i> Kërkesa nr. 15974/90, 26 prill 1995	134
<i>De Haes dhe Gijssels k. Belgjikës,</i> Kërkesa nr. 19983/92, 24 shkurt 1997	137
<i>Peruzzi k. Italisë,</i> Kërkesa nr. 39294/09, 30 qershor 2015	141

Çështje të tjera mbi nenin 10

<i>Youth Initiative for Human Rights k. Serbisë,</i> Kërkesa nr. 48135/06, 25 qershor 2013	144
<i>Koprivica k. Malit të Zi,</i> Kërkesa nr. 41158/09, 22 nëntor 2011	146
<i>Šabanović k. Malit të Zi,</i> Kërkesa nr.5995/06, 31 maj 2011	149
<i>Lepojić k. Serbisë,</i> Kërkesa nr. 13909/05, 6 nëntor 2007	151
<i>Perinçek k. Zvicrës,</i> Kërkesa nr. 27510/08, 15 tetor 2015	154
<i>Pentikwinen k. Finlandës,</i> Kërkesa nr. 11882/10, 20 tetor 2015.	158
<i>Selmani dhe Të Tjerët k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë,</i> Kërkesa nr. 67259/14, 9 shkurt 2017	161

Një Guidë në Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

[I] Neni 10: Vështrim i Përgjithshëm

(a) Neni 10 KEDNJ

Neni 10 i Konventës parashikon:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të 12 13 drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

(b) Qëllimi i Nenit 10

Neni 10 i shërben një sërë qëllimesh. Mbrojtja e lirisë së shprehjes është konsideruar se nxit të mirën sociale dhe individuale, si edhe është parakusht i një sistemi efektiv demokratik. Gjykata ka shprehur se:

‘Liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike, një nga kushtet bazë për zhvillimin e saj dhe vetëpërmeshjen e çdo individi’²

Në thelb, neni 10 është i lidhur me realizimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi. Pa lirinë e shprehjes, shkeljet e të drejtave të njeriut mund të neglizhohen dhe abuzimet e Shtetit do të kalonin pa u kontrolluar. Për rrjedhojë, do kishte një mungesë llogaridhënieje universale. Për më tepër, kjo e drejtë ka shërbyer si

² Ahmed k Mbretërisë së Bashkuar, Ap. Nr. 22954/93, vendim i 2 shtatorit 1998, paragrafi 55.

mjet lehtësues në shkëmbimin e informacionit kulturor, politik dhe social³. Liria e shprehjes promovon dije, mirëkuptim dhe tolerancë në shoqëritë kulturalisht të ndryshme si ato të Evropës.

(c) Fusha e Veprimit të Neni 10

Autoritetet kombëtare duhet të jetë të vetëdijshme për fushën të gjerë të zbatimit të konceptit të lirisë së shprehjes. Neni 10 garanton lirinë e shprehjes për “të gjithë”, duke përfshirë këtu si individët ashtu edhe kompanitë⁴, madje edhe kur këto të fundit ushtrojnë veprimtari fitimprurëse⁵. Gjithashtu, ky nen garanton lirinë e shprehjes për një shumëllojshmëri të gjerë informacionesh ose idesh, për shembull në fushën politike, tregtare⁶, madje edhe në atë të argëtimit⁷.

Një shembull tjetër është shprehja përmes artit për të cilën Gjykata ka vërejtur:

“Ata që krijojnë, kryejnë, shpërndajnë ose ekspozojnë veprat e tyre të artit, kontribuojnë në shkëmbimin e ideve dhe mendimeve, elemente thelbësore këto për një shoqëri demokratike. Prandaj shteti ka detyrim, që të mos shkel padrejtësisht lirinë e tyre të shprehjes⁸.”

Siç mund të pritet, neni 10 mbron por nuk kufizohet vetëm në shprehjen e deklaratave të vërteta të fakteve, (edhe pse e vëretësia e deklaratës do të mbajë një peshë të caktuar gjatë vlerësimit), por përfshin shprehjen e mendimeve të tilla si kritikën dhe gjykimet mbi vlerat⁹. Ky nen nuk kufizohet as në përmbajtje, që janë trajtuar si të favorshme, të padëmshme apo si çështje indiferente. Gjithashtu, përfshin informacione dhe ide që fyejnë, trondisin ose shqetësojnë¹⁰. Këto informacione dhe ide mbrohen, mbi bazë të parimit se një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistojë pa një pluralizëm, tolerancë dhe largpamësi të caktuar. Gjykata ka bërë një interpretim të zgjeruar për qëllimin e lirisë së shprehjes me qëllim që të mbrojë këto vlera.

3 Müller dhe Të Tjerët k Zvicrës, Ap. Nr. 10737/84, vendim i 24 majit 1988, paragrafi 27.

4 Ahmed Yildirim k Turqisë, Ap. Nr. 31111/10, vendim i 18 dhjetorit 2012, paragrafi 50.

5 Casado Coca k Spanjës, Ap. Nr. 15450/89, vendim i 24 shkurtit 1994, paragrafi 35.

6 Markt Intern Verlag GmbH & Klaus Beermann k Gjermanisë, Ap. Nr. 10572/83, vendim i 20 nëntorit 1989, para 26.

7 Groppera Radio AG k Zvicrës, Ap. Nr. 10890/84, vendim i 28 marsit 1990, paragrafi 55.

8 Vereinigung Bildender Künstler k Austrisë, Ap. Nr. 68354/01, vendim i 25 janarit 2007, paragrafi 26.

9 Lingens k Austrisë, Ap. Nr. 9815/82, vendim i 8 korrikut 1986.

10 Ahmed k Mbretërisë së Bashkuar, Ap. Nr. 22954/93, vendim i 2 shtatorit 1998, paragrafi 55; Megjithatë, deklaratat që janë thjesht revizioniste duhet të përjashtohen nga mbrojtja e neni 10 në zbatim të neni 17 KEDNJ (shih Chauvy k Francës, Ap. Nr. 64915/01, vendim i 29 qershorit 2004, paragrafi 69).

Gjithashtu, neni 10 siguron mbrojtje në lidhje me një gamë shumë të gjerë të mjeteve të shpërndarjes së informacionit dhe ideve. Kjo mbrojtje shtrihet edhe në mediat kryesore, të tilla si televizioni¹¹, gazetat¹², si dhe shumë mjete të tjera të shprehjes të tilla si veshje¹³, muzikë¹⁴, ose mbishkrime¹⁵. Neni 10 i Konventës mbron informacione dhe ide postuar në faqet e internetit, rëndësia e së cilave është theksuar nga Gjykata në vitet e fundit në kuadër të ushtrimit të lirisë së shprehjes¹⁶. Çdo kufizim i vendosur mbi mjetet e shpërndarjes së informacionit ose ideve përbën një ndërhyrje në të drejtën për të shkëmbyer informacion¹⁷.

Neni 10 garanton të drejtën për të marrë informacione, që të tjerët janë të gatshëm për të dhënë¹⁸, por në disa raste të veçanta edhe të drejtën për të marrë informacione që janë në interes të publikut¹⁹, si dhe mbron lirinë e mendimit. Megjithatë, për shkak se liria e ndërgjegjes mbrohet pa kufizim sipas nenit 9, lirisë së mendimit i është kushtuar vëmendje të kufizuar. Jurisprudenca e Gjykatës ka tendencë të përqëndrohet në shprehjen e opinionëve të dhëna.

(d) Kualifikimi Ligjor i së Drejtës

E drejta e lirisë së shprehjes në bazë të nenit 10, së bashku me nenet 8, 9 dhe 11 të Konventës kualifikohet më tepër se një e drejtë absolute sipas Konventës. Kjo do të thotë se ajo është subjekt i një numri përjashtimesh, të cilat janë shpjeguar më poshtë. Gjykata ka vërejtur se këto përjashtime duhet të interpretohen ngushtësht dhe nevoja për ndonjë përjashtim duhet të jetë bindëse²⁰.

Gjyqtarët e gjykatave vendase duhet të jetë të vetëdijshëm për këtë qasje të Gjykatës në lidhje me çështjet mbi nenin 10.

Gjykata ka tendencë t'i qaset nenit 10 duke iu referuar pesë çështjeve të mëposhtme:

11 *Autronic AG k Zvicrës*, Ap. Nr. 12726/87, vendim i 22 majit 1990, paragrafi 47.

12 *Goodwin k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 17488/90, Dhomë e Madhe vendim i 27 marsit 1996, paragrafi 28.

13 *Stevens k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 11674/85, Vendim i Komisionit i 3 marsit 1986.

14 *H and K k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 10317/83, Vendim i Komisionit i 6 tetorit 1983.

15 *N k Zvicrës*, Ap. Nr. 9870/82, Vendim i Komisionit i 13 tetorit 1983.

16 *Ahmet Yildirim k Turqisë*, Ap. Nr. 3111/10, vendim i 18 dhjetorit 2012, paragrafi 48.

17 *Ahmet Yildirim k Turqisë*, Ap. Nr. 3111/10, vendim i 18 dhjetorit 2012, paragrafi 50; *Youth Initiative for Human Rights k Serbisë*, Ap. Nr. 48135/06, vendim i 25 qershorit 2013.

18 E.g. *Mustafa k Suedisë*, Ap. Nr. 23883/06, vendim i 6 dhjetorit 2008, paragrafi 32.

19 *Youth Initiative for Human Rights k Serbisë*, Ap. Nr. 48135/06, vendim i 25 qershorit 2013.

20 *Ahmed dhe Të Tjerët k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 22954/93, vendim i 2 shtatorit 1998, paragrafi 55.

1. A përfshijnë faktet llojin e shprehjeve mbrojtur nga nenin 10²¹?
2. A ka pasur, ose është vendosur ndërhyrje në këtë të drejtë? Kjo mund të përfshijë kufizime të mëparshme (p.sh. censurë), ndërhyrjeve të vazhdueshme dhe sanksione pas shprehjes së tij/saj?
3. A është ndërhyrja “e parashikuar me ligj”?
4. A ndjek ndërhyrja një qëllim legjitim?
5. A është ajo “e nevojshme në një shoqëri demokratike”?

Nëse përgjigjia për dy pyetjet e para është “po”, kjo do të thotë se ka pasur një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një personi brenda fushëveprimit të nenit 10. Gjykata ka zhvendosur barrën e provës për shtetin, i cili duhet të tregojë se ndërhyrja ishte e justifikuar në përputhje me nenin 10 (2). Tre pyetjet e fundit, kanë të bëjnë me faktin nëse kjo ndërhyrje është e justifikuar. Nëse përgjigjia për ndonjërin nga këto tri pyetje është “jo”, kjo do të derivojë shkelje të nenit 10. Në anën tjetër, nëse përgjigjia për të gjitha pyetjet është “po”, kjo do të thotë se ndërhyrja do të jetë e justifikuar dhe neni 10 nuk është shkelur. Tri kushtet justifikuese për një ndërhyrje në lirinë e shprehjes janë shpjeguar shkurtimisht më poshtë.

(i) “E parashikuar me ligj”

Një ndërhyrje në lirinë e shprehjes nuk mund të jetë e justifikuar në bazë të nenit 10, përveç rasteve kur ajo është “e parashikuar me ligj”. Kjo do të thotë se çdo ndërhyrje në të drejtat e garantuara nga neni 10, duhet të bazohet në legjislacionin e brendshëm. Gjykata ka vërejtur se në temrin “ligj” duhet të përfshijë si ligjin i shkruar ashtu edhe jurisprudencën. Kështu, për shembull, një ndërhyrje në lirinë e shprehjes, që rezulton nga zbatimi duhur i ligjit të brendshëm të shpifjes do të kishte *prima facie* një bazë të tillë. Në qoftë se një ndërhyrje nuk bazohet në legjislacionin e brendshëm ajo do të derivojë automatikisht një shkelje të nenit 10 të Konventës²².

Shprehja “e parashikuar me ligj” përfshin dhe dy elementë të tjerë. Së pari, ligji duhet të jetë i aksesueshëm nga qytetari p.sh. qytetari duhet të këtë mundësi informimi për rregullat ligjore në fuqi për një çështje të caktuar²³. Për më tepër, ligji duhet të formulohet në mënyrë të tillë, që qytetari të mund të përshtasë sjelljen e tij në përputhje me rrethanat. Pra, të parashikojë brenda një shkalle të arsyeshme pasojat, që mund të derivojë një veprim i caktuar²⁴.

21 Shih më poshtë në lidhje me gjuhën e urrejtjes.

22 E.g. *Gsell k Zvicrës*, Ap. Nr. 12675/05, vendim i 8 tetorit 2009.

23 *Sunday Times k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 6538/74, 26 prill 1979.

24 *Malone k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 8691/79, 2 gushtit 1984.

Kjo kërkesë është përmendur shpesh si “cilësia e ligjit”²⁵. Një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një individi, që është ndërmarrë në kuadër të një ligji, i cili nuk ka akses ose saktësi të mjaftueshme, nuk do të cilësohet “e parashikuar me ligj”. Për rrjedhojë, kjo ndërhyrje nuk justifikohet në bazë të nenit 10. Në përbushje të detyrimeve të Konventës, për shtetin është thelbësore, që legjislacioni i brendshëm të jetë koherent dhe i aksesueshëm.

(ii) *“Qëllimet legjitime të parashikuara në nenin 10 (2)”*

Në mënyrë që një ndërhyrje në të drejtat e garantuara në nenin 10 (1), të justifikohet, duhet të ndjekë një nga qëllimet legjitime²⁶, të renditura në mënyrë shteruese në nenin 10 (2).

Qëllimet legjitime të renditura në nenin 10 (2) janë:

- Interesi i sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike;
- Mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit;
- Mbrojtja e shëndetit ose e moralit;
- Mbrojtja e dinjitetit ose e të drejtave të tjerëve;
- Ndalimi i përhapjes së të dhënave konfidenciale;
- Garantimi i autoritetit dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor.

(iii) *“E nevojshme në një shoqëri demokratike” (në proporcionalitet me qëllimin e ndjekur)*

Në përfundim, me qëllim që të jetë e justifikuar, çdo ndërhyrje në lirinë e shprehjes duhet të jetë “e nevojshme në një shoqëri demokratike. Shpesh kjo është çështja kryesore në rastet e lirisë së shprehjes.

Një ndërhyrje në nenin 10, për të qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, duhet të adresojë një “nevojë të ngutshme sociale” dhe të jetë në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur. Kjo do të thotë se çdo kufizim në lirinë e shprehjes së një personi duhet të reflektojë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese individuale dhe të përgjithshme. Thënë ndryshe, autoritetet kombëtare duhet të përdorin metodën, që kufizon më pak lirinë e shprehjes.

Për të përcaktuar nëse një ndërhyrje është proporcionale Gjykata mund të marrë parasysh një sërë faktorësh. Në varësi të qëllimeve legjitime të përcaktuara në

25 *Karademirci k Turqisë*, Ap. Nrs. 37096/97 and 37101/97, vendim i 25 janarit 2005, paragrafi 33.

26 Duhet të theksohet se synimet e legjitimuara që justifikojnë ndërhyrje në kontekstin e të drejtave të tjera ndryshojnë pak me ato të nenit 10.

nenin 10 (2) do të zbatohen konsiderata të ndryshme. Për shembull, Gjykata do të lejojë një hapësirë më të gjerë (por jo të pakufizuar) vlerësimi për ndërhyrje, të cilat kanë qëllimin legjitim mbrojtjen e moralit²⁷. Zbatimi i nenit 10 në kuadër të rasteve që përfshijnë lirinë e shprehjes në fushën e gazetarisë dhe të mediave janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar më poshtë.

Në vështrim të përgjithshëm, Shtetet Kontraktuese kanë liri për të përcaktuar nëse një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një personi është e nevojshme në një shoqëri demokratike. Zakonisht, kjo referohet si hapësirë vlerësimi. Autoritetet vendase janë njohur gjithmonë nga organet e Konventës, se gjenden në një pozitë më të favorshme për të marrë një vendim, në interpretim të ligjit vendas, apo për të vlerësuar faktet në një çështje të caktuar. Gjykata ka theksuar se nuk duhet të nxiton për të zëvendësuar pikëpamjet e saj me ato të autoriteteve vendase. Ky qëndrim është i lidhur me parimin e subsidiaritetit Konventës, ku Gjykata e sheh veten kryesisht si një organ mbikëqyrës, që është subsidiar për sistemet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Ky qëndrim, ose hapësirë vlerësimi, luan një rol të rëndësishëm për çështjet në të cilat kemi *prima facie* ka një shkelje të së drejtës dhe argumenteve, që e justifikojnë ndërhyrjen si të nevojshme. Ndaj, ajo është shumë e rëndësishme për çështjet e nenit 10.

Zgjerimi i kësaj hapësire vlerësimi varjon nga lloji i shprehjes në të cilën ka pasur një ndërhyrje. Për shembull, hapësira e vlerësimit të shtetit në lidhje me diskutet politike është kryesisht e ngushtë krahasuar me këtë hapësirë në lidhje me diskutet tregtare apo artistike²⁸.

Autoritetet kombëtare duhet të jenë të vetëdijshëm se hapësira e vlerësimit shkon në të njëjtën linjë me mbikëqyrjen evropiane, duke përfshirë si ligjin dhe vendimet e bazuara në të, madje edhe ato të dhëna nga gjykatat e pavarura. Prandaj, Gjykata është e autorizuar për të dhënë vendimin përfundimtar nëse një “ku-fizim” është në përputhje me lirinë e shprehjes mbrojtur nga neni 10²⁹.

Një implikim tjetër i hapësirës së vlerësimit dhe subsidiaritetit është ndikimi, që kanë gjyqtarët vendas. Gjykata dhe Konventa nënvizojnë rëndësinë e respektimit të vlerësimit të autoriteteve kombëtare në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes nga ana e shtetit në të drejtë. Në qoftë se mund të provohet se ky vlerësim është bërë në përputhje me Konventën, Gjykata do të ngurronjë për të gjetur një

27 *Otto-Preminger-Institut k Austrisë*, Ap. Nr. 13487/87, vendim i 20 shtatorit 1994, paragrafi 50.

28 *Vgt Verein Gegen Tierfabriken k Zvicrës*, Ap. Nr. 24699/94, vendim i 28 qershorit 2001, paragrafet 69-71.

29 *Ahmed k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 22954/93, vendim i 2 shtatorit 1998, paragrafi 55.

shkelje të Konventës vetëm për shkak se ajo beson se mund të kishte arritur në një përfundim të ndryshëm. Pra, përgjegjësia për respektimin e Konventës lihet në duart e autoriteteve kombëtare, në veçanti të gjyqtarëve vendas.

(e) Përgjegjësia e Shtetit në kuadër të Nenit 10 dhe të Konventës në tërësi

Megjithëse, Gjykata ka vërejtur se qëllimi thelbësor i shumë prej dispozitave të Konventës është të mbrojnë individin nga ndërhyrja arbitrare e autoriteve publike, shumë prej të drejtave të mbrojtura nga Konventa mund të sjellin detyrime pozitive për shtetin³⁰. Kjo ide rrjedh nga neni 1 i Konventës që parashikon se “[P] alët e Larta Kontraktuese i *sigurojnë* çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente”. Kështu, për ushtrimin efektiv të liritë të caktuara do të kërkohej *njëherazi*, që shtetet të mos ndërmarrin asnjë veprim i cili në mënyrë disproporcionale ndërhyr me të drejtat e Konventës, por miratimi i masave mbrojtëse pozitive edhe në lidhje me marrëdhëniet mes individëve³¹. Ndër të tjera, ky fakt është i zbatueshëm për nenin 10, nenin 8 dhe nenin 2 të Konventës.

Për të përcaktuar nëse ekziston apo jo një detyrim pozitiv, duhet pasur në vëmendje ekuilibri i drejtë që duhet të arrihet ndërmjet interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe interesit të individit³². Ky është një test i ngjashëm me atë të detyrimeve negative të vendosura në llogari të shtetit. Gjithashtu, Gjykata do të marrë në konsideratë situatat e ndryshme në Shtetet Kontraktuese. Gjykata e ka bërë të qartë se detyrimet në kuadër të këtyre neneve, nuk do të interpretohen në mënyrë të tillë, që të imponojnë mbi autoritetet një barrë prove të pamundur apo joproportionale³³.

Gjykata ka theksuar se neni 10, duke pasur një rol kyç në funksionimin e demokracisë, do të kërkojë nga shteti më shumë se mos ndërhyrje, ndërmarrjen e disa masave mbrojtëse pozitive. Për shembull, dështimi për të mbrojtur një gazetë ndaj sulmeve ka rezultuar në shkelje të nenit 10³⁴, detyrimi i shteteve për të krijuar një mjedis të favorshëm për pjesëmarrje në debatin publik nga të gjithë personat e interesuar, duke u lejuar atyre që të shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa frikë³⁵. Gjykata ka pranuar se një detyrim pozitiv për të mbrojtur të drejtën e lirisë së

30 *Ozgur Gundem k Turqisë*, Ap. Nr. 23144/93, vendim i 16 marsit 2000, paragrafi 42.

31 *Palomo Sánchez dhe Të Tjerët k. Spanjës*, Ap. Nos. 28955/06, 28957/06, 28959/06 dhe 28964/06, Dhomë e Madhe vendim i 12 shtatorit 2011, paragrafët 58-59.

32 *Ozgur Gundem k Turqisë*, Ap. Nr. 23144/93, vendim i 16 marsit 2000, paragrafi 43.

33 *Rees k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 9532/81, vendim i 17 tetorit 1986, paragrafi 37.

34 *Ozgur Gundem k Turqisë*, Ap. Nr. 23144/93, vendim i 16 marsit 2000.

35 *Dink k Turqisë*, Ap. Nrs. 2668/07, 6102/08, 30079/08, 7072/09 dhe 7124/09, vendim i 14 shtatorit 2010.

shprehjes ekziston edhe duke siguruar një mundësi të arsyeshme për të ushtruar të drejtën e përgjigjes³⁶.

Në kuadër të fokusit të kësaj guide në lidhje me ndërveprimin mes nenit 10, me nenin 6 dhe nenin 8 të Konventës, është e rëndësishme të theksohet se natyra e detyrimeve pozitive të një shteti sipas nenit 10 mund të ndryshojë kur Gjykatës do t' i duhet të ekuilibrojë të drejtën e lirisë e shprehjes me të drejta të tjera të Konventës³⁷. Ky ndërveprim do të shqyrtohet në mënyrë të hollësishme në seksionet e mëposhtme.

(f) Diskurset e pambrojtura: Gjuha e Urrejtjes

Është e rëndësishme të theksohet se, për shkak të kërkesave të pluralizmit, tolerancës dhe largpamësisë, fusha e mbrojtjes e nenit 10 mbulon informacione ose ide të cilat mund të trondisin apo ofendojnë disa njerëz³⁸. Diskurset, të cilat mund të jenë ofenduese duhet të dallohen nga gjuha e urrejtjes. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës e ka përshkruar “gjuhën e urrejtjes” si “forma të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes në bazë të intolerancës³⁹. Liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të justifikuar “gjuhën e urrejtjes”. Diskurset, të cilat vijnë në kundërshtim me vlerat e Konventës nuk do të mbrohen nga neni 10. Gjykata ka vërejtur:

“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike pluraliste. Duke qenë kështu, parimisht, mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike për të dënuar apo parandaluar të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen në bazë të intolerancës⁴⁰.”

Për të përcaktuar nëse një deklaratë mund të mbrohet nga neni 10 është e nevojshme të bëhet dallimi në mes diskurseve, që janë tronditëse, por jo abuzive apo ofenduese (të cilat do të mbrohen në disa raste)⁴¹, dhe diskurseve, të cilat kanë qëll-

36 *Melnychuk k Ukrainës* (dec.), nr. 28743/03, GJEDNJ 2005-IX.

37 *Appleby dhe Të Tjerët k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 44306/98, vendim i 6 majit 2003, paragrafet 42-43 dhe 47-49.

38 *Handyside k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 5493/72, vendim i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 49.

39 Rekomandimi Nr. R 97 (20) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës i aksesueshëm në: [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec\(97\)20_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec(97)20_en.pdf)

40 *Erbakan k Turqisë*, Ap. Nr. 59405/00, vendim i 6 korrikut 2006, paragrafi 56.

41 E.g. *Lehideux dhe Isorni k Francës*, Ap. Nr. 24662/94, vendim i 23 shtatorit 1998.

lim shkeljen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve (të cilat nuk mbrohen)⁴². Kështu, në disa raste, Gjykata është shprehur se gjuha e urrejtjes bie tërësisht jashtë fushës së mbrojtjes së nenit 10. Në raste të tjera, Gjykata ka vërejtur se deklaratat kanë qenë brenda fushëveprimit të këtij neni, por se ndërhyrjet kanë qenë të justifikuara⁴³.

Gjykata ka përjashtuar gjuhën e urrejtjes nga mbrojtja me anë të dy qasjeve të parashikuara në Konventë:

- a) Duke vërejtur se për shkak të natyrës së tij, ky diskurs bie tërësisht jashtë fushës së mbrojtjes së nenit 10 dhe për rrjedhojë ankimet janë të papranueshme *ratione materiae*. Gjykata ka vlerësuar se në zbatim të nenit 17 të Konventës (ndalimi i shpërdorimit të të drejtave), kërkuesit nuk mund të përfitojnë nga mbrojtja e ofruar nga neni 10. Ky qëndrim ka për qëllim parandalimin e aktiviteteve apo veprimeve që synojnë ndërhyje në të gjitha të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventë. Në këto raste, Gjykatës nuk i duhet të shqyrtojë nëse ndërhyrjet kanë qenë në përputhje me ligjin apo të justifikueshme.
- b) Duke zbatuar kufizimet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 10 të Konventës - kjo qasje zbatohet kur diskursi në fjalë (megjithëse mund të konsiderohet si gjuhë e urrejtjes) nuk është i aftë të shkatërrojë vlerat themelore të Konventës.

Gjykata ka vërejtur se neni 10 nuk mbron *inter alia*:

- Mohimin e Holokaustit⁴⁴;
- Akuzimin e homoseksualëve se kanë një efekt moralisht shkatërrues në shoqëri dhe janë përgjegjës për zhvillimin e HIV-it dhe AIDS-it⁴⁵;
- Mbrojtjen në publik e krimeve të luftës⁴⁶; dhe
- Diskurse që lidhin të gjithë muslimanët me sulmet e 9/11⁴⁷.

Të tilla deklaratat vijnë në kundërshtim me vlerat themelore të Konventës, specifikisht me drejtësinë, paqen sociale dhe mosdiskriminimin. Në fakt, sanksionet penale mund edhe të lejohet ose kërkohen në këtë kontekst⁴⁸.

42 E.g. *Vona v Hungarisë*, Ap. Nr. 35943/10, vendim i 9 korrikut 2013.

43 *Sürek k Turqisë (no. 1)*, Ap. Nr. 26682/95, Dhomë e Madhe vendim i 8 korrikut 1999.

44 *Garaudy k Francës*, Ap. Nr. 65831/01, vendim i 24 qershorit 2003, Pranueshmëri.

45 *Vejdeland dhe Të Tjerët k Suedisë*, Ap. Nr. 1813/07, vendim i 9 korrikut 2012.

46 *Lehideux dhe Isorni k Francës*, Ap. Nr. 24662/94, vendim i 23 shtatorit 1998, paragrafi 53; *Leroy k Francës*, Ap. Nr. 36109/03, vendim i 2 tetorit 2008.

47 *Norwood k Mbretërisë së Bashkuar*, App No. 23131/03, DA 16 nëntorit 2004.

48 *Garaudy k Francës*, Ap. Nr. 65831/01, DA 24 qershor 2003.

[II] Liria e Shprehjes dhe Media

Ky seksion do të shqyrtojë çështjen tepër të rëndësishme të lirisë së shtypit në bazë të nenit 10 të Konventës, si dhe mënyrën si mbrojtja e mediave mund të ndikojnë mbi të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

(a) Mbrojtja e Garantuar për Mediat në Kuadër të Nenit 10

Gjykata ka theksuar se neni 10 mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit, por edhe mjetet e shpërndarjes së tij⁴⁹. Megjithëse, neni 10 nuk përmend në mënyrë eksplicite lirinë e shtypit, Gjykata ka zhvilluar një jurisprudencë të gjerë për këtë çështje, duke siguruar një linjë parimesh dhe rregullash, duke i dhënë shtypit një status të veçantë në gëzimin e lirive të garantuara në nenin 10. Gjykata ka theksuar rolin e shtypit, si mbikqyrës i politikës, duke u shprehur se:

“[është]... detyrë e [shtypit] për të dhënë informacione dhe ide mbi çështjet politike, si edhe në fusha të tjera të cilat kanë interes publik. Jo vetëm shtypi ka detyrë të japë informacione dhe ide të tilla: edhe publiku ka të drejtë t'i marrë ato”⁵⁰.

Liria e shtypit shihet si një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe krijuar një opinion mbi idetë dhe qëndrimet e liderëve politikë. Për këtë arsye ajo është në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike. Në këtë drejtim, shtypi është aktiv në ekspozimin veprimeve të qeverisë përpara publikut⁵¹. Gjithashtu, shtypi ka një rol të rëndësishëm edhe jashtë procesit politik, në nxitjen e debatit mbi çështjet me interes publik.⁵²

Shtypi gëzon një fushë të gjerë mbrojtjeje në kuadër të nenit 10. Kjo mbrojtje shtrihet në kërkimet dhe hetimet e kryera nga gazetarët⁵³ për përgatitjen e artikujve, si dhe mbrojtjen e burimeve gazetareske⁵⁴. Qëllimi i lirisë së shprehjes së shtypit duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar për shkak të rolit të tij “mbikqyrës”.

49 *Autronic AG k Zvicrës*, Ap. Nr. 12726/87, vendim i 22 majit 1990, paragrafi 47; *Öztürk k Turqisë*, Ap. Nr. 22479/93, Dhomë e Madhe vendim i 28 shtatorit 1999, paragrafi 49.

50 *Lingens k Austrisë*, Ap. Nr. 9815/82, vendim i 8 korrikut 1986, paragrafi 42.

51 *Martin dhe Të Tjerët k Francës*, Ap. Nr. 30002/08, vendim i 12 prillit 2012, paragrafi 80.

52 *Cumpana dhe Mazare k Rumanisë*, Ap. Nr. 33348/96, vendim i 17 dhjetorit 2004, paragrafi 80.

53 *Sunday Times k Mbretërisë së Bashkuar (no. 2)*, Ap. Nr. 13166/87, vendim i 26 nëntorit 1991.

54 *Goodwin k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 17488/90, Dhomë e Madhe vendim i 27 marsit 2006.

Kështu, lirisë gazetareske mund t'i lejohet një shkallë ekzagjerimi ose provokimi⁵⁵. Masat e vendosura nga autoritetet publike (përfshirë gjykatat vendase), që janë të afta të dekurajojnë pjesëmarrjen e shtypit në debatet mbi çështjet me interes publik, kanë gjasa të shqyrtohen përmes interpretimit të ngushtë⁵⁶.

(b) Detyrat dhe Përgjegjësitë e Medias

Megjithëse, neni 10 ofron mbrojtje të fortë për shtypin, liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute dhe detyrat e përgjegjësitë, që mbart me vete zbatohen edhe për shtypin. Gjykata ka vërejtur: “Për shkak të “detyrave dhe përgjegjësi” në kuadër të ushtrimit të lirisë së shprehjes, mbrojtja e ofruar nga neni 10 për gazetarët në lidhje me raportimin për çështjet me interes të përgjithshëm detyron, ata të veprojnë në mirëbesim, me qëllim për të siguruar informacione të sakta dhe të besueshme në përputhje me etikën gazetareske⁵⁷.”

Për gazetarët, kjo do të thotë se qëllimi i saktë i këtyre detyrave dhe përgjegjësi varet nga situata e personit, që ushtron të drejtën dhe mjetet teknike që ai ose ajo përdor⁵⁸. Ka të ngjarë, që detyrimet të jenë më të rënda, kur sulmohet reputacioni i një individi, ose të drejtat të një personi janë shkelur⁵⁹. Gjithashtu, kjo do të thotë se gazetarët duhet të kenë në vëmendje *Rekomandimin* 1215 (1993) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe *Rezolutën e saj 1003 (1993)* mbi etikën gazetareske.

(c) Faktorë të Rëndësishëm në Ekuilibrimin e të Drejtave Konkurruese

Sikurse u përmend dhe më herët, neni 10 nuk është një e drejtë absolute; por një e drejtë që mund të kufizohet. Kjo do të thotë se një ndërhyrje me lirinë e shprehjes nuk është domosdoshmërisht një shkelje e nenit 10 - por mund të justifikohet. Për më tepër, përcjellja e informacionit nga media brenda objektit të nenit 10, mund të ndikojnë në jetën private të një personi në kuadër të nenit 8 të Konventës⁶⁰. Prandaj, ekzistojnë një sërë faktorësh, që duhet të peshohen nga autoritetet kombëtare në ekuilibrimin e të drejtave potencialisht kontradiktore apo konkurruese dhe publikimeve të medias.

55 *Bladet Tromsø dhe Stensaas k Norvegjisë*, Ap. Nr. 21980/93, Dhomë e Madhe vendim i 20 majit 1999, paragrafi 59.

56 *Ibid*, paragrafi 64.

57 *Ibid*, para 65; *Bladet Tromsø dhe Stensaas k Norvegjisë*, Ap. Nr. 21980/93, vendim i 20 majit 1999, paragrafi 65.

58 *Handyside k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 5493/72), vendim i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 49.

59 *Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July k Francës*, Ap. Nr. 21279/02, Dhomë e Madhe vendim i 22 tetorit 2008.

60 Neni 8 i Konventës, dhe se si ai ndërvepron me të drejtën e lirisë së shprehjes, do të shqyrtohet në hollësi në Pjesën IV të kësaj guide.

Në çështjet e lidhura me median një sërë faktorësh mund të jenë të rëndësishëm në balancimin e të drejtave dhe interesave në fjalë. Këto çështje përfshijnë⁶¹:

- Nëse informacioni kontribuon në një debat me interes publik;
- Nëse personi në fjalë është figurë publike ose private;
- Sjellja paraprake e personit në fjalë;
- Forma, përmbajtja dhe pasojat e botimit; dhe
- Rrethanat në të cilat janë bërë fotografitë.

Këto çështje janë shqyrtuar në mënyrë kronologjike më poshtë:

(i) *Kontributi në një Debat me Interes Publik*

Aspekti i parë, i cili duhet marrë parasysh është nëse dhe në çfarë mase fotot ose artikulli kontribuojnë në një debat me interes publik⁶². Ajo çfarët mund të jetë interesante për publikun, nuk është gjithmonë një diskutim i cili është në interes të publikut. Nëse një çështje përbën ose jo një subjekt me interes publik varet nga rrethanat e rastit. Çështjet, që lidhen me politikën normalisht janë të një interesi të përgjithshëm dhe për këtë arsye shumë pak kufizime mund të lejohen në këto raste⁶³.

Gjykata ka çmuar se çështjet e mëposhtme nuk përfshihen në interesin publik:

- Problemet bashkëshortore të një lideri politik⁶⁴;
- Situata financiare e një këngëtarit të famshëm⁶⁵;
- Fotot e jetës private të një figure publike që thjesht synojnë të shuajnë kuriozitetin e publikut mbi jetën e tij/saj⁶⁶.

Rregulli i përgjithshëm është se në çfarë aspekti, komunikimi në fjalë kontribuon në një debat me interes publik. Çdo lloj ndërhyrjeje në këto lloj komunikimesh do të jetë e vështirë për t'u kufizuar.

61 *Von Hannover k Gjermanisë (nr. 2)*, Ap. Nrs. 40660/08 dhe 60641/08, vendim i 7 shkurtit 2012, paragrafët 109-113.

62 *Von Hannover k Gjermanisë (nr. 2)*, Ap. Nrs. 40660/08 dhe 60641/08, vendim i 7 shkurtit 2012, paragrafi 109.

63 *Kulis k Polonisë*, Ap. Nr. 15601/02, vendim i 18 marsit 2008, paragrafët 37-38.

64 *Standard Verlags GmbH k Austrisë (Nr. 2)*, Ap. Nr. 21277/05, vendim i 4 qershorit 2009.

65 *Hachette Filipacchi Associes (ICI Paris) k Francës*, Ap. Nr. 12268/03, vendim i 27 korrikut 2009.

66 *Von Hannover k Gjermanisë*, Ap. Nr. 59320/00, vendim i 24 qershorit 2004, paragrafi 64.

Nivele të ndryshme të mbrojtjeje zbatohen në varësi të faktit nëse individët janë figura publike ose private. Kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë, kur një figurë publike është e përfshirë; veçanërisht kur objektivi i publikimit është një politikan. Gjykata është shprehur se figurat publike, përfshirë këtu gjyqtarët⁶⁷ dhe politikanët, në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije, e kanë vendosur veten në lenten e publikut. Për rrjedhojë, ata duhet të shfaqin një shkallë më të madhe tolerance⁶⁸. Ky fakt është veçanërisht i zbatueshëm për politikanët gjatë fushatave zgjedhore. Gjatë këtyre periudhave, opinione dhe informacione të të gjitha llojeve duhet të lejohen të qarkullojnë lirisht⁶⁹.

Megjithatë, edhe personat me profil publik mund të legjitimohen të presin një shkallë të caktuar privatësie⁷⁰. Gjykata bën dallimin midis raportimit për aspektet e jetës private të figurave publike dhe raportimit mbi *funksionin e tyre publik*⁷¹. Mbrojtje më e madhe është dhënë për situatën e parë. Megjithatë, e drejta e publikut për t'u informuar mund edhe të zgjerohet, në rrethana të caktuara, për aspekte të veçanta të jetës private të figurave publike, veçanërisht kur bëhet fjalë për politikanët⁷².

Gjithashtu, Gjykata ka pranuar se personat mund të tërhiqen nga jeta publike. Provimi i interesit publik për dhënien e informacioneve në lidhje me jetën private të personave, që janë tërhequr nga jeta publike ka të ngjarë të jetë më e vështirë⁷³.

(iii) *Forma, Përmbajtja dhe Pasojat e publikimeve*

Një faktor tjetër i rëndësishëm është mënyra në të cilën fotot ose raportet janë publikuar, si edhe mënyra në të cilën personi shfaqet në këto materiale⁷⁴. Gjykata do të marrë në konsideratë shkallën në të cilën raportet dhe fotot janë shpërndarë, duke vërejtur nëse gazeta është kombëtare ose lokale dhe ka një tirazh të madh apo të kufizuar⁷⁵.

67 Ky aspekt i veçantë i lirisë së shprehjes do të shqyrtohet më hollësisht në Pjesën VI më poshtë.

68 E.g. *Angelov k Bullgarisë; Lombardo dhe Të Tjerët k Maltës*, Ap. Nr. 7333/06, vendim i 24 prillit 2007, paragrafi 54; *Kulis k Polonisë*, Ap. Nr. 15601/02, vendim i 13 marsit 2008.

69 *Lepojić k Serbisë*, Ap. Nr. 13909/05, vendim i 6 nëntorit 2007.

70 *Von Hannover k Gjermanisë*, Ap. Nr. 59320/00, vendim i 24 June 2004.

71 *Dalban k Rumanisë*, Ap. Nr. 28114/95, Dhomë e Madhe vendim i 28 shtatorit 1999, paragrafi 50.

72 *Von Hannover k Gjermanisë*, Ap. Nr. 59320/00, vendim i 24 qershorit 2004, paragrafi 64.

73 *Tammer k Estonisë*, Ap. Nr. 41205/98, vendim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 68.

74 *Jokitaipale dhe Të Tjerët k Finlandës*, Ap. Nr. 43349/05, vendim i 6 prillit 2010.

75 *Karhuvaara dhe Iltalehti k Finlandës*, Ap. Nr. 53678/00, vendim i 16 nëntorit 2004, paragrafi 47.

(iv) *Rrethanat në të cilat janë bërë Fotografitë*

Gjykata është shprehur se konteksti dhe rrethanat në të cilat janë bërë fotot janë të rëndësishme⁷⁶. Është e nevojshme të vlerësohet nëse marrja e fotografive dhe publikimi i tyre është bërë me pëlqimin e personit të fotografuar, apo pa dijeninë e tij/saj me mjete të paligjshme. Duhet të merret parasysh, serioziteti i ndërhyrjes dhe pasojat e ardhura nga publikimi për personin në fjalë.

(d) Dy tipologji çështjesh

Megjithëse, ekuilibrimi i të drejtave do të shqyrtohet më hollësisht më tej në kontekstet specifike të nenit 6 dhe nenit 8 të Konventës, ajo çfarë mund të jetë e dobishme për të ilustruar në këtë pjesë janë faktorët e zbatuar nga Gjykata, për ekuilibrimin e të drejtave konkurruese. Dy rasteve të rëndësishme të GJEDNJ në këtë fushë:

1. *Hachette Filipacchi k Francës* – një rast i sjellë nga një shtëpi botuese, e cila u ankua për një ndërhyrje në të drejtën e saj për lirinë e shprehjes; dhe
2. *Von Hannover k Gjermanisë* – një çështje e sjellë nga një individ, që ankohej për publikimin në shtyp të jetës së saj private.

Këto dy çështje do të trajtohen me radhë më poshtë.

Hachette Filipacchi k. Francës⁷⁷

Revista e përjavshme franceze, Paris-Match, botoi një artikull në lidhje me vrasjen e Prefektit Klaud Erignac në Ajacio, Korsikë, më 6 shkurt 1998. Artikulli ishte ilustruar me një fotografi të skenës së krimit, moment i marrë pas vrasjes, e cila tregonte trupin e prefektit të shtrirë në tokë.

Në gjykimin civil të brendshëm, gjykatat franceze urdhëruan që Paris-Match duhet të botonte një deklaratë se fotografia ishte publikuar pa lejen e familjes Claude Erignac dhe se ajo e konsideroi botimin e saj si një ndërhyrje në privatsinë e jetës së tyre private.

Shoqëria botuese kërkuese u ankua para Gjykatës se detyrimi për të publikuar deklaratën shkelte të drejtën e saj për tu shprehur lirisht. Gjykata u shpreh se rasti në fjalë përbente ndërhyrje në lirinë e shprehjes së kërkuesit. Ajo vijoi më tej të vlerësojë nëse ndërhyrja ishte e justifikuar:

⁷⁶ *Von Hannover k Gjermanisë* (nr. 2), Ap. Nrs. 40660/08 dhe 60641/08, vendim i 7 shkurtit 2012, paragrafi 113

⁷⁷ *Hachette Filipacchi k Francës*, Ap. Nr. 71111/01, vendimi i 14 qershorit 2007.

- Së pari, ajo u shpreh se detyrimi i caktuar në bazë të jurisprudencës, përmbushte kushtet e aksesit dhe parashikueshmërisë së nevojshme për të përcaktuar se kjo formë e ndërhyrjes ishte “e parashikuar me ligj”.
- Së dyti, ndërhyrja kishte ndjekur një nga qëllimet legjitime të përcaktuara në nenin 10 (2), konkretisht “mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.
- Për rrjedhojë, çështja e tretë dhe më kritike ishte nëse masa ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Në vlerësimin e çështjes së tretë Gjykata konsideroi një sërë faktorësh, duke përfshirë:

- ‘Detyrat dhe përgjegjësitë’ që natyrshëm rrjedhin nga ushtrimi i lirisë së shprehjes dhe efektit potencialisht parandalues të dënimit të dhënë mbi mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte.
- Shqetësimin e ndërë nga familja e viktimës, kundërshtimin e tyre të shprehur mbi publikimin dhe rrethanat e dhunshme traumatike të vdekjes.
- Formulimi i deklaratës që gjykatat franceze i kërkuan Paris-Match të publikojë dhe respektimi i lirisë editoriale të revistës nga gjykata vendase.

Duke marrë parasysh këta faktorë, Gjykata konstatoi se gjykatat e brendshme i kishin caktuar dënimin më të lehtë të parashikuar sipas të drejtave të Kodit Civil francez, shoqërisë kërkuese. Prandaj, Gjykata u shpreh se ndërhyrja e gjykatave të brendshme mbi lirinë e shprehjes së kërkuesit ishte e justifikuar dhe se për rrjedhojë nuk ka pasur shkelje të nenit 10.

*Von Hannover k Gjermanisë*⁷⁸

Ky rast kishte të bënte me publikimin në një revistë gjermane të një sërë fotografish të Caroline Von Hannover, vajza e madhe e princit Rainier III të Monakos. Pas procesit gjyqësor në gjykatat e brendshme gjermane lidhur me publikimet, ajo u ankua në Gjykatë për mungesën e mbrojtjes së duhur nga ana e shtetit të jetës private dhe imazhit të saj.

Gjykata i qaset kësaj lloji çështje, duke theksuar se duhej të gjendej një ekuilibër mes mbrojtjes së jetës së saj private kundrejt lirisë së shprehjes të garantuar në nenin 10. Nga njëra anë ajo theksoi se e drejta për lirinë e shprehjes vlen për publikimin e fotografive. Nga ana tjetër, ajo u shpreh se kjo është një fushë në të cilën mbrojtja e të drejtave dhe dinjitetit të të tjerëve merr një rëndësi të veçantë.

⁷⁸ Von Hannover k Gjermanisë, Ap. Nr. 59320/00, vendimi i 24 qershorit 2004.

Në vlerësimin e ekuilibrit mes zbatimit të të drejtave të nenit 8 dhe nenit 10, Gjykata ka konstatuar disa pika të rëndësishme:

- Faktori vendimtar në vendosjen e ekuilibrit midis të drejtës së nenit 8 dhe nenit 10 është kontributi i dhënë nga fotot apo artikujt në shtyp për një debat me interes publik. Kërkuesja ka përfaqësuar familjen mbretërore të Monakos në ngjarje të caktuara kulturore apo bamirëse, por ajo nuk ka ushtruar funksione zyrtare. Fotot lidhen vetëm me jetën private të kërkueses dhe nuk kontribuojnë në një debat publik. Gjykata nënvizoi se duhej bërë një interpretim në i ngushtë i nenit 10.
- Në këtë rast, fotot përmbanin informacion shumë personal apo edhe intim rreth kërkueses. Gjykata theksoi se fotot e publikuara në shtypin e shkruar shpesh janë marrë si ngacmime të vazhdueshme, të cilat personit në fjalë i shkaktojnë një ndjenjë shumë të fortë ndërhyrje apo edhe të persekutimi në jetën e tyre private.
- Ato janë marrë pa dijeninë apo pëlqimin e kërkueses dhe u shpreh se ngacmimet e shkaktuara ndaj shumë figurave publike në jetën e përditshme nuk mund të shpërfillen plotësisht.
- Gjykata konsideroi se publiku nuk ka një interes legjitim për të ditur se ku ndodhet kërkuesja dhe se si ajo silllet në përgjithësi në jetën private, edhe nëse ajo shfaqet në vende që jo gjithmonë mund të cilësohen si të veçuara edhe pavarësisht faktit se ajo është e njohur nga publiku.

Gjykata theksoi se neni 8, e drejta për respektimin e jetës private shtrihej përtej rrethit privat familjar dhe gjithashtu përfshinte një shtrirje shoqërore. Edhe personat e njohur për publikun e gjerë, duhet të kenë mundësinë për të gëzuar një “pritshtëri legjitime” të mbrojtjes dhe respektimit të jetës së tyre private, veçanërisht duke pasur parasysh teknologjitë e reja të komunikimit. Gjykata vendosi unanimitisht se e drejta e kërkueses për respektimin e jetës së saj private ishte shkelur nga mosveprimi i autoriteteve në mbrojtjen e saj nga ndërhyrjet e shtypit. Kjo mund të krahasohet me vendimin e *Gjykatës së Von Hannover (nr. 2)*⁷⁹, në të cilin nuk u konstatua asnjë shkelje në lidhje me fakte të ngjashme pasi gjykatat e brendshme kishin parë me kujdes ekuilibërën mes interesave konkurruese, duke marrë parasysh jurisprudencën e Gjykatës.

(e) Natyra e Sanksioneve

Disa kufizime apo sanksione të caktuara për ushtrimin e lirisë së shprehjes nga ana e medias, janë veçanërisht të vështira të justifikohen për shkak të ashpërsisë së ndikimit që mund të kenë në ushtrimin e së drejtës. Kjo përfshin:

⁷⁹ *Von Hannover k Gjermanisë (nr. 2)*, Ap. Nrs. 40660/08 dhe 60641/08, vendim i 7 shkurtit 2012,

- Sanksionet penale.⁸⁰
- Kufizime paraprake për publikime.

Sanksionet penale për publikimet, që nuk janë të ndaluara sipas Konventës, duhet të zbatohen vetëm në “rrethana të veçanta”. Gjykata ka theksuar se:

‘adresimi për ndjekje penale për fyrije të qëllimshme nga ana gazetarëve që ngrenë diskutime të çështjeve të interesit publik ... duhet të jetë proporcionale vetëm në raste shumë të veçanta që përfshijnë një sulm më të rëndë për të drejtat e një individi Në të kundërt kjo do të pengojë gazetarët të kontribuojnë në diskutim e çështjeve në publik, të cilat ndikojnë në jetën e komunitetit dhe më në përgjithësi, do të pengojë shtypin në kryerjen e rolit të tij të rëndësishëm si një “monitorues publik”.’⁸¹

Kufizime të mëparshme të botimeve nuk janë absolutisht të ndaluara nga neni 10, por Gjykata ka theksuar se:

‘rreziqet e natyrshme në kufizimin paraprak janë të tilla që kërkojnë shqyrtim më të kujdesshëm nga ana e Gjykatës. Kjo sepse shqetësimi i shtypit qëndron në faktin se lajmi është një produkt i përkohshëm dhe vonesat në publikimin e tij, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër, mund të dëmtojnë gjithë vlerën dhe interesin e tij. Ky rrezik mund të shtrihet deri në censurimin e publikimeve të tjera nga botimet periodike që merren me një çështje të caktuar’.⁸²

[III] Neni 10 dhe neni 8: Ekuilibrimi i të Drejtës për Jetë Private me të Drejtën e Lirisë së Shprehjes

Një nga rastet më të dukshme, kur ngrihet çështja e ekuilibrit midis të drejtës të lirisë së shprehjes dhe të drejtave të tjera, është rasti kur ushtrimi i lirisë së shprehjes nga një person, ndikon në të drejtën e jetës private të një personi tjetër të garantuar në nenin 8 të Konventës. Ky ndërveprim u prek më sipër në kontekstin e lirisë së shtypit, por ai do të shqyrtohet në mënyrë më të detajuar në këtë pjesë.

(a) Neni 8 KEDNJ

Neni 8 garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës. Ai garanton:

⁸⁰ *Karademirci k Turqisë*, Ap. Nr. 37096/97 dhe 37101/97, vendim i 25 janarit 2005, paragrafi 42-43.

⁸¹ *Bodrožić dhe Vujin k Serbisë*, Ap. Nr. 38435/05, vendim i 23 qershorit 2009, paragrafi 39.

⁸² *Alinak k Turqisë*, Ap. Nr. 40287/98, vendim i 29 marsit 2005, paragrafi 37.

‘1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti Publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.’

(b) Qëllimi i nenit 8

Neni 8 u kërkon Shteteve të respektojnë katër të drejta, të cilat janë të papërcaktuara në tekstin e Konventës. Përgjatë viteve, Gjykata ka bërë një përsqasje shumë të gjerë për të përcaktuar qëllimin e mbrojtjes së parashikuar nga kjo dispozitë. Neni 8 ndonjëherë është konsideruar si një dispozitë e ‘papërdorur’ për çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e tjera të kësaj Konvente. Gjykata ka përdorur qasjen e ‘instrumentit jetësor’ për të lehtësuar interpretimin e nenit 8 në përputhje me zhvillimet shoqërore. Neni 8 mbron ‘respektin për’ çdo interes. Kështu, jo vetëm që Shtetet kanë detyrimin negativ të mos ndërhyjnë në këto të drejta, por ka edhe një detyrim të qenësishëm pozitiv ndaj qytetarëve për të mbrojtur këto interesat nga ndërhyrjet nga aktorë jo-shtetërorë.

Neni 8 përfshin mbrojtjen e katër fushave kryesore:

- Jeta Private;
- Jeta Familjare;
- Banesa;
- Korrespondenca.

Secili prej tyre është një koncept autonom sipas Konventës. Në kontekstin e marrjes në konsideratë të lirisë së shprehjes, është veçanërisht e rëndësishme të merret parasysh fusha e mbrojtjes së jetës private. Prandaj, në fokus të shqyrtimit është e drejta për respektimin e jetës private.

(c) Fusha e Veprimit e ‘jetës private’

Në krye të herës, Gjykata ka ndërmarrë një interpretim të zgjeruar të nocionit të jetës private, në vend të një interpretimi më të ngushtë, e cila do të kufizonte fushëveprimin e konceptit tradicional të privatësisë. Koncepti i “jetës private” është më i ngjashëm me konceptin e autonomisë personale. Si rezultat i kësaj, qëllimit të jetës private nuk mund ti vendoset një kufi që për të qenë në përputhje

me sigurinë juridike. Në çështjen e Linguistikës Belge⁸³, Gjykata u shpreh se jeta private përfshin të drejtën për të jetuar jetën e dikujt pa pasur ndërhyrje arbitrare. Gjykata shkoi edhe më tej duke thënë se “[r]espekti për jetën private duhet të përfshijë në një shkallë të caktuar të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore”⁸⁴. Megjithatë, Gjykata sqaroi se

*‘Gjithsesi, kuptimi i plotë i nenit 8 nuk do të thotë, se ai mbron çdo veprim që një person mund të kërkojë në marrëdhëniet me qeniet e tjera njerëzore për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie të tilla. Për shembull, kjo nuk do të garantojë marrëdhënie ndërpersonale të një fushe veprimi të gjerë dhe të papërcaktuar, që s’mund të ketë lidhje të mundshme të drejtpërdrejta midis veprimit ose mosveprimit të një Shteti dhe jetës private të një personi’.*⁸⁵

Gjithashtu, Gjykata u shpreh se mbrojtja e të dhënave është e garantuar nga neni 8. Ruajtja e të dhënave nga një autoritet publik të informacionit në lidhje me jetën private të një personi përbën një ndërhyrje në nenin 8, pavarësisht përdorimit të informacionit⁸⁶.

Nocioni për respektimin e jetës private shtrihet gjithashtu edhe në integritetin fizik dhe moral, që lidhet me mirëqenien fizike dhe psikologjike.⁸⁷ Ajo gjithashtu është e përcaktuar në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës, se e drejta për mbrojtjen e dinjitetit dhe nderit është e parashikuar në nenin 8 të Konventës si pjesë e së drejtës për respektimin e jetës private.⁸⁸

(d) Kualifikimi Ligjor i të Drejtës

Objekti kryesor i nenit 8 është të mbrojë individët ndaj ndërhyrjeve arbitrare nga shteti në ndonjë nga katër fushat e mbrojtura. Në vijim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka zhvilluar testin pesë-pikësh, të ngjashëm me atë që ajo zbaton në bazë të nenit 10. Ajo e përdor këtë test për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje të këtij detyrimi negativ që rrjedh sipas nenit 8.

83 Çështja “Në Lidhje me Aspekte të Caktuara të Ligjeve mbi Përdorimin e Gjuhëve në Fushën e Arsimit në Belgjikë” k Belgjikës’, Ap. Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63, 2126/64, vendim i 23 korrikut 1968, paragrafi 6.

84 *Niemietz k Gjermanisë*, Ap. No. 13710/88, vendim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 29.

85 *Friend dhe të Tjerët k Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 16072/06, 27809/08, DA 24 nëntor 2009.

86 *Leander k Suedisë*, Ap. Nr. 9248/81, vendim i 26 marsit 1987; *Kopp k Zvicrës*, Ap. Nr. 23224/94, vendim i 25 marsit 1998; *Amann k Zvicrës*, Ap. Nr. 27798/95, vendim i 16 shkurtit 2000.

87 *X dhe Y k Holandës*, Ap. Nr. 8978/80, vendim i 6 marsit 1985.

88 *A k Norvegjisë*, Ap. Nr. 28070/06, vendim i 9 prillit 2009, paragrafi 64.

Së pari, individi i dëmtuar duhet të tregojë se:

1. Të drejtat e tij/saj sipas nenit 8 kanë qenë të përfshira - A përfshihet rasti në fushëveprimin e një prej të drejtave të garantuara në nenin 8? Nëse jo, neni 8 nuk zbatohet.
2. Shteti ka ndërhyrë në këto të drejta – a janë veprimet e shtetit të mjaftueshme për të derivuar në një ndërhyrje në jetën private të një personi apo një nga fushat e tjera të garantuara?

Nëse ka pasur një ndërhyrje e tillë, ajo nuk mund të jetë e justifikuar nëse Shteti nuk mund të tregojë se:

1. Ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin. Në lidhje me nenin 10, ashtu si u diskutua më sipër, ligji në fjalë duhet të jetë mjaftueshëm i sigurt në formulimin dhe parashikimin e pasojave të tij. Ajo duhet gjithashtu të jetë në dispozicion të publikut;
2. Ndërhyrja ndjek një ose më shumë nga qëllimet legjitime të përcaktuara në nenin 8 (2);
3. Ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Kjo do të thotë se ndërhyrja duhet të plotësojë *një nevojë të ngutshme sociale dhe duhet të jetë në përpjesëtim me e qëllimin legjitim të ndjekur*.

Qëllimet legjitime në fjalë janë të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 8, përkatësisht:

- Siguria kombëtare, siguria publike ose mirëqenia ekonomike e një vendi.
- Mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit.
- Mbrojtja e shëndetit dhe moralit.
- Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

(e) Ndërveprimi me Nenin 10

Një nga fushat në të cilat parashikohen detyrimet pozitive të një Shteti sipas nenit 8, është kontrolli i duhur i autoriteteve publike në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes nga ana e individëve, duke pasur parasysh dispozitën e qartë të nenit 10 (2) se ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban detyrime dhe përgjegjësi. Kështu, për shembull, mungesa e një mjeti në lidhje me publikimin e informacionit që lidhet me çështje private mund të përbëjë mungesë të respektimit të jetës private.⁸⁹

⁸⁹ *Schiissel k Austrisë*, Ap. Nr. 40409/98, vendim i 21 shkurtit 2002.

Gjyqtarët e gjykatave vendase duhet të kenë parasysh vendosjen e ekuilibrit të duhur midis të drejtave të nenit 8 dhe nenit 10 me qëllim respektimin e këtyre dy të drejtave, ku asnjëra prej të cilave nuk prevalon ndaj tjetrës.⁹⁰ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka deklaruar se: “Asambleja riafirmon rëndësinë e të drejtës së gjithësecilit për privatësi, dhe të drejtës për lirinë e shprehjes, si dy të drejta themelore për një shoqëri demokratike. Këto të drejta nuk janë as absolute dhe nuk mund të renditen në mënyrë hierarkike, për sa kohë që ato kanë një rëndësi të njëjtë.”⁹¹

Gjykata ka nënvizuar disa parime, të cilat janë të zbatueshme kur kërkohet vendosja e një ekuilibri mes nenit 10 dhe nenit 8. Së pari, në mënyrë që neni 8 të gjejë zbatim, një “sulm mbi dinjitetin e një personi duhet të arrijë një nivel të caktuar ashpërsie dhe të bëhet në mënyrë të tillë që të shkaktojë dëme në gëzimin personal të të drejtës për respektimin e jetës private”.⁹² Gjithashtu, Gjykata rithekson vazhdimisht parimet e përgjithshme në lidhje me lirinë e shprehjes, konkretisht, liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike, se ajo është e zbatueshme jo vetëm për “informacione” ose ‘ide’ që janë marrë në mënyrën e duhur ose konsiderohen si të padëmshme apo si çështje të paanshmërisë, por edhe për ata që fyejnë, trondisin ose shqetësojnë, dhe se çdo përjashtim për lirinë e shprehjes duhet të interpretohet në mënyrë rigoroze dhe nevoja për çdo kufizim duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse.

[IV] Neni 10 dhe Neni 6: Bashkëveprimi midis Lirisë së Shprehjes me të Drejtën për Një Proces të Rregullt sipas Konventës

Një tjetër çështje e rëndësishme bashkëveprimi është marrëdhënia midis të drejtës së lirisë së shprehjes dhe të drejtës për një proces të rregullt. Kur liria e medias dhe çështje të tjera të lirisë së shprehjes ngrihen në kontekstin e sistemit të drejtësisë, duhet të merren parasysh faktorë të tjerë. Në veçanti, gjyqtarët duhet të marrin në konsideratë se si e drejta për një proces të rregullt lidhet me lirinë e shprehjes. Në mënyrë që kjo të arrihet, atyre do tu duhet të kuptojnë nenin 6 të Konventës, i cili mbron të drejtën për një proces të rregullt.

90 *Von Hannover k Gjermansë*, Ap. Nr. 59320/00, vendim i 24 qershorit 2004, paragrafi 58.

91 Rezoluta 1165 (1998) e Asamblesë së Parlamentit të Këshillit të Evropës, paragrafi 10.

92 *Delfi AS k Estonisë*, Ap. Nr. 64569/09, vendim i Dhomës së Madhe i 16 qershorit 2015, paragrafi 137

(a) Neni 6 KEDNJ

Neni 6 i Konvëntës garanton:

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një veprë penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

- (a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
- (b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
- (c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
- (d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*
- (e) të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.*

(b) Ekuilibrimi i Dy të Drejtave

Ndër të tjera, neni 6 parashikon se seancat gjyqësore duhet të jenë publike dhe kjo mund t'i nënshtrohet vetëm përjashtimeve të veçanta. Garantimi i seancave publike dhe mbrojtja e lirisë së shprehjes së mediave janë të lidhura me nenin 10, dhe se ato së bashku luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e sistemit të drejtësisë

që është i hapur ndaj kontrollit. Gjithashtu, mbulimi mediatic i sistemit të drejtësisë, i mundëson publikut informacione që mund të ndihmojnë atë në krijimin e besimit ndaj tij. Për këtë arsye, në shumë raste, mbrojtja e lirisë së shprehjes do të ndihmojë në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave për një proces të rregullt. Këto dy të drejta mbështesin në mënyrë reciproke njëra-tjetrën dhe mund të bashkë-ekzistojnë në harmoni.

Megjithatë, ka edhe raste kur mbrojtja e interesave në bazë të nenit 6 dhe nenit 10 nuk është dhe aq e thjeshtë. Në këto raste, Gjykatës i është kërkuar të përcaktojë nëse autoritetet vendase kanë gjetur ekuilibrin e duhur mes dy grupeve të të drejtave.

Çështje të tilla mund të vijnë para Gjykatës në mënyra të ndryshme, si për shembull:

- Ankesat nga gazetarët apo të tjerët, se e drejta e tyre për lirinë e shprehjes është shkelur në lidhje me një çështje që ka të bëjë apo mund të lidhet me një proces gjyqësor⁹³;
- Ankesat mbi nenin 6 se ushtrimi i lirisë së shprehjes nga një person tjetër ka cenuar procesin e rregullt ose të drejtën e një personi për tu prezumuar i pafajshëm derisa të provohet fajësia e tij.

Gjyqtarëve të çështjes mund tu lindë nevoja për të vendosur një ekuilibër sipas nenit 10, rast që del qartë në çështjen *Worm kundër Austrisë*⁹⁴, në të cilën Gjykata referon drejtpërdrejt ndërlidhjen mes nenit 6 dhe nenit 10. Në çështjen *Worm*, Gjykatës i është dashur të marrë në konsideratë të drejtat kontradiktore lidhur me botimin e një artikulli gjatë procesit penal. Artikulli rrezikonte shkaktimin e paragjyqimit për këtë çështje. Kërkuesi ishte një gazetar, i cili për disa vite raportonte ndaj Z. Androsch, një ish zëvendës-kancelar dhe Ministër i Financave, i cili kishte qenë i përfshirë në procese të ndryshme penale, përfshi këtu dhe gjykime për të cilat ai ishte dënuar për evazion fiskal. Ndërmjet seancave dhe dënimit lidhur me akuzat për evazion fiskal kërkuesi botoi një artikull. Ai më pas u gjykua dhe dënuar në lidhje me këtë artikull, pasi ka vesuar procedimet penale.

Faktori vendimtar në përcaktimin e çështjes para Gjykatës, ishte nëse ndërhyrja në të drejtën e nenit 10 të kërkuesit ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Këtu, qëllimi legjitim në fjalë ishte “ruajtja e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit”.⁹⁵ Edhe pse nevoja për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e

93 Ky aspekt i ndërveprimit mes nenit 6 dhe nenit 10 do të shqyrtohet në seksionin e ardhshëm në kontekst të çështjes specifike të marrëdhënieve ndërmjet profesionit të ligjit dhe nenit 10.

94 *Worm k Austrisë*, Ap. Nr. 22714/93, vendim i 29 gushtit 1997.

95 Arsyetimi i nenit 10 (2) do të shqyrtohet më me detaje në Seksionin V (a) të mëposhtëm.

pushtetit gjyqësor është një qëllim legjitim që mund të justifikojë një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një personi, Gjykata ka deklaruar se nuk i jep të drejtën Shteteve të kufizojnë të gjitha format e debatit publik për çështje të pazgjdhura ende në gjykata. Ajo theksoi se raportimi brenda kufijve të vendosura në interes të administrimit të duhur të drejtësisë është në harmoni me nenin 6. Në këtë mënyrë, Gjykata konfirmoi rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së shprehjes në kuadrin e raportimit të procesit.

Megjithatë, Gjykata vuri në dukje rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës për një proces të rregullt, duke deklaruar se garancitë e procesit të rregullt të përcaktuara në nenin 6, duhet të merren parasysh nga gazetarët gjatë raportimit të proceseve brenda fushës së veprimit të këtij neni. Gjykata arsyetoi se “kufijtë e komenteve të lejuara nuk mund të shtrihen në deklarata, të cilat me qëllim apo jo mund të cenojnë mundësitë e një personi për të pasur një proces të rregullt, ose për të dëmtuar besimin e publikut mbi rolin e gjykatave në administrimin e drejtësisë penale.”⁹⁶ E thënë ndryshe, edhe pse në kontekstin e sistemit të drejtësisë, liritë e medias janë të një rëndësie jetike dhe janë të mbrojtura siç duhet, por liri të tilla nuk vijnë pa përgjegjësi apo kufizime. Pjesë e detyrës së gjykatave të brendshme, kjo nën mbikëqyrjen e GJEDNJ-së, është ekuilibrimi i interesave konkurruese për të gjetur se çfarë kufizimesh janë të përshtatshme, nëse ka të tilla.

Më tej do të trajtohen këto lloj çështjesh.

(c) Anikimet në kuadër të nenit 10 në Lidhje me Proceset Gjyqësore

Një gazetar mund të ankohet në gjykatë se një masë e marrë ndaj tij apo asaj, në kuadër të raportimit të një gjyqi apo hetimi është në shkelje të nenit 10. Për shembull, një vendim gjyqësor mund të jepet ndaj një gazetari për të penguar botimin e një artikulli ose një gazetar mund të dënohet për shpifje në lidhje me një artikull të botuar. Një rast i tillë ka shumë gjasa që të shkaktojë një ndërhyrje me lirinë e shprehjes së gazetarit.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksojmë se neni 10 është një e drejtë kualifikuar. Qëllimet legjitime të renditura në nenin 10 (2), të cilat mund të përdoren për të justifikuar një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një personi përfshijnë:

- Mbrojtja e të drejtave të të tjerëve; dhe
- ‘Garantimi i autoritetit dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor.’⁹⁷

⁹⁶ *Worm k Austrisë*, Ap. Nr. 22714/93, vendim i 29 gushtit 1997, paragrafi 50.

⁹⁷ Ky arsyetim do të shqyrtohet më poshtë, në mënyrë më të hollësishme në Pjesën V (a).

Në lidhje me pikën e parë të këtyre dy qëllimeve legjitime, është e rëndësishme të theksohet se ‘të drejtat e të tjerëve’ mund të përfshijnë të drejtat e të tjerëve për të pasur një proces të rregullt. Mbrojtja e të drejtave të të tjerëve për të pasur një proces të rregullt, mund të justifikojë një ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes, nëse ndërhyrja në fjalë është ‘e parashikuar me ligj’ dhe ‘e nevojshme në një shoqëri demokratike’.

Ky përjashtim i së drejtës për lirinë e shprehjes për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve për një proces të rregullt është paraqitur para Gjykatës në çështjen e *News Verlags GmbH & Co.KG kundër Austrisë*.⁹⁸ Kërkuesi ishte një shtëpi botuese e një reviste që kishte publikuar raporte në lidhje me një seri letrash bombë që i dërgoheshin figurave publike në Austri, disa prej të cilëve u kishte shkaktuar dëmtime serioze. Raportet përfshinin një person të caktuar, i cili u arrestua dhe akuzua lidhur me sulmet dhe se ishte i lidhur politikisht me djathtën ekstreme. Në përgjigje të raporteve, ndaj individit në fjalë u mor një masë sigurimi urdhër ndalimi për të parandaluar kërkuesin në botimin e fotografive në kontekstin e procesit penal kundër tij.

Më pas, kompania kërkuese bëri një ankesë në lidhje me masën e ndalimit, duke ju referuar nenit 10 dhe çështja u paraqit para GJEDNJ-së. Gjykata konsideroi se masat e sigurisë ndaj kërkuesit përbënin një ndërhyrje në lirinë e tij të shprehjes, edhe pse nuk ishte ndaluar raportimi i rastit, por vetëm publikimi i fotografive. Gjykata ka konstatuar se neni 10 mbron jo vetëm thelbin e ideve dhe informacionit, por edhe formën në të cilën ato përcillen, për rrjedhojë kufizimet në formën e botimit të raporteve në rastin konkret (p.sh. ndalimi i publikimit të fotografive) ndërhynte në të drejtën e kërkuesit për tu shprehur lirisht. Gjykata vijoi më tej se ndërhyrja ishte caktuar në përputhje me një ligj specifik dhe se ndërhyrja ka ndjekur një ose më shumë qëllime legjitime. Për rrjedhojë, çështja kryesore që ngrihet konsistonte në faktin nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Gjykata theksoi rëndësinë e vëzhgimit të vendimeve të kontestuara, të cilat nuk duhen parë të veçuara, por duke pasur parasysh rastin në tërësi. Ajo vuri në dukje se ndërhyrja u ngrit në kontekstin e një lajmi të interesit të madh publik dhe në lidhje me një figurë publike. Ajo gjithashtu vuri në dukje funksionin thelbësor të shtypit në një shoqëri demokratike, e cila shtrihet në raportimin dhe komentimin e proceseve gjyqësore. Megjithatë, këto konsiderata duhet të jenë në ekuilibër me çdo rrezik që bie ndesh me procesin e rregullt dhe të drejtat e një personi për tu prezumuar i pafajshëm derisa të provohet fajësia e tij. Në dritën e fakteve se mediat

98 *News Verlags GmbH & Co.KG k. Austrisë*, Ap.. Nr. 31457/96, vendim i 11 janarit 2000. Ky arsyetim do të shqyrtohet më hollësisht në seksionin e mëposhtëm mbi lirinë e shprehjes dhe profesionit të ligjit.

e tjera kishin mundësi për të publikuar fotografitë dhe se ajo ka qenë e vetmja që ka ndërhyrë në të drejtat e individit në rastin në fjalë duke ndërthurrur fjalët me imazhet (dhe jo vetëm imazhe), Gjykata u shpreh se masa e marrë kundër publikimit të të gjitha imazheve ka shkuar përtej nevojës për të mbrojtur qëllimin legjitim të mbrojtjes së këtyre të drejtave. Ndërhyrja nuk ishte proporcionale dhe për rrjedhojë nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Si përfundim, ka pasur shkelje të nenit 10.⁹⁹

Rasti *News Verlags* që përshkruhet më sipër ilustron se sa i rëndësishëm është testi nëse një ndërhyrje është e nevojshme në një shoqëri demokratike, ku një kërkesë e këtij lloji është duke u gjykuar sipas nenit 10. Testi kërkon nga Gjykatat për të përcaktuar nëse ndërhyrja korrespondon me një «nevojë të ngutshme shoqërore», nëse ajo është në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur, dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për të justifikuar atë janë të rëndësishme dhe të mjaftueshme.¹⁰⁰ Shteteve Kontraktuese do tu lihet një hapësirë vlerësimi në zbatimin e testit, por kjo diferencë nuk është e pakufizuar dhe mbetet objekt i mbikëqyrjes së Gjykatës.

Nëse, nga njëra anë, çështja *News Verlags* është shembull i një ndërhyrje joproporcionale, dhe nga ana tjetër, çështja *BBC k. MB*¹⁰¹, është shembull i një ndërhyrje ndaj lirisë së shprehjes, që u konsiderua si proporcionale. Rasti në fjalë ka të bëjë me një urdhër parandalimi të transmetimit të një programi televiziv në lidhje me dhunimin e dyshuar ndaj gjashtë të burgosurve nga tre policë burgu, deri në përfundimin e gjykimit ndaj policëve të burgut. Komisioni¹⁰² vuri në dukje se gjykata vendase, e cila kishte dhënë urdhrin kishte vendosur një ekuilibër që përfshinte marrjen në konsideratë të rrezikut më tepër se minimal të paragjykimit të çështjes ndaj policëve të burgut në gjykimin e tyre. Duke theksuar se urdhri shtynte dhe nuk ndalonte transmetimin, Komisioni konstatoi se vendimi nuk kishte shkelur nenin 10.

Këto raste ilustronë faktin se gjykatat vendase do të duhet të jenë të kujdesshme dhe të arsyeshme në vlerësimin e ekuilibrit, kur ballafaqohen me çështje të ngjashme. Ata do të duhet të marrin në konsideratë shkallën në të cilën një ndërhyrje mund të jetë e nevojshme mbi lirinë e shprehjes për të mbrojtur të drejtat e të

99 Në mënyrë të ngjashme, në *Sunday Times k. MB (Nr. 1)*, Ap. Nr. 6538/74, vendimi i 26 prillit 1979, një shkelje e nenit 10, mbi një vendim gjyqësor për një artikull në lidhje me drogën *Thalidomide*. Dhoma e Lordëve të Mbretërisë së Bashkuar kishte dhënë vendimin pas konkludimit se artikulli kishte të bënte me një çështje të pakujdesisë së korporatës në një mënyrë që paragjykonte çështjen (albeit dormant) civile në gjykim.

100 *The Sunday Times k MB (nr. 1)*, Ap. Nr. 6538/74, vendimi i 26 prillit 1979, paragrafi 62.

101 *BBC k MB*, Ap. Nr. 25798/94, Vendim i Komisionit i 23 tetorit 1997.

102 Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut (Komisioni) ishte pjesë e sistemit të vjetër të Strasburgut. Ap. do të bëhen në Komision, i cili do të marrë disa nga rastet e Gjykatës.

tjerëve dhe të jetë e kujdesshme që të mos caktojë urdhra ose masa të tjera të cilat janë joproporcionale dhe shkojnë përtej nevojës në këtë drejtim. Për më tepër, nga ana e gjyqtarëve duhet të jepen arsye të rëndësishme dhe të mjaftueshme për vendosjen e masave të tilla.

(d) Ankimet në kuadër të nenit 6 në Lidhje me Lirinë e Shprehjes

Gjykata ka pranuar se sistemi i drejtësisë nuk mund të veprojë në boshllëk dhe se nuk do të ishte i përshtatshëm përjashtimi i gjithë diskutimeve të mëparshme ose aktuale për gjykimin e objektit të çështjes në shtyp ose në publik. Megjithatë, siç u përmend më lart, disa kufizime duhet të vendosen në përmbushje të interesit të administrimit të duhur të drejtësisë.¹⁰³ Prandaj, në qoftë se nuk janë vendosur kufijtë e duhur, në bazë të nenit 6 mund të lindin ankesa se ushtrimi i së drejtës për tu shprehur lirsht nga një person tjetër ka ndërhyrë në procesin e rregullt.

Një mënyrë që një ankesë të mund të ngrihet në kuadër të nenit 6 duhet që, ndërhyrja që mund të krijohet përmes publicitetit paragjykses të medias, e cila ndikon në opinionin publik dhe për rrjedhojë dhe në ata që do të vendosin për këtë çështje e në këtë mënyrë ndërhyrjen potencialisht në të drejtën e një personi për një proces të rregullt ose të drejtën për një proces gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm. Dallimi kryesor mes një ankesë të tillë sipas nenit 6 dhe një ankesë sipas nenit 10 është që fusha e zbatimit të nenit 6 është më e kufizuar. Kjo do të thotë se në shumicën e rasteve nuk është caktuar ekuilibri ose proporcionaliteti i testit që do të zbatohen në lidhje me ankesat e nenit 6, pas identifikimit të ndërhyrjes në këto të drejta.

Megjithatë, ndoshta në kuadër të natyrës së kufizuar të këtyre të drejtave të nenit 6 dhe ndërveprimit të tyre me nenin 10, Gjykata ka miratuar një koncept mjaft të kufizuar të asaj që përbën një ndërhyrje në lidhje me rastet rreth publicitetit potencialisht paragjykses lidhur me procesin gjyqësor. Ndërsa, Gjykata pranon se, në raste të caktuara, një publicitet i tillë mund të ndikojë negativisht në procesin e rregullt dhe përfshin përgjegjësinë e Shtetit, ajo ka kërkuar që publiciteti që përbën një “fushatë shtypi të ashpër” ka pasur qëllim pengimin e procesit të rregullt, duke përbërë në këtë formë ndërhyrje të parashikuar në të drejtat e nenit 6.¹⁰⁴ Kjo qasje e mundshme e bën relativisht të vështirë përcaktimin se publiciteti mediatik ka ndërhyrë në paanshmërinë e një gjykate, dhe kjo ka gjasa të jetë më e vështirë për të bërë këtë kur gjykata në fjalë përbëhet nga gjyqtarë profesionistë në krahasim me juritë ose ekspertët vlerësues.¹⁰⁵

¹⁰³ *Papon k Franës*, Ap. Nr. 54210/00, DA 15 nëntor 2001.

¹⁰⁴ *Anguelov k Bullgarisë*, Ap. Nr. 45963/99, DA 14 dhjetor 2004.

¹⁰⁵ *Craxi k Italisë*, Ap. Nr. 34896/97, vendim i 5 dhjetorit 2002.

Një mënyrë tjetër që mund të ngrihet një ankesë lidhur me nenin 6 në një media apo në kontekstin e lirisë së shprehjes është ndërmjet deklaratave që cenojë të drejtën e një personi për tu prezumuar i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Përsëri, një ndërhyrje në këtë të drejtë mund të çojë në shkelje, pa pasur nevojë për të marrë parasysh justifikimet e mundshme për ndërhyrjen, për shkak të natyrës së kufizuar të së drejtës. Rezultati është se autoritetet shtetërore, duke përfshirë dhe gjyqtarët, duhet të jenë shumë të kujdesshëm për të mos për ndjekur shembullin e disa prej oficerëve më të lartë të policisë franceze si në rastin e *Ribemont kundër Francës*.¹⁰⁶

Policia franceze në lidhje me çështjen e referuar nga kërkuesi, i cili as nuk ishte akuzuar si një nga të nxitësit për vrasje. Gjykata konstatoi se deklaratat e bëra ndaj kërkuesit fajësonin atë dhe inkurajonin publikun për të besuar se ai ishte fajtor dhe paragjykonin vlerësimin e fakteve nga autoriteti kompetent gjyqësor. Ka pasur një shkelje të të drejtës së kërkuesit për tu prezumuar i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Për sa kohë që kishte shkelje të nenit 6 (2) nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ekuilibri me lirinë e shprehjes.

Në dritën e kësaj jurisprudence, gjyqtarët kombëtare duhet të jenë të vetëdijshëm se në bazë të Konventës, ndaj Shtetit mund të ngrihet një detyrim pozitiv për të kontrolluar fushatat e ashpra për shtyp, të cilat mund të ndërhyjnë në të drejtën për një proces të rregullt sipas nenit 6. Përveç kësaj, ata duhet të kenë kujdes për të mbrojtur parimin e prezumimit të pafajësisë, jo më pak i rëndësishëm për tu siguruar se mënyra sesi shprehen nuk përbën një deklaratë fajësie të një personi derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

[V] Liria e Shprehjes dhe Profesionet e Ligjit

Ky seksion do të marrë parasysh nenin 10 në kontekstin specifik të profesionit të ligjit. Shumë parime dhe ide që janë përfshirë deri tani në këtë guidë janë të zbatueshme në rastin konkret. Në veçanti, ky seksioni është i lidhur me ndërveprimet e nenit 6/neni 10, edhe pse çdo kritikë e anëtarëve të profesionit ligjor do të lidhet me të drejtat e garantuara në nenin 8. Pavarësisht nga kjo mbivendosje, ashtu si me mediat, për shkak të rolit themelor që gjyqësori dhe avokatët luajnë në një shoqëri demokratike, u mendua se një seksion i tillë do të ishte i përshtatshëm.

¹⁰⁶ *Ribemont k. Francës*, Ap. Nr. 15175/89, vendim i 10 shkurtit 1995; shiko gjithashtu *Ergashev k. Rusisë*, Ap. Nr. 12106/09, vendim i 20 dhjetorit 2011.

(a) Kufijtë e kritikës ndaj gjyqësorit: ‘Garantimi i autoritetit dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor’

Është një fakt botërisht i ditur se shteti i së drejtës është parimi themelor i çdo demokracie dhe zbatimi i tij efektiv varet nga zbatimi rigoroz i ligjit nga ana e gjykatave. Shteti i së drejtës kërkon që pushteti gjyqësor të gëzojë besimin e popullit të cilit i shërben.

Për këtë qëllim, shtetet kanë interes të garantojnë paprekshmërinë e procesit gjyqësor, duke limituar kritikën për proceset gjyqësore të papërfunduara. Rëndësia e kësaj është e njohur në nenin 10 (2), që përfshin “garantimin e autoritetit dhe paanshmërinë e gjyqësorit” si një nga qëllimet legjitime që mund të justifikojë një ndërhyrje në të drejtat e mbrojtura në nenin 10 (1).

Gjykata ka theksuar se termi “pushteti gjyqësor” përbëhet nga institucionet e drejtësisë së ekzekutivit, si dhe gjyqtarët në cilësinë e tyre zyrtare. “Autoriteti i gjyqësorit”, nga ana e tij, përfshin “idenë se gjykatat janë pranuar nga publiku si, shkalla e përshtatshme për konstatimin e të drejtave dhe detyrimeve ligjore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” në lidhje me këto të drejta dhe detyrime.¹⁰⁷ Në këto raste, Gjykata do të shikojë më nga afër kontekstin në të cilin janë thënë ose shkruar fjalët, sidomos qëllimit që i ka shërbyer shprehja e këtyre fjalëve.¹⁰⁸

Gjykata ka konstatuar se qëllimi i ndërmarrë nga pushteti gjyqësor mund të jetë i nevojshëm për të mbrojtur atë nga kritikën destruktive, të cilat në thelb janë të pabazuara, veçanërisht nisur nga fakti se gjyqtarët janë në një pozicion që i përjashton ata ndaj mundësisë për t’ju përgjigjur kritikave¹⁰⁹. Për shembull, lidhur me pretendimet e paragjyqimeve, Gjykata është shprehur se ata kanë nevojë për një bazë shumë të fortë faktike.¹¹⁰ Megjithatë, si gjithmonë, ajo lidhet me ekuilibrin e duhur, dhe për rrjedhojë institucionet publike nuk mund të jenë të përjashtuara nga kritikën dhe shqyrtimet. Kështu, Gjykata bën një dallim të qartë midis fyerjes dhe kritikës.¹¹¹ Në rastin e fyerjeve, Gjykata është shprehur se dënimi i duhur nuk përbën shkelje të nenit 10.

Kur provohej se pretendimet e ngritura kishin baza të forta faktike, Gjykata konstatonte shkelje.¹¹² Në mënyrë të njëjtë, komente që nuk ishin të rënda apo fyese,

107 *Sunday Times k Mbretërisë së Bashkuar (Nr.1)*, Ap. Nr. 6538/74, vendim i 26 prillit 1979, paragrafi 55.

108 *Thorgeirson k Islandës*, Ap. Nr. 13778/88, vendim i 25 qershorit 1992.

109 *Falter Zeitschriften k Austrisë*, Ap. Nr. 3084/07, vendim i 27 majit 2003.

110 *Prager dhe Oberschlick k Austrisë*, Ap. Nr. 15974/90, vendim i 26 prillit 1995.

111 *Skalka k Polonisë*, Ap. Nr. 43425/98, vendim i 27 majit 2003.

112 *De Haes dhe Gijssels k Belgjikës*, Ap. Nr. 19983/92, vendim i 24 shkurtit 1997.

por që demonstroi një mungesë të caktuar respekti në drejtim të Gjykatës Kushtetuese, nuk duhet të kishin përfunduar me dhënien e një dënimi.¹¹³ Gjykata i ka dhënë rëndësi faktit se deklaratat akuzuese të bëra lidhur me një vendim të caktuar, ishin pjesë e një botimi akademik dhe të shkruara në kontekstin e debatit intensiv publik për çështjet e parshikuara në procedurë.¹¹⁴ Për më tepër, kur një artikull mund të ketë parajgykuar rezultatin e procesit gjyqësor duke shprehur një opinion lidhur me fajsinw, interesi në garantimin e autoritetit dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor, do të thotë se detyrimi pwr pagimin e një gjobe nuk përbënte shkelje të nenit 10.¹¹⁵ Këtu përsëri flitet për ndërveprimin midis nenit 10 dhe nenit 6.

Së fundi, parë nga qasja që Gjykata ka bërë në çështjen *Morice k. Francës* (ku është konstatuar shkelje) se Gjykata do të kërkojë që ndërhyrja të jetë e justifikuar nga nevoja për të garantuar “autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor” në fakt i shërben këtij qëllimi.¹¹⁶

(b) Liria e Shprehjes së Gjyqësorit dhe Avokatët

Për sa i përket lirisë së shprehjes së anëtarëve të lartë të gjyqësorit, pritet që të tregojnë maturi në rrethana ku autoriteti dhe paanshmëria e gjyqësorit mund të vihet në pikëpyetje. Megjithatë, çdo ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një gjyqtari në këtë pozicion kërkon një shqyrtim të ngushtë.

Gjykata ka konstatuar, se në mënyrë që të parandalojë ‘dekurajimin’ e gjyqtarëve, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në debatin publik për efikasitetin e institucioneve gjyqësore, ata duhet të lejohen të flasim lirisht (dhe madje edhe me një shkallë të caktuar ekzagjerimi) në lidhje me çështjet e rëndësishme të madhe publike.¹¹⁷ Gjykata ka arsyetuar se edhe nëse shprehja e qëndrimeve të caktuara nga ana e gjyqtarit ka luajtur një rol të caktuar në largimin e tij/saj nga detyra, nëse kjo nuk ishte arsyeja *ekskluzive ose mbizotëruese* për largimin, neni 10 nuk mund të mos ishte shkelur. Për shembull, aftësia e gjyqtarit për të ushtruar si duhet detyrat gjyqësore është një arsye e ligjshme për ta hequr një gjyqtar.¹¹⁸

Për sa i përket lirisë së shprehjes së avokatëve, Gjykata është shprehur se për shkak se ata luajnë një rol qendror në administrimin e drejtësisë, ata duhet të gëzojnë

113 *Amihalachioaie k Moldovisë*, Ap. Nr. 60115/00, vendim i 20 prillit 2004.

114 *Mustafa Erdogan k Turqisë*, Ap. Nr. 346/04 & 39779/04, vendim i 27 majit 2014.

115 *Worm k Austrisë*, Ap. Nr. 22714/93, vendim i 29 gushtit 1997.

116 *Morice k Francës*, Ap. Nr. 29369/10, vendim i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015, paragrafi 170.

117 *Kudeshkina k Rusisë*, Ap. Nr. 29492/05, vendim i 26 shkurtit 2009.

118 *Harabín k Sllovakia*, Ap. Nr. 58688/11, vendim i 20 nëntorit 2012.

një mbrojtje të madhe. Kjo mbrojtje ju akordohet atyre, kur janë duke vepruar në kuadër të mbrojtjes së të akuzuarit në një proces penal.¹¹⁹ Kështu, ndërsa ajo lejohet që të kufizojë shprehjen e kritikës së gjykatave në rrethana të caktuara, në mënyrë që të mbrojë pavarësinë e tyre, kritika e shprehur në gjykatë e bërë nga përfaqësues ligjor i tjetrit, normalisht nuk duhet të konsiderohet si bazë për kufizimin e lirisë së shprehjes.

Kështu, Gjykata ka theksuar se vetëm në rrethana të jashtëzakonshme një mbrojtës, i cili vepron në gjykatë dhe gjatë mbrojtjes së klientit të tij, duhet të jetë subjekt i kufizimit të lirisë së tij të shprehjes.¹²⁰ Gjykata ka miratuar këtë qasje, në mënyrë që të parandalojë ‘dekurajimin’ në performancën e avokatëve dhe deyrave të tyre si mbrojtës¹²¹. Për shembull, Gjykata konstatoi se edhe një këshillë e thjeshtë nga një këshill disiplinor ndaj avokatit mbrojtës lidhur me pretendimin se klienti i tij ishte vënë nën presionin e një oficeri gjyqësor përfundoi në ‘dekurajimin’ e pajustificuar.¹²²

Megjithatë, në rrethana të caktuara, për shembull kur ndjek qëllime legjitime, masat disiplinore të vendosura ndaj avokatëve nga institucionet përgjegjëse mund të jenë të pranueshme.¹²³ Për shembull, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 10, në rastin kur një avokat ishte dënuar dhe gjobitur për shpifje pas një deklarate për shtyp ku akuzonte policinë për shkelje të rënda dhe brutalitet. Gjykata konstatoi se në pretendimet e ngritura mungonte baza faktike dhe nuk ishte bërë me qëllim mbrojtja e të drejtave të klientëve të saj.¹²⁴

Në mënyrë të barabartë, duke përdorur mediat si mjet për zgjidhjen e çështjeve në gjykim, Gjykata nuk ka mundësi të garantojë mbrojtjen sipas nenit 10. Për shembull, dalja e provës në shtyp, kur ajo ishte përjashtuar nga dosja e çështjes dhe ishte mbajtur në të për të justifikuar vendosjen e gjobës ndaj një avokati.¹²⁵ Megjithatë, tanimë kur një raport i ekspertëve ishte vënë në dispozicion të publikut, Gjykata konstatoi se autoritetet vendase kishin dështuar në vendosjen e ekuilibrit të duhur, pasi nuk kishte prova se deklaratat e avokatit në shtyp kanë pasur ndonjë ndikim negativ në proces.¹²⁶

119 *Morice k Francës*, Ap. Nr. 29369/10, vendim i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015.

120 *Nikula k Finlandës*, Ap. Nr. 31611/96, vendim i 21 marsit 2002.

121 *Kyprianou k Qipros*, Ap. Nr. 73797/01, Dhomë e Madhe vendim i 15 dhjetorit 2005.

122 *Steur k Holandës*, Ap. Nr. 39657/98, vendim i 28 tetorit 2003.

123 *Schöpfer k Zvicrës*, Ap. Nr. 25405/94, vendim i 20 majit 1998.

124 *Coutant k Francës*, Ap. Nr. 17155/03, vendim i 24 janarit 2008.

125 *Furuholmen k Norvegjisë*, Ap. Nr. 53349/06, vendim i 18 marsit 2010.

126 *Morice k Francës*, Ap. Nr. 28198/09, vendim i 15 dhjetorit 2011.

[VI] Përfundime: Liria e Shprehjes në Evropë –Përse është në Rend të Ditës?

Ky udhëzues ka shqyrtuar, në mënyrë të pavarur dhe marrë së bashku, të drejtën për lirinë e shprehjes, të drejtën për respektimin e jetës private dhe të drejtën për një proces të rregullt. E drejta e lirisë së shprehjes dhe e drejta për jetë private janë dy të drejta të kualifikuara sipas Konventës. Kjo kërkon që gjyqtarët duke pasur parasysh kërkesën e tyre duhet të marrin në konsideratë jo vetëm nëse ka pasur një ndërhyrje me një ose dy prej tyre, por edhe nëse një ndërhyrje e tillë është e justifikuar. Për më tepër, ky udhëzues ka marrë parasysh aspekte të ndryshme të marrëdhënieve të të drejtës së lirisë së shprehjes.

Fushat e zbatimit të këtyre tre të drejtave mbivendosen. Veçanërisht, ato shpesh zbatohen për të garantuar interesat konkurruese në rastet e përfshirjes së medias dhe lirisë e shtypit. Kjo është një fushë në të cilën autoriteteve kombëtare, përfshi këtu gjykatave të brendshme, u kërkohet nga Konventa për të bërë një vlerësim të kujdesshëm të ekuilibrit. Vendosija e ekuilibrit duhet të shqyrtojë dhe respektojë interesat potencialisht kontradiktore në fjalë, në kuadër të kërkesave të Konventës dhe masave mbrojtëse që shtrihen për shtypin, për sistemin e drejtësisë dhe për ata që janë subjekt i vëmendjes mediatike.

Gjithashtu, kjo guidë shqyrton çështjen specifike të së drejtës së profesionit të ligjit, duke përfshirë avokatët dhe gjyqtarët, lirinë e shprehjes, dhe zbatimin e justifikuar të nenit 10 (2) për të “garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”. Kjo gjithashtu kërkon që autoritetet kombëtare të ekuilibrojnë interesat konkurruese.

Kuptimi për qasjen e Gjykatës mbi nenin 10 është i domosdoshëm, sidomos duke pasur parasysh se ngjarjet e fundit kanë ngritur pyetje në lidhje me zbatimin e duhur të lirisë së shprehjes në shoqëritë demokratike. Për shembull, vrasja e gazetarëve Charlie Hebdo në Paris më 7 janar 2015 ngriti disa çështje në kontekstin e të drejtës së lirisë së shprehjes. Këto përfshijnë mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve, qëllimin e pambrojtur të gjuhës së urrejtjes dhe gjithashtu çështjet në lidhje me kufijtë e gjuhës së pranueshme në shoqëritë bashkëkohore evropiane, në të cilën gëzimi i lirisë së dikujt ndikon në lirinë e të tjerëve për shkak të rritjes së diversitetit dhe bashkë-ekzistencës së kulturave. Sot, në kontekstin e punësimit ekziston edhe çështja e përdorimit të mediave sociale dhe internetit. A mundet një punëdhënës të reagojë ndaj përdorimit të ‘pamatur’ të internetit nga punëmarrësi i tij?

Shtetet Evropiane, duke përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, janë të

detyruara të parandalojnë shkelje të nenit 10, dhe për më tepër, t'ju përgjigjen kërcënimeve kur këto të fundit ndalojnë zbatimin e detyrimeve të tyre pozitive. Në përputhje me nenin 10, siç është treguar në këtë guidë, në mënyrë të vazhdueshme do t'ju kërkohetë autoriteteve vendase për të vendosur këtë liri në ekuilibër me të drejtat e tjera të Konventës. Për këtë arsye është e rëndësishme që caktimi i ekuilibrave është thelbësor. Në fund të fundit ky ishte dhe qëllimi i përgatitjes së kësaj guide.

Për më tepër, nga analiza e mësipërme del qartë se ndërsa të gjitha autoritetet vendase kanë një rol për të luajtur në zbatimin e Konventës për qytetarët, gjyqtarët vendas ndodhen në një pozitë të veçantë, në faktin që ata janë shkalla e fundit për vlerësimin e proporcionalitetit, përpara se kërkesa ti drejtohet GJEDNJ-së për shkak të një ndërhyrje të pajustificuar. Pra, është, e domosdoshme që gjyqtarët të kuptojnë natyrën e vlerësimit të proporcionalitetit, sepse nëse ajo mund të provohet se është kryer sipas parashikimeve të Konventës, nuk ka gjasa që Shteti të gjendet para shkeljeve të Konventës.

Ashtu siç është përsëritur në gjithë këtë guidë, mbrojtja e lirisë së shprehjes është një element thelbësor i një shoqërie demokratike, duke bërë hetime të shpejta, efikase, të paanshme dhe të plota në të gjitha shkeljet kryesore të pretenduara. Për rrjedhojë, gjyqtarët në mënyrë paraprake luajnë një rol kryesor, dhe mbajnë përgjegjësi për garantimin dhe mbrojtjen e vlerave demokratike kur vendosin mbi çështjet që lidhen me lirinë shprehjes.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Përmbledhje Vendimesh

Evidentimi i përgjegjësisë së një portali interneti për komentet e papërshtatshme të bëra nga një palë e tretë ishte një kufizim i justifikuar dhe proporcional i lirisë së shprehjes

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN DELFI AS k. ESTONISË

(Kërkesa nr. 64569/09)

16 qershor 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Delfi AS, është një kompani aksionere publike e regjistruar në Estoni. Ajo ka në pronësi një prej portaleve më të mëdha të lajmeve në vend.

Në janar 2006, Delfi publikoi një artikull në website-in e saj ku diskutoheshin vedimet e një kompanie traqetesh për të ndryshuar intenerarin e disa prej traqeteve të saj në drejt disa ishujve. Ndryshimi derivoi shtyrjen e hapjes së rrugëve të akullit – të cilat siguronin një lidhje me të shpejtë dhe të lirë me ishujt krahasuar me kompaninë e shërbimeve – të cilat ishin thyer nga traqetet.

Në fund të artikullit lexuesit kishin mundësi të linin komentet e tyre dhe të shihnin komentet e personave të tjerë përdorues të faqes. Shumë lexues kishin shkruar komente tepër ofenduese ose kërcënuese për operatorin e linjës së traqeteve dhe pronarin e tij. Me kërkesë të avokatëve të pronarit të kompanisë, Delfi fshiu komentet ofenduese rreth gjashtë javë pas publikimit të tyre në mars 2006.

Në prill 2006, pronari i kompanisë së traqeteve ngriti një padi kundër Delfi-it dhe arriti të fitojë gjyqin në qershor 2008. Gjykata estoneze vlerësoi se komentet ishin shpifje ndaj kompanisë dhe se portali Delfi ishte përgjegjës për to. Kompanisë së traqeteve iu akordua një dëmshpërblim prej 5,000 koronash (rreth €320). Në qershor 2009, Gjykata e Lartë e Estonisë rrëzoi apelimin e Delfi-t duke kundërshtuar argumentin se në zbatim të Direktivës 2000/31/KE mbi Tregëtinë Elektronike roli i portalit si një ofrues shërbimesh informacioni ose ruajtës të dhënash ishte tërësisht teknik, pasiv dhe neutral, duke nënvizuar se portali ushtronte kontroll mbi publikimet dhe komentet e bëra në të.

2. Vendimi i Gjykatës

Kompania kërkuese u ankua se deklarimi i saj përgjegjëse për komentet e postuara nga lexues të portalit të saj të lajmeve në internet cenonte lirinë e saj të

shprehjes garantuar nga neni 10 i KEDNJ. Qeveria estoneze e kundërshtoi këtë argument. Më 10 tetor 2013, Dhoma e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se në rastin objekt gjykimi nuk kishte pasur shkelje të Konventës. Me kërkesë të kompanisë Delfi çështja iu referua Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43 të Konventës.

Neni 10

Nuk u kundërshtua se vendimi i gjykatave vendase kishte cenuar lirinë e shprehjes së kompanisë Delfi dhe se ky kufizim kishte qëllim legjitim për të mbrojtur reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve.

Palët nuk binin dakord nëse kjo ndërhyrje ishte “e parashikuar në ligj”. Dhoma e Madhe vërejti se është detyrë e gjykatave vendase të zgjidhnin çështjet e interpretimit të legjislacionit vendas. Gjykata nënvizoi se nuk mund të adresojë çështje në interpretim të legjislacionit të BE-së dhe mund të shprehej vetëm mbi faktin nëse zbatimi i legjislacionit vendas nga Gjykata e Lartë në rastin konkret kishte qenë i parashikueshëm. Gjykata vërejti se kompania Delfi si botues profesional që drejtonte një portal lajmesh online duhet të kishte kërkuar konsulencë ligjore. Për më tepër, shqetësimi publik ishte shprehur edhe përpara publikimit të komenteve në fjalë dhe në shtator 2005 Ministri i Drejtësisë kish vërejtur se viktimat e fyerjeve duhet të ngrinin padi për shpërblim dëmi kundër kompanisë kërkuese.

Dhoma e Madhe vlerësoi se kompania Delfi kishte qenë në një pozitë të tillë sa të parashikonte riskun dhe pasojat që do të derivonin nga aktiviteti i saj. Për rrjedhojë, ndërhyrja në të drejtën e saj për t’u shprehur lirisht ishte “e parashikuar në ligj”.

Gjykata vërejti se duhej shqyrtuar nëse përgjegjësia që i adresohet kompanisë kërkuese për komentet e postuara nga palë të treta shkelte lirinë e saj për të dhënë informacion garantuar nga neni 10 i Konventës.

Dhoma e Madhe shqyrtoi nëse përgjegjësia e kompanisë ishte përcaktuar mbi fakte relevante dhe të mjaftueshme, duke iu referuar katër aspekteve kyçe: konteksti i komenteve; dhënia e përgjegjësisë autorëve të komenteve; hapat e ndërmarra nga Delfi për të ndaluar ose fshirë komente diskretituese; si edhe pasojat që kishin derivuar në llogari të kompanisë pas proceseve gjyqësore në Estoni.

Së pari, duke iu referuar kontekstit, duhet të merret në konsideratë natyra ekstreme e komenteve dhe fakti që kompania Delfi ishte një menaxhuese profesionale e një portali lajmesh, i cili synoi të tërhiqte një numër të madh komentesh. Për më tepër, Delfi kishte një interes ekonomik në postimin e komenteve. Dhoma

e Madhe vërejtë se paravërsisht se kompania nuk ishte autore e këtyre komenteve të postuara ajo kishte kontroll të plotë në menaxhimin e tyre.

Së dyti, Delfi nuk kishte siguruar një mekanizëm për të bërë të mundur, që përgjegjësia të binte mbi autorët e komenteve. Lexuesit mund të komentonin lajmet e publikuara pa ju nënshtruar asnjë lloj regjistrimi të emrave të tyre dhe njohja e identitetit të tyre nuk ishte e sigurtë.

Së treti, masat e marra nga kompania kërkuese për të ndaluar ose fshirë pa vonesë komentet në fjalë, kishin qenë të pamjaftueshme.

Shënimi i bërë në faqen e Delfit, se autorët e komenteve ishin përgjegjës për to duke u shprehur se nuk lejoheshin komentet kërcënuese ose fyese, kishte dështuar në parandalimin e shprehjes së hyrjerve dhe kërcënimeve. Sistemi automatik i filtrimit të fjalëve dhe sistemi i njoftimit kishin dështuar në filtrimin e këtyre komenteve.

Dhoma e Madhe vlerësoi se nuk kishte qenë një masë joproporcionale detyrimi i kompanisë për të fshirë nga faqja e internetit menjëherë dhe pa vonesa komente të cilat ishin haptazi në shkelje të ligjit, kjo madje edhe pa kërkesë të viktimave ose palëve të treta të cilat objektivisht kishin mundësi më të pakta për ti monitoruar këto komente, nëse krahasohen me vetë kompaninë.

Në përfundim, Dhoma e Madhe vlerësoi se pasojat e fajësisë së kompanisë kërkuese kishin qenë minimale. Gjoha prej 320 euro nuk kishte qenë e tepruar dhe popullariteti i portalit dhe personave që komentojnë në të nuk ishte ndikuar nga kjo situatë. Për më tepër, pas çështjes Delfi rezultati kishte qenë i prekshëm për operatorët e tjerët të internetit, të cilët kanë fshirë gjithashtu komente ofenduese për çështje të tjera, por nuk janë urdhëruar për të paguar kompensim.

Dhoma e Madhe vendosi se përfundimi i gjykatave estoneze për shpalljen përgjegjëse të kompanisë kërkuese kishte qenë një kufizim proporcional në lirinë e shprehjes së portalit. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN AHMET YILDIRIM k. TURQISË

(Kërkesa nr. 3111/10)

18 dhjetor 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Ahmet Yildirim, është një shtetas turk i lindur në vitin 1983 dhe banues në Stamboll, Turqi.

Ai ka në pronësi dhe drejton një faqe interneti, në të cilën publikon punën e tij akademike dhe pikëpamjet e tij mbi tema të ndryshme. Kjo faqe ishte krijuar duke përdorur shërbimet e ofruara nga një faqe Google për këtë proces.

Më 23 qershor 2009, Dhoma Penale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Denizlisë urdhëroi bllokimin e një website-i në kuadër të procedimit penal ndaj pronarit të tij, i cili akuzohej se kishte fyer kujtimin e Ataturkut. Urdhëri iu komunikua për ekzekutim Drejtorisë së Telekomunikimit dhe Teknologjisë së Informacionit (DTTI). Megjithatë, më 24 qershor 2009, si rezultat i vështirësive në zbatimin e këtij urdhëri, me kërkesë të DTTI-së gjykata vendase ndryshoi vendimin e parë, duke urdhëruar bllokimin e aksesit për të gjitha faqet Google. Sipas DTTI kjo ishte mënyra e vetme për të bllokuar aksesin në website-in, që kishte publikuar komentet ofenduese.

Si pasojë e vendimit të mësipërm kërkuesi e kishte të pamundur të aksesonte faqen e tij të internetit. Më 1 korrik 2009, ai kërkoi që urdhëri bllokues të shfuqizohej në lidhje me website-in e tij, sepse ky i fundit nuk kishte aspak të bënte me faqen në të cilën ishin publikuar komentet ofenduese.

Më 13 korrik 2009, Gjykata e Shkallës së Parë rrëzoi çështjen e ngritur nga kërkuesit duke vërejtur se veprimi i ndërmarrë kishte qenë masa e vetme për të bllokuar website-in ofendues.

Më 25 prill 2012, kërkuesi ende nuk kishte mundësi të aksesonte faqen e tij të internetit pavarësisht se procedimi penal ndaj pronarit të website-it që përmbante komente ofenduese ishte pushuar më 25 mars 2011 për shkak të pamundësisë për të përcaktuar identitetin e tij.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se fakti, që ai nuk ishte në gjendje të aksesonte faqen e tij të

internetit për shkak të një mase të urdhëruar në kuadër të një procedimi penal, që nuk lidhet me të, kishte cenuar lirinë e tij të shprehjes në bazë të nenit 10 të Konventës. Në veçanti, ai argumentoi se masa e ndërmarrë kishte shkelur të drejtën e tij për të shkëmbyer informacione dhe ide.

Neni 10

Gjykata vërejtë se Faqet Google ishin një shërbim i projektuar për të lehtësuar krijimin dhe ndarjen e website-ve brenda një grupi dhe për këtë arsye përbënin një mjet për të ushtruar lirinë e shprehjes. Ky konstatim u mbështet në faktin se si përmbajtja e informacionit dhe mjetet e shpërndarjes së tij mbrohen nga neni 10. Gjykata nënvizoi se çdo ndërhyrje në mjetet e shpërndarjes së informacionit ndikon në të drejtën për të marrë dhe shpërndarë informacion.

Sipas Gjykatës, “thelbi” i rastit në fjalë ka të bëjë me efektin e masës parandaluese të miratuar në kuadër të procedimit penal, që po kryhej për pronarin e website-it me përmbajtje ofenduese. Vendimi i 24 qershorit 2009, derivoi pamundësinë e kërkuesit për të aksesuar faqen e tij të internetit pa përdorur Faqet Google, ndërkohë që faqja e internetit të kërkuesit nuk ishte pjesë e procedimit penal. Për rrjedhojë, ky veprim konstituonte një kufizim të publikimeve.

Gjykata pranoi se masa e ndërmarrë nuk ishte një ndalim i përgjithshëm, por më tepër një kufizim për të aksesuar internetin. Megjithatë, efekti i limituar i këtij kufizimi nuk ka pakësuar rëndësinë e tij, veçanërisht në një kohë kur interneti është bërë një nga mjetet kryesore të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe informimit. Ky fakt detyroi Gjykatën të konstatonte se masa në fjalë përbënte “ndërhyrje të autoriteteve publike” në të drejtën e kërkuesit për t`u shprehur lirisht, pjesë e së cilës janë dhe liria për të shkëmbyer informacion dhe ide. Kjo ndërhyrje do të derivojë në shkelje të nenit 10, nëse ajo nuk ishte e “parashikuar me ligj”, ndiqej nga një ose më shumë qëllime të ligjshme të përmendura në nenin 10 (2) dhe marrja e saj është “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për arritjen e qëllimeve në fjalë.

Kushti “të jetë e parashikuar me ligj”, kërkon që masa e ndërmarrë të jetë bazuar në të drejtën e brendshme dhe të jetë e aksesueshme për personin në llogari të të cilit kryhet, duke përfshirë këtu aftësinë e individëve për të parashikuar pasojat e saj. Gjithashtu, masa e ndërmarrë duhet të jetë në përputhje me frymën e shtetit të së drejtës.

Në rastin konkret objekt gjykimi, masa e ndërmarrë ishte parashikuar në legjislationin vendas. Një rregullim ligjor do të konsiderohet i parashikueshëm në qoftë se ai është formuluar me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme, duke parandaluar ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike dhe duke i lejuar individëve për të rregulluar sjelljen e tyre në përputhje me rrethanat.

Në mënyrë të veçantë, për kufizimet e mëparshme, Gjykata vuri në dukje se kuadri ligjor kishte nevojë për të siguruar kontroll të fortë mbi fushën e ndalimeve dhe mbikqyrjes së efektshme ligjore për të parandaluar çdo abuzim të pushtetit.

Gjykata vërejti se as faqja e kërkuesit, as Faqet e tjera Google për sa përfshiheshin në fushëveprimin e nenit 8 (1) të ligjit nr. 5651, pasi në çështjen në fjalë nuk diskutohet ligjshmëria e përmbajtjes së tyre, siç kërkohet nga dispozita e sipër cituar. Vetë ligji nuk autorizonte bllokimin e një domain-i të tërë të internetit siç është Google.

Gjithashtu, Gjykata vërejti se ligji vendas i kishte dhënë kompetenca të gjera DT-TI-së si një organ administrativ, fillimisht në zbatim e një urdhri bllokues lëshuar vetëm për një faqe interneti dhe më pas duke e zgjeruar fushën e veprimit të këtij urdhëri. Për më tepër, kur gjykata vendase kishte vendosur për të bllokuar të gjithë aksesin në Sitet Google, ky institucion nuk kishte shqyrtuar nëse mund të merrej një masë me ndikim më të kufizuar për të bllokuar në mënyrë specifike aksesin vetëm për website-in i cili ishte objekt i një procedimi penal.

Gjykata vërejti se nuk do të shqyrtojë interesat e ndryshme, që ishin në rrezik në rastin konkret, për shkak se ligji nuk e kërkon një gjë të tillë. Gjykata nënvizoi se Konventa i kërkon gjykatave të vendeve anëtare të marrin parasysh faktin, se duke bërë një gamë të gjerë informacioni të pa aksesueshëm të drejtat e përdoruesve të internetit do të kufizohen në mënyrë thelbësore.

Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja e derivuar nga zbatimi i nenit 8 të ligjit nr. 5616 nuk përmbush kërkesat e parashikueshmërisë në bazë të Konventës dhe nuk i ofron kërkuesit nivelin e duhur të mbrojtjes, që i duhet garantuar atij në një shoqëri demokratike. Më tej, Gjykata arriti në përfundimin se masa e marrë nga autoritetet ka prodhuar efekte arbitrare dhe nuk mund të pretendohet se ajo ka pasur për qëllim vetëm të bllokonte aksesin në website-in që përmbante shkrime ofenduese, pasi ajo bllokoi të gjitha Faqet Google. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi se Turqia duhet t'i paguante kërkuesit shumën prej 7,500 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 1,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

VENDIMI NË ÇËSHTJEN VEJDELAND DHE TË TJERËT k. SUEDISË

(Kërkesa nr. 1813/07)

9 shkurt 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, Tor Fredrik Vejdeland, Mattias Harlin, Björn Tang dhe Niklas Lundström, janë shtetas suedezë, të lindur respektivisht në 1978, 1981, 1987 dhe 1986. Të gjithë kërkuesit banojnë në Suedi.

Në dhjetor të vitit 2004, si pjesë e aktiviteteve të tyre për Rininë Kombëtare, kërkuesit shpërndanë rreth 100 fletëpalosje në dollapët e nxënësve të një shkolle të mesme. Fletëpalosjet shprehnin se homoseksualiteti ishte një “tendencë devijante seksuale”, kishte “një efekt moralisht shkatërrues për thelbin e shoqërisë” dhe ishte përgjegjës për zhvillimin e HIV dhe AIDS.

Kërkuesit pretenduan se në shpërndarjen e fletëpalosjeve, ata nuk kishin për qëllim të shprehnin përbuzje për homoseksualët si grup. Ata deklaruan se qëllimi i tyre ishte të ndiznin një debat në lidhje me mungesën e objektivitetit në sistemin arsimor suedez. Më 6 korrik 2006, Gjykata e Lartë suedeze dënoi kërkuesit për veprën penale të agjitacionit kundër një grupi kombëtar apo etnik. Shumica e gjyqtarëve çmuan se nxënësit nuk e kishin pasur të mundur të refuzonin fletëpalosjet dhe se qëllimi për të informuar nxënësit me argumente për një debat të tillë, mund të ishte arritur pa përdorur deklaratat fyese.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se dënimi i dhënë për llogari të tyre nga Gjykata e Lartë për veprën penale të agjitacionit kundër një grupi kombëtar apo etnik përbënte shkelje të lirisë së shprehjes në bazë të nenit 10 të Konventës. Ata më tej pretenduan se ishin dënuar pa ligj në kundërshtim me nenin 7 të Konventës.

Neni 10

Kërkuesit u dënuan për agjitacion kundër një grupi kombëtar apo etnik, në përputhje me parashikimet ligjore të Kodit Penal të Suedisë. Prandaj, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja në lirinë e tyre të shprehjes kishte qenë mjaft e qartë dhe e parashikueshme duke përmbushur kështu kriterin “e parashikuar me ligj” në kuptim të Konventës. Ndërhyrja i kishte shërbyer një qëllimi legjitim, përkatësisht

Gjykata u dakordësua me argumentimin e Gjykatës së Lartë suedeze, se edhe nëse qëllimi i kërkuësve për të nisur një debat për mungesën e objektivitetit të edukimit në shkollat suedeze mund të cilësohet si një qëllim i pranueshëm, vëmendje i duhet kushtuar gjuhës së përdorur në formulimin e informacionit, që përmbanin fletëpalosjet. Këto fletëpalosje deklarorin se homoseksualiteti ishte një “tendencë devijimi seksual”, kishte “një efekt moralisht shkatërrues” në shoqëri dhe ishte përgjegjës për zhvillimin e viruseve HIV dhe AIDS. Fletëpalosjet më tej pohonin se “lobi homoseksual” u përpoq të trajtonte si të pa rëndësishme pedofilinë. Këto deklarata përbënin akuza serioze dhe të dëmshme, madje edhe në qoftë se ato nuk ishin një thirrje e drejtpërdrejtë për ndërmarrjen e veprimeve të urrejtjes. Gjykata theksoi se diskriminimi në bazë të orientimit seksual ishte po aq serioz sa diskriminimi në bazë të “racës, origjinës apo ngjyrës”.

Duke pranuar të drejtën e kërkuësve për të shprehur idetë e tyre, Gjykata e Lartë kishte vlerësuar se fletëpalosjet përmbanin deklarata të panevojshme dhe ofenduese. Ajo kishte theksuar më tej se kërkuësit u kishin imponuar nxënësve marrjen e fletëpalosjeve duke i lënë ato në dollapët e tyre. Gjykata nënvizoi se nxënësit ishin në një moshë të ndikueshme e të ndjeshme dhe se shpërndarja e fletëpalosjeve kishte ndodhur në një shkollë, të cilën nuk e kishin ndjekur asnjë nga kërkuësit dhe ku ata nuk kishin akses lirisht.

Për tre nga kërkuësit ishin dhënë dënime me kusht të kombinuara me gjoba, që varionin nga 200 deri në 2,000 euro. Ndërkohë, edhe kërkuësi i katërt u dënua me kusht. Gjykata nuk vlerësoi se këto dënime ishin të tepruara për rrethanat e veprës penale të kryer nga kërkuësit, për të cilën parashikohej një dënim nga një deri në dy vjet burgim.

Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja në ushtrimin e të drejtës së kërkuësve për t`u shprehur lirisht ishte konsideruar në mënyrë të drejtë nga autoritetet suedeze si e nevojshme në një shoqëri demokratike, për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve. Gjykata arriti në përfundimin se në këtë rast nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 7

Duke pasur parasysh konstatimin e bërë në kuadër të nenit 10 të Konventës, ku masa e kundërshtuar u cilësua si e “parashikuar me ligj”, Gjykata e shpalli ankimin e kërkuësve sipas nenit 7 të Konventës të papranueshme, meqenëse ishte haptazi i pabazuar.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN FATULLAYEV K. AZERBJAXHANIT

(Kërkesa nr. 40984/07)

22 prill 2010

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Z. Fatullayev, ka lindur në vitin 1976 dhe jeton në Baku. Ai ishte themelues dhe kryeredaktor i dy gazetave të njohura gjerësisht për publikimin e artikujve kritikues ndaj qeverisë dhe zyrtarëve publikë. Ai aktualisht është duke vuajtur një dënim me burgim.

Seti i parë i procedimeve penale lidhet me një artikull të botuar në prill 2005. Deklaratat e bëra në këtë artikull ndryshonin nga versioni gjerësisht i pranuar në lidhje me ngjarjet në qytetin Khojaly gjatë luftës në Nagorno-Karabakh, sipas të cilit qindra civilë azer u vranë nga forcat e armatosura armene me ndihmën e ushtrisë ruse. Katër të mbijetuar dhe dy ish-ushtarë të përfshirë në luftë paditën penalisht Z. Fatullayev për shpifje dhe për akuzimin në mënyrë të gabuar të ushtarëve azer për kryerjen e një krimi të rëndë.

Gjykatat mbështetën akuzat kundër kërkuesit, duke e dënuar atë me dy vjet e gjashtë muaj heqje lirie për kryerjen e veprës penale të shpifjes. Për më tepër gjatë procesit civil nisur kundër kërkuesit përpara kryerjes së procedimit penal, ai ishte urdhëruar të publikonte një përgënjeshttrim të artikullit të tij të parë, një apologji drejtuar refugjatëve nga Khojaly dhe lexuesve të gazetës, si edhe të paguante personalisht dëmshpërblimin prej 8,500 euro personalisht. Gjithashtu, duhet të paguante edhe një tjetër dëmshpërblim prej 8,500 eurosh në emër të gazetës së tij për dëmin jomaterial.

Seti i dytë i procedimeve penale lidhet me një artikull të botuar në mars të vitit 2007. Në të kërkuesi kishte shprehur mendimin se presidenti i vendit me qëllim, që të mbetej në pushtet, kishte kërkuar mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këmbim të mbështetjes së Azerbajxhanit për “agresionin” amerikan kundër Iranit. Ai argumentoi se si rezultat i këtij veprimi Azerbajxhani mund të bëhej një viktimë e hakmarrjes iraniane dhe spekuloi mbi objektivat e mundshme të Azerbajxhanit. Procedimi penal kundër kërkuesit në lidhje me këtë artikull u nis nga Ministria e Sigurisë Kombëtare në maj të vitit 2007. Përpara se kërkuesi të akuzohej zyrtarisht për veprën penale “kërcënimi për të ndërmarrje të veprime terroriste”, Prokurori i Përgjithshëm i vendit kishte bërë një deklaratë për shtyp, duke vënë në dukje se artikulli i Z. Fatullayev përbënte një kërcënim

terrorist. Në tetor të vitit 2007 kërkuesi u shpall fajtor dhe u dënua me tetë vjet e gjashtë heqje lirie.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua në kuadër të neneve 6 dhe 10 të Konventës, duke pretenduar se dënimet e tij penale në lidhje me deklaratat, që kishte bërë në artikujt e gazetave përbënin një ndërhyrje të pajustificuar në lirinë e tij të shprehjes. Gjithashtu, ai pretendoi se gjatë procedimeve penale ndaj tij është shkelur dhe e drejta për një proces të rregullt.

Neni 10

Dënimi i parë penal

Në lidhje me dënimin e parë penal, Gjykata pranoi natyrën shumë të ndjeshme të çështjeve të diskutuara në artikullin e kërkuesit dhe se pasojat e ngjarjeve në Khojaly ishin burim i një hidhërimi të thellë kombëtar. Kështu, ishte e kuptueshme se deklaratat e bëra nga kërkuesi mund të jenë konsideruar shokuese ose shqetësuese nga publiku. Megjithatë, Gjykata kujton se liria e informimit zbatohet jo vetëm në lidhje me informacione ose ideve, që janë pranuar në mënyrë të favorshme, por edhe për ato që fyejnë, trondisin apo shqetësojnë. Ky standard është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, që një debat mbi shkaqet e veprimeve të një rëndësie të veçantë, të cilat mund të përbëjnë krime lufte ose krime kundër njerëzimit duhet të jenë në gjendje zenë vend lirisht.

Gjykata vlerësoi se artikulli ishte shkruar në një stil përgjithësisht përshkrues, me qëllim informimin e lexuesve vendas mbi realitetin e përditshëm në zonën në fjalë. Publiku kishte të drejtë për të marrë informacion në lidhje me atë, që po ndodhte në territoret mbi të cilat vendi i tyre kishte humbur kontrollin si pasojë e luftës. Artikulli nuk përmbante asnjë deklaratë, që akuzonte drejtpërdrejt ushtrinë e vendit ose individë të caktuar për kryerjen e masakrave dhe vrasjen e civilëve azerë.

Për më tepër, Gjykata u shpreh se dhënia e një dënimi me burg për publikimin e një artikulli nuk do të konsiderohet si cenim i lirisë së shprehjes së gazetarëve vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht kur të drejta të tjera themelore janë të cenuar rëndë, si për shembull, në rastet e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së dhunës. Meqenëse rasti në fjalë nuk ka qenë i tillë nuk mund të ketë asnjë justifikim për dënimin me burg të Z. Fatullayev. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës në lidhje me dënimin e parë të kërkuesit.

Artikulli i dytë ishte përqëndruar në rolin specifik të Azerbajxhanit në dinamikën e politikës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet mes SHBA-së dhe Iranit. Kërkuesi kishte kritikuar lëvizjet e politikës së brendshme dhe të jashtme të qeverisë së tij. Në vetvete, fakti që kërkuesi kishte publikuar një listë të objektivave specifike të mundshme nuk rriste dhe as ulte shanset e një sulmi hipotetik nga ana e Iranit. Z. Fatullayev nuk kishte shprehur ndonjë miratim të ndonjë sulmi të tillë të mundshëm, ose të kishte argumentuar në favor të tyre. Detyra e tij si gazetar ishte për të dhënë informacion dhe ide mbi çështjet e rëndësishme politike, si edhe të shprehte opinione rreth pasojave të mundshme të vendimeve specifike të marra nga qeveria.

Gjykata vlerësoi se dënimi i dytë i Z. Fatullayev, si edhe ashpërsia e këtij dënimi përbënte një kufizim tmerrësisht disproporcional të lirisë së shprehjes. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës në lidhje me dënimin e dytë të kërkuesit.

Neni 6 § 1

Gjykata vërejtë se gjyqtari, i cili kishte gjykuar çështjen penale kundër kërkuesit ishte i njëjti gjyqtar, që shqyrtuar më parë padinë civile kundër Z. Fatullayev. Të dy setet e procedurave, civile dhe penale përmblanin të njëjtat deklaratat kinse ofenduese të bëra nga kërkuesi. Me dhënien e vendimit civil gjyqtari kishte arritur në përfundimin se deklaratat e kërkuesit përbënin informacion të rremë dhe njollosje të dinjitetit të të mbijetuarve në Khojaly. Gjykata vlerësoi se frika e kërkuesit për një mungesë paanshmërie nga ana e gjyqtarit mund të konsiderohet objektivisht e justifikuar. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 6 § 2

Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj të mëparshme se në rastet kur një zyrtar publik ka bërë një deklaratë kundër një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, duke pasqyruar mendimin se ky individ ka qenë fajtor përpara se fajësia e tij të provohet në bazë të ligjit, është shkelje e parimit të prezumimit të pafajësisë. Prokurori i Përgjithshëm ka deklaruar haptazi se artikulli i kërkuesit përmbante një kërcënim terrorist. Këto komente të bëra pa ndonjë kualifikim ligjor apo rezervë, kishin derivuar në një deklaratë se kërkuesi kishte kryer veprën penale të kërcënimit për ndërmarrjen e veprimeve terroriste dhe kështu kishte paragjykuar vlerësimin e drejtë të fakteve nga gjykatat vendase. Kjo deklaratë nga ana tjetër kishte inkurajuar publikun për të besuar se kërkuesi ishte fajtor përpara se fajësia e tij të vërtetohej sipas ligjit. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës.

Gjykata vërejti se kërkuksi ishte duke vuajtur dënimin për veprat penale të lidhura me lirinë e shtypit, për të cilat GJEDNJ kishte gjetur Azerbajxhanin në shkelje të Konventës. Gjykata konsideroi të papranueshme, që kërkuksi të mbetej ende në burg duke theksuar këtë nevojën urgjente për t'i dhënë fund shkeljeve të nenit 10 të Konventës, Gjykata u shpreh se Azerbajxhani duhet të lironte menjëherë kërkuksin.

Neni 41

Gjykata vendosi se Azerbajxhani duhet t'i paguante kërkuksit shumën prej 25,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 2,822 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Nuk ka shkelje të nenit 10 kur nevoja për të mbrojtur të drejtat e një komuniteti emigrantësh detyron të kufizohet liria e shprehjes

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN FERET K. BELGJIKËS

(Kërkesa nr. 15615/07)

16 korrik 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesi Daniel Féret, është një shtetas belg i cili ka lindur në vitin 1944 dhe jeton në Bruksel. Si kryetar i partisë politike “Fronti Nacional” ai është kryeredaktor i publikimeve dhe pronari i faqes së internetit të saj. Ai ishte anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës në kohën e zhvillimit të ngjarjeve.

Në periudhën ndërmjet korrikut të vitit 1999 dhe tetorit 2001, shpërndarja e fletushkave dhe posterave nga partia e tij, në lidhje me fushatat zgjedhore të Frontit Nacional, derivuan në ankesa nga individë dhe shoqata të ndryshme për nxitjen e urrejtjes, diskriminimit dhe dhunës. Individët u bazuan në legjislacionin belg, i cili penalizonte akte të caktuara të frymëzuara nga rracizmi ose ksenofobia.

Më 19 shkurt 2002, Z. Féret është marrë në pyetje nga policia në lidhje me këto ankesa.

Kërkuesit iu hoq imuniteti parlamentar me kërkesë të prokurorit të Gjykatës së Apelit në Bruksel. Në nëntor 2002 ndaj kërkuesit u iniciua një procedim penal, si autor dhe redaktor i përgjithshëm i fletëpalosjeve fyese dhe pronar i faqes së internetit.

Më 4 qershor 2003, në mënyrë që të shqyrtonte themelin e çështjes, Gjykata Penale e Brukselit rihapi procedimin. Ankimi i Z. Féret në lidhje me mungesën e juridiksionit të gjykatës së shkallës së parë u shpall e papranueshme në qershor të vitit 2003. Në mars 2004 Gjykata e Kasacionit mbajti të njëjtin qëndrim.

Më 13 qershor 2004, kërkuesi u zgjodh në Këshillin Rajonal të Brukselit dhe në Kuvendin e Komunitetit Francez, të dyja pozicione të cilat i jepnin atij imunitet të ri parlamentar.

Më 23 qershor 2004, prokurori i çështjes rinisi procedimin penal. Më 20 shkurt 2006, Gjykata e Apelit në Bruksel zhvilloi një seancë të plotë gjyqësore duke dëgjuar të gjithë pretendimet e palëve dhe më 18 prill 2006 e dënoi Z. Féret me 250 orë shërbim në komunitet, që kishin të bënin me integrimin e emigrantëve, si edhe me 10 muaj dënim me kusht. Gjykata e deklaroi kërkuesin të papërshtatshëm

për mbajtjen e posteve publike për dhjetë vjet. Së fundi, ai u urdhërua atë për të paguar një euro secilës prej palëve civile.

Gjykata vërejti se sjellja ofenduese e Z. Féret nuk kishte pjesë e veprimtarisë së tij parlamentare dhe se fletëpalosja përmbante pasazhe, që përfaqësonin një nxitje të qartë dhe të qëllimshme të diskriminimit, segregimit apo urrejtjes, madje edhe dhunës, për arsye të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare ose etnike. Më 4 tetor 2006, apeli i kërkuetit u rrëzua.

2. Vendimi i Gjykatës

Në kuadër të nenit 10 të Konventës, kërkueti pretendoi se dënimi i tij për përmbajtjen e fletushkave të partisë së tij politike përbënte një kufizim të tepruar të lirisë së shprehjes.

Neni 10

Ndërhyrja në të drejtën e Z. Féret për t' u shprehur lirisht ka qenë parashikuar me ligj dhe justifikohet përmes ekzistencës së një qëllimi legjitim, siç ishte parandalimi i çrregullimeve dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve.

Gjykata vërejti se fletëpalosjet paraqisnin komunitetet në fjalë si penalisht të rrezikshëm dhe të prirur për të shfrytëzuar përfitimet, që rrjedhin nga të jetuarit në Belgjikë. Gjithashtu, fletëpalosjet talleshin me këta emigrantë, duke rrezikuar të provokonin, veçanërisht në sytë e individëve të publikut me më pak njohuri, duke krijuar ndjenjën e mosbesimit, refuzimit apo edhe urrejtjes ndaj të huajve.

Në një kohë kur liria e shprehjes është e rëndësishme për të gjithë individët, ajo është veçanërisht e rëndësishme për një përfaqësues të zgjedhur të popullit, sepse ky individ duhet të përfaqësojë elektoratin dhe të mbrojë interesat e tyre. Megjithatë, Gjykata vërejti se ishte tepër e rëndësishme për politikanët të ndalonin komentet që mund të nxisin intolerancën, kur shpreheshin në publik.

Ndikimi i diskursit racist dhe ksenofobik u zmadhua në kontekstin zgjedhor, në të cilin argumentet e përmendura nga kërkueti u bënë më të fuqishëm. Rekomandimi i zgjidhjeve për problemet e emigracionit, duke mbrojtur diskriminimin racor ka të ngjarë të shkaktojë tensione sociale dhe të minojnë besimin në institucionet demokratike. Në rastin konkret ka pasur një nevojë sociale bindëse për të mbrojtur të drejtat e komunitetit të emigrantëve, ashtu sikurse kishin bërë gjykatat belge.

Në lidhje me dënimin e Z. Féret, Gjykata vlerësoi se në rastin konkret nuk ka pasur shkelje të nenit 10.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BODROŽIĆ k. SERBIŠË

(Kërkesa nr. 32550/05)

23 qershor 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Zeljko Bodrožić, ka lindur në vitin 1970 dhe jeton në Kikinda, Serbi. Ai është gazetar dhe anëtar i një partie politike. Në kohën e ngjarjeve objekt gjykimi, kërkuesi ishte edhe redaktor i gazetës lokale javore, *Kikindske*.

Më 3 tetor 2003, kërkuesi botoi një artikull në lidhje me një historian J.P., me titull “Radha i lihet fashistëve”, ku ai e quajti historianin idiot dhe fashist. J.P. nisi një proces penal për fyerje ndaj kërkuesit. Në seancën e mbajtur më 17 nëntor 2003. Bodrožić deklaroi se “ai nuk dëshironte të zgjidhte çështjen me paditësin për shkak se ai ishte anëtar i lëvizjes fashiste në Serbi”. Pas kësaj deklarate, më 5 janar 2004, J.P. nisi një proces të ri penal ndaj kërkuesit.

Gjykata vendase vendosi se kërkuesi ishte fajtor për veprat penale të fyerjes për artikullin e publikuar dhe të shpifjes për deklaratën e bërë në seancën gjyqësore të datës 17 nëntor 2003. Kërkuesi u detyrua të paguante një gjobë prej 162 euro dëmshpërblim dhe 225 euro për shpenzimet gjyqësore. Kërkuesi e apeloj vendimin por ankimi i tij u rrëzua.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se dënimi i dhënë kishte shkelur të drejtën e tij për t`u shprehur lirisht, siç parashikohet në nenin 10 të Konventës. Gjithashtu, ai u ankua se nuk i ishte dhënë kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij në procesin penal në kundërshtim me parashikimin e nenit 6 § 3 të Konventës, por Gjykata e refuzoi ankimin e fundit si haptazi të pabazuar.

Pranueshmëria

Qeveria argumentoi se kërkuesi mund të kishte paraqitur pranë gjykatave vendase një padi civile për dëmshpërblim, nëse ai pretendonte se një nga të drejtat e tij të personalitetit ishin shkelur.

Megjithatë, Gjykata konsideron se autoritetet nuk ishin në gjendje të mbështesnin këtë përmendim në jurisprudencën e tyre të brendshme, ku një kërkesë e bazuar

në dispozitat përkatëse të së drejtës së detyrimeve ishte përdorur me sukses në një rast të tillë si ai i kërkuesit. Sipas Gjykatës, është qëllimi social i nisjes së procesit civil për shpërblim dëmi ndaj personit të dënuar gjatë proceseve penale është përfitimi dëmshpërblimit si pasojë e shkeljeve të shtetit. Për rrjedhojë, Gjykata deklaroi pranimin e ankimit.

Neni 10

Palët nuk kundërshtuan faktin se dënimi i kërkuesit për shpifje dhe fyerje shkaktoi një “ndërrhyrje” në të drejtën e tij për tu shprehur lirisht, se kjo ndërrhyrje ishte “e parashikuar me ligj” sipas Kodit Penal në fuqi në kohën kur ndodhën ngjarjet; dhe se ky veprim ndiqej nga qëllimi legjitim i mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve. Ajo që ka mbetur për t’u vlerësuar është nëse ndërrhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Gjykata ka vërejtur shpesh herë se liria e shprehjes garantuar në nenin 10 të Konventës përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike. Paragrafi 2 i nenit 10 garanton zbatim të saj jo vetëm për “informacionet” ose “idetë”, të cilat priten në mënyrë të favorshme ose që konsiderohen si të padëmshme, por edhe për ato të cilat fyejnë, trondisin ose shqetësojnë.

Gjykata theksoi funksionin thelbësor që përmbush shtypi në një shoqëri demokratike. Megjithatë, shtypi nuk duhet të kalojë disa kufij veçanërisht në lidhje me reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve, detyra e tij është gjithësesi të kujtoj informacione dhe ide për të gjitha çështjet me interes publik. Në çështjet e lidhura me shtypin, hapësira e vlerësimit të shtetit është e kufizuar nga interesat e një shoqërie demokratike për të siguruar dhe mbajtur një shtyp të lirë.

Deklaratat e kërkuesit duhet të shihen në këtë kontekst. Kërkuesi ka reaguar ndaj deklaratave të caktuara të diskutueshme të bëra nga J.P. në televizionin publik në lidhje me ekzistencën dhe historinë e pakicave kombëtare në Vojvodinë, një rajon multi-etnik ku sipas regjistrimit të vitit 2002, 35% e popullsisë të tij është jo-serbe. Ky minoritet i madh është i përbërë kryesisht nga hungarezët, por edhe sllovakët, kroatët dhe të tjerë. Në këtë intervistë, J.P. kishte thënë ndër të tjera se “të gjithë hungarezët në Vojvodinë ishin kolonë” dhe se “nuk ka pasur kroatë në atë rajon”. Pavarësisht se J.P. në asnjë mënyrë nuk u mbështet nga fashistët siç përcaktohet nga gjykatat serbe, është e kuptueshme pse kërkuesi, i cili vetë kishte pikëpamje të ndryshme politike mund të ketë interpretuar deklaratat J.P. si imponuese të një shkalle të caktuar të intolerancës ndaj pakicave kombëtare. Fakti që ai e vlerësoi detyrën e tij si gazetar për të reaguar ndaj deklaratave të tilla publike është gjithashtu e kuptueshme. Më tej, Gjykata konsideron se të quash dikë fashist, nazist apo komunist nuk mund në vetvete të identifikohet me një deklaratë faktike të përkatësisë partiake të atij personi.

Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata çmoi se shprehjet e përdorura nga kërkuesi, nuk mund të interpretohen si gjykime thelbësore vërtetësia e të cilave nuk bazohet në fakte. Këto gjykime mund cilësohen të tepruara në mungesë të ndonjë baze faktike, por nën dritën e elementeve të rastit objekt gjykimi nuk duhet të zbatohen.

Së fundi, Gjykata përsëriti se për të vlerësuar proporcionalitetin e ndërhyrjes, natyra dhe pesha e gjobave të vendosura janë faktorë, që duhet të merren parasysh. Në rastin në fjalë, kërkuesi jo vetëm që ka qenë subjekt i një dënimi penal, por gjoba e vënë ndaj tij në rast se nuk paguhej në kohë mund të zëvendësohej me 75 ditë burgim.

Gjykata arriti në përfundimin se procedimi penal në rrethanat e çështjes objekt gjykimi ka derivuar shkelje të së drejtës së kërkuesit për t`u shprehur lirisht garantuar nga neni 10 i Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit një dëmshpërblim prej 500 euro në kuadër të dëmit jomaterial.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN SATAKUNNAN MARKKINAPÖRSSI OY DHE SATAMEDIA OY k. FINLANDËS¹²⁷

(Kërkesa nr. 931/13)

21 korrik 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy, janë dy kompani finlandeze, botues të revistës “Veropörssi”, e cila raportoi informacione mbi tatimet, sidomos mbi të ardhurat e tatueshme dhe pasuritë e individëve. Në vitin 2003, Satamedia Oy filloi ofrimin e një shërbimi SMS duke lejuar individët për të marrë informacione tatimore nga një bazë të dhënash. Baza e të dhënave ishte krijuar duke përdorur informacionin, që kishte botuar tashmë revista.

Në shkurt të vitit 2004, Avokati i Popullit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kërkoi nga Bordit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të ndalonte kërkuesit të përpunonin dhe publikonin informacione të tilla për individë të ndryshëm, me arsyetimin se ky veprim ishte në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Finlandë. Bordi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale rrëzoi kërkesën me argumentin se kushti i parashikuar në ligj për “shfuqizimin gazetaresk” zbatohet në këtë rast.

Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Helsinkit. Avokati i Popullit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale apeloj në Gjykatën e Lartë Administrative dhe pas një vendim paraprak nga ana e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian¹²⁸, Gjykata e Lartë Administrative prishi vendimet e mëparshme dhe riktheu çështjen përpara Bordit. Ai u shpreh se publikimi i të gjithë bazës së të dhënave nuk mund të konsiderohej si aktivitet gazetaresk, por si përpunim i të dhënave personale, proces të cilin kompanitë kërkuese nuk kishin asnjë të drejtë për t’ a kryer. Në këtë rast duhet të vlerësohej ekuilibri midis të drejtës së kompanive për t’ u shprehur lirisht dhe të drejtës së individëve për privatësi. Në përfundim u vlerësua se publikimi i këtyre të dhënave nuk ishte në interes të publikut. Shërbimi SMS u ndërpre dhe revista botoi më tej në vjeshtë të vitit 2009 një çështje me të dhëna të reduktuara tatimore. Revista nuk u botua më prej atj viti.

127 Kjo çështje i është referuar Dhomës së Madhe. Gjykimi i saj është ende pezull.

128 Çështja C-73/07 *Tietosuojavaltutettu k. Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy* [DHM], 16 dhjetor 2008

Bordi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale ndaloi kërkuesit për përpunimin të dhënave tatimore dhe ky vendim u la në fuqi në apel.

2. Vendimi i Gjykatës

Neni 10

Kërkuesit u ankuan se ndalimi i përpunimit të të dhënave tatimore derivoi censurë dhe shkelje të nenit 10 të Konventës. Gjykata konstatoi se ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për të dhënë informacion, e drejtë e garantuar nga neni 10 (1) i Konventës. Kjo ndërhyrje ka qenë e parashikuar me ligj përsa kohë ajo u bazua në dispozitat e Ligjit të Dhënave Personale dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve.

Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja ishte e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Gjykata ka identifikuar një sërë kriteresh në rastet kur duhen balancuar liria e shprehjes dhe e drejta për respektimin e jetës private: kontributi në një debat me interes të përgjithshëm; sa publik është personi në fjalë dhe cili është subjekt i raportit; sjellja e mëparshme e personit në fjalë; mënyra e marrjes së informacionit dhe vërtetësia e tij / rrethanat në të cilat janë marrë fotografitë; përmbajtja, forma dhe pasojat e botimit; si edhe ashpërsia e sanksionit të imponuar.

Për të përcaktuar nëse kufizimi ka qenë i nevojshëm, Gjykata shqyrtoi nëse vlerësimi i balancës mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për respektimin e jetës private të kryer nga autoritetet kombëtare kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës.

Gjykata vërejti se publikimi e të dhënave tatimore ka qenë pjesë e të drejtës së publikut për të marrë informacion e justifikuar kjo nga një këndvështrim gazetaresk. Për më tepër, saktësia e informacionit nuk ishte kundërshtuar nga autoritetet finlandeze. Megjithatë, Gjykata vërejti se Gjykata e Lartë Administrative kishte kryer një vlerësim të plotë të dy të drejtave në fjalë duke i dhënë rëndësinë e duhur këtyre të drejtave në shqyrtim. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm, Gjykata e Lartë Administrative kishte çmuar se ndërhyrja në të drejtën e kërkuesve ishte e nevojshme. Gjykata e Strasburgut e vlerësoi këtë arsyetim të pranueshëm.

Për më tepër, asgjë nuk i kishte penguar kërkuesit për të publikuar informacione të një game më të ngushtë se sa ato, që kishin publikuar në vitin 2002. Arsyet mbi të cilat ishin mbështetur gjykatat vendase ishin të mjaftueshme për të treguar se ndërhyrja ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe se për pasojë, nuk ka pasur pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 6(1)

Kërkuesit u ankuan se kohëzgjatja e proceseve administrative, të cilat nuk kishin përfunduar për më shumë se tetë vjet, kishte shkelur nenin 6 (1) të Konventës.

Për të shqyrtuar kohëzgjatjen e procedurave në fjalë, Gjykata nuk do të marrë në shqyrtim kohën gjatë së cilës çështja ka qenë referuar përpara GJDBE, duke e reduktuar kohën gjatë së cilës procesi ka qenë pezull në gjashtë vjet e gjashtë muaj. Megjithatë, kohëzgjatja e tepruar e procedurave përtej një afati të arsyeshëm nuk u arsyetua bindshëm nga ana e qeverisë. Për rrjedhojë ka pasur një shkelje të nenit 6 (1) të Konventës.

Neni 14

Kjo pjesë e ankimit u shpall haptazi e papranueshme.

Neni 41

Gjykata nuk i akordoi kërkuesve dëmshpërblim për dëmin material dhe jomaterial, por vetëm kompensim të shpenzimeve gjyqësore në shumën 9,500 euro.

Mbulimi mediatik i jetës private të personave të famshëm mbrohet nga neni 10, nëse ekziston interesi i përgjithshëm dhe vendoset një ekuilibër i arsyeshëm me të drejtën për respektimin e jetës private

VENDIMET E DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJET AXEL SPRINGER k. GJERMANISË DHE VON HANNOVER (2) k. GJERMANISË

(Kërkesat nr. 39954/08, 40660/08 dhe 60641/08)

7 shkurt 2012

1. Faktet kryesore

Axel Springer AG

Shoqëria kërkuese, Axel Springer AG (“Springer”), është e regjistruar në Gjermani. Është botuesja e Bild, gazetës së përditshme me tirazhin më të madh në vend.

Në shtator 2004, Bild ka publikuar një artikull në faqen e parë të saj për X, një aktor i njohur televiziv, duke u arrestuar në festën e birrës në Mynih pasi i ishte gjetur kokainë. Artikulli gjithashtu përmendi se X, i cili kishte luajtur rolin e një inspektori policie në një serial televiziv popullor prej vitit 1998, ishte dënuar edhe në korrik 2000 me dënim me kusht për posedim droge. Gazeta publikoi një artikull të dytë në korrik 2005, duke raportuar se X ishte dënuar dhe gjobitur për posedim të paligjshëm të drogës, pasi kishte rrëfyer plotësisht ngjarjen.

Kur artikulli u publikua për herë të parë, X nisi një proces gjyqësor kundër Springer në Gjykatën Rajonale të Hamburgut. Gjykata pranoi kërkesën e X-it dhe ndaloi çdo publikim të mëtejshëm të atij artikulli dhe fotove lidhur me të. Në një tjetër set procedurash në lidhje artikullin e dytë botuar për dënimin e X-it, Gjykata Rajonale e Hamburgut dha gjithashtu një urdhër. Vendimet u lanë në fuqi nga Gjykata e Apelit në Hamburg dhe Gjykata Federale e Drejtësisë. Në të dy rastet, gjykatat vendosën se e drejta e X-it për mbrojtjen e jetës së tij private mbizotëroi mbi interesin publik.

Von Hannover (nr. 2)

Kërkuesit ishin Princesha Caroline von Hannover, e bija e të ndjerit Princit Rainier III i Monakos dhe bashkëshorti i saj Princi Ernst August von Hannover.

Prej fillimit të viteve 1990 Princesha Caroline është përpjekur për të parandaluar publikimin e fotografive të jetës së saj private në shtyp. Dy sete të fotografish, botuar në vitin 1993 dhe 1997 në revista gjermane kanë qenë subjekt i tre serie procedurash përpara gjykatave gjermane. Këto procedura në fund u konkluduan

me vendim nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shih *Caroline von Hannover k. Gjermanisë* (nr. 59320/00). Në këtë rast, Gjykata u shpreh se publikimi i fotografive kishte cenuar të drejtën e Princeshës Caroline për gëzimin e jetës së saj private sipas nenit 8 të Konventës.

Duke iu referuar çështjes *Caroline von Hannover k. Gjermanisë*, Princesha Caroline dhe Princi Ernst August kanë hapur një sërë procesesh gjyqësore përpara gjykatave civile gjermane ku kërkojnë një urdhër kundër publikimit të fotografive të mëtejshme të tyre. Gjykata Federale e Drejtësisë pranoi kërkesën e Princeshës sa i përket publikimit të dy fotografive, duke deklaruar se ato nuk kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm. Megjithatë, kjo gjykatë rrëzoi kërkesën e saj për një foto tjetër të çiftit duke ecur gjatë një pushimeve dimërore në Shën Moritz. Kjo fotografi u shoqërua me një artikull mbi shëndetin e dobët e princit Rainier të Monakos. Në marrjen e vendimit të saj, Gjykata Federale vendosi se shëndeti i dobët Princit ishte një çështje me interes publik dhe se shtypi ka pasur të drejtë për të raportuar për mënyrën në të cilën fëmijët e tij pajtojnë detyrimet e tyre të solidaritetit familjar me nevojat legjitime të jetës së tyre private.

Më pas, Gjykata Kushtetuese Federale hodhi poshtë një ankesë kushtetuese bërë nga Princesha Caroline, duke rrëzuar në mënyrë të veçantë pretendimin e saj se gjykatat gjermane kishin shpërfillur ose nuk kishin marrë parasysh pamjaftueshmëri të çështjes *Caroline von Hannover k. Gjermanisë*.

2. Vendimet e Gjykatës

Axel Springer AG u ankua se urdhri për të ndaluar çdo publikim të mëtejshëm të artikujve për aktorin X kishte cenuar lirinë e tyre të shprehjes sipas nenit 10 të Konventës.

Princesa Caroline von Hannover dhe Princi Ernst August von Hannover ankuan se refuzimi i gjykatave gjermane për të ndaluar çdo publikim të mëtejshëm të fotografive objekt gjykimi kishte shkelur të drejtat e tyre sipas nenit 8 të Konventës. Në veçanti, ishte theksuar se gjykatat gjermane nuk e kishin marrë në konsideratë vendimin *Caroline von Hannover k. Gjermanisë*.

Dhoma pranë së të cilës kërkesat ishin paraqitur për gjykim si aplikime të ndara vendosi bashkimin e tyre dhe hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe.

Axel Springer AG

Fakti se vendimet e gjykatave gjermane përbënin një ndërhyrje në të drejtat e Springer sipas nenit 10 nuk u kundërshtua nga palët. Në të njëjtën linjë qëndronte

dhe fakti se ndërhyrja në fjalë ishte e parashikuar nga ligji gjerman dhe se kishte ndjekur një qëllim legjitim, për mbrojtjen e dinjitetit të të tjerëve.

Për sa i përket pyetjes nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vërejt se artikujt në fjalë, në lidhje me arrestimin dhe dënimin e aktorit përbënin fakte gjyqësore publike, mbi të cilat publiku kishte një interes për t' u informuar. Gjykatave vendase i takonte për të vlerësuar se sa i njohur ishte ky person, duke u ndalur në faktin se ky aktori ishte gjerësisht i njohur në nivel kombëtar. Gjykata vërejt se gjykata gjermane e apelit kishte theksuar se aktori kishte luajtur rolin e një inspektori të policisë gjatë një periudhe të gjatë kohe dhe ishte mirënjohur e shumë popullor. Prandaj, Gjykata vërejt se X ishte një figurë e cila mund të kualifikohet si publike. Ky fakt përforconte interesin e publikut për t' u informuar për arrestimin e tij dhe procedurat e mëtejshme gjyqësore.

Gjykata mund të pajtohet me vlerësimin e gjykatave gjermane se interesi i gazetës për të publikuar artikujt vinte vetëm nga fakti se personi i arrestuar ishte aktor i mirënjohur, i cili kishte kryer një vepër penale – vepër që nuk do të kishte qenë raportuar nëse do të ishte kryer nga një individ i panjohur për publikun. Gjykata theksoi se aktori ishte arrestuar në publik në festën e birrës në Mynih. Pritshmëria e aktorit se jeta e tij private do të mbrohej në mënyrë efektive duhet të ishte reduktuar edhe nga fakti se ai vetë kishte zbuluar detaje rreth jetës së tij private në një numër intervistash të dhëna më parë.

Në bazë të një deklaratë bërë nga një prej gazetarëve të përfshirë, fakt i cili nuk u kundërshtua nga qeveria gjermane, informacioni i publikuar në gazetën Bild në shtator të vitit 2004 ishte marrë nga zyra e prokurorit publik të Mynihut dhe policia. Për këtë arsye ekzistonte një bazë e mjaftueshme faktike, për të besuar vërtetësinë e informacionit. Nuk ekziston asnjë bazë për të argumentuar se Springer nuk kishte ndërmarrë në shqyrtim balancimin ndërmjet interesit të tij në publikimin e informacionit dhe të drejtës së aktorit për të respektuar jetën e tij private. Duke pasur parasysh se Springer kishte marrë konfirmimin e informacionit të përcjellë nga autoritetet e ndjekjes penale, nuk ka pasur arsye mjaftueshmërisht të forta për të besuar se ajo duhet të ruajë anonimitetin e aktorit. Nuk mund të thuhet pra se kompania kërkuese ka vepruar me keqbesim.

Gjithashtu, Gjykata theksoi se artikujt nuk kanë zbuluar detaje në lidhje me jetën private të aktorit, por ishin ndalur kryesisht tek rrethanat e arrestimit dhe rezultatin e procesit penal kundër tij. Artikujt nuk përmbanin shprehje përçmuese apo pretendime të pabaza dhe autoritetet nuk kishin provuar se publikimi i artikujve kishte rezultuar në pasoja të rënda për aktorin. Ndërsa sanksionet e vendosura mbi Springer mund të prodhonin një efekt frenues mbi kompaninë. Gjykata arriti

në përfundimin se kufizimet e vendosura ndaj kompanisë nuk kishin qenë proporcionale me qëllimin legjitim të mbrojtjes së jetës private e aktorit. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

Von Hannover (nr. 2)

Gjykata vërejti se pas vendimit të saj në 2004 *Caroline von Hannover k. Gjermanisë*, Gjykata Federale e Drejtësisë kishte bërë ndryshime në jurisprudencën e saj të mëparshme. Në veçanti, Gjykata Federale e Drejtësisë kishte deklaruar se ishte e rëndësishme nëse një raport në media kontribonte në një debat faktik dhe nëse përmbajtja e tij shkonte përtej një dëshire të thjeshtë për të kënaqur kuriozitetin e publikut. Gjykata Federale e Drejtësisë ka theksuar se sa më e madhe vlera e informacionit për publikun aq më shumë ekziston interesi i një personi të mbrojtë jetën e tij private dhe anasjelltas.

Fakti se Gjykata Federale e Drejtësisë ka vlerësuar vlerën e informacionit e fotos në fjalë, në dritën e artikullit, që është botuar së bashku me të nuk mund të kritikohet në bazë të Konventës. Gjykata mund të pranojë që fotoja, në kontekstin e shkrimit në një farë mase, kontribuonte për një debat me interes të përgjithshëm. Gjykatat gjermane u shprehën se karakterizimi i sëmundjes së Princit Rainier si një rast i një shoqërie bashkëkohore nuk mund të konsiderohej e paarsyeshme. Gjykata më tej vuri në dukje se pavarësisht pyetjes se në çfarë mase Caroline von Hannover mori funksionet zyrtare në emër të Principatës së Monakos, ajo nuk mund të pretendojë se nuk ishte e njohur nga publiku duke u trajtuar si një individ i zakonshëm privat. Kështu kërkuesit duhej të konsiderohen si figura publike.

Gjykatat gjermane kishin konstatuar se kërkuesit nuk kishin provuar se fotot kryer në një klimë të përgjithshme shqetësimi, apo ishin bërë në mënyrë të fshehtë ashtu siç kishin pretenduar kërkuesit.

Në përfundim, Gjykata vendosi se gjykatat gjermane kishin balancuar me kujdes lirinë e shprehjes kundrejt të drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës së tyre private. Duke vepruar kështu, gjykatat gjermane kishin zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ, duke përfshirë këtu dhe çështjen *Caroline von Hannover k. Gjermanisë*. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi se Gjermania duhet t'i paguante kompanisë Axel Springer AG vlerën prej 17,734.28 euro në kuadër të dëmit material dhe 32,522.80 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

VENDIM I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN COUDERC DHE HACHETTE FILIPACCHI ASSOCIÉS K. FRANCËS

(Kërkesa nr. 40454/07)

10 nëntor 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesit janë Anne-Marie Couderc, një shtetase franceze e cila ka lindur në vitin 1950, e cili është drejtoreshë publikimi i Paris Match, dhe kompania Hachette Filipacchi Associés, e cila boton revistën javore Paris Match.

Më 3 maj 2005, gazeta britanike Daily Mail botoi një artikull në të cilin një qytetare e quajtur Znj. Coste pretendonte se babai i djalit të saj ishte Albert Grimaldi, princi në fron i Monakos. Më 5 maj 2005, Paris Match publikoi artikullin, i cili përbëhej nga një intervistë me Znj. Coste ku rrëfehej fakti i mësipërm. Artikulli u shoqërua me fotografi që tregojnë Princin Albert me fëmijë në krahët e tij.

Më 19 maj 2005, Princi Albert nisi procedim kundër kërkuesve me pretendimin se artikulli kishte shkelur të drejtat e tij për të gëzuar një jetë të qetë private dhe për të mbrojtur imazhin, duke kërkuar dëmshpërblim nga kompania botuese dhe një urdhër që të publikojë vendimin e gjykatës në kopertinën e revistës.

Më 29 qershor 2005, Gjykata i Lartë i Nanterres urdhëroi kompaninë Hachette Filipacchi Associés t'i paguajnë Princit Albert dëmshpërblim për dëm jomaterial në shumën 50,000 euro, si dhe urdhëroi që detajet e gjykimit të botoheshin në tërë ballinën Paris Match-it, me titull "Gjykata vendosi kundër Paris Match, me kërkesën e princit Albert II i Monakos". Gjykata vendase vlerësoi se i tërë artikulli përfshihej brenda sferës më intime të dashurisë dhe jetës familjare të princit Albert dhe se nuk shqetësohej më për ndonjë debat me interes të përgjithshëm. Kërkuesit apeluan vendimin.

Në një njoftim për shtyp të datës 6 korrik 2005 princi Albert pranoi publikisht se ai ishte babai i fëmijës. Më 24 nëntor 2005, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin kundër kërkuesve dhe ndryshoi kushtet për publikimin e vendimit të gjykatës në kopertinën e revistës.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 10, kërkuesit u ankuan se gjykimi kundër tyre kishte

derivuar ndërhyrje të pajustificuar në ushtrimin e së drejtës së tyre për t' u shprehur lirisht. Më 12 qershor 2014, Dhoma e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka gjetur se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Më 13 tetor 2014, një panel i Dhomës së Madhe pranoi kërkesën e qeverisë për referimin e rastit.

Neni 10

Gjykata theksoi se nuk është kundërshtuar nga palët se vendimi objekt gjykimi përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes të kërkuesve. As nuk u është kontestuar se ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj. Për më tepër, Gjykata vërejti se është pranuar se kjo ndërhyrje ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes të së drejtave të të tjerëve brenda kuptimit të nenit 10 (2) të Konventës. Megjithatë, në mënyrë që një ndërhyrje të jenë në përputhje me Konventën, ajo duhet të jetë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Gjykata vërejti se për të shqyrtuar nëse ndërhyrja në këtë rast ishte “e nevojshme”, kërkohet që ajo të shqyrtojë nëse gjykatat e brendshme vlerësuarn ekuilibrin e duhur mes të dy të drejtave konkurruese. Pra, të drejtës për respektimin e jetës private të princit dhe të lirisë së shprehjes së kërkuesve. Gjykata vuri në dukje se mbrojtja e ofruar nga koncepti i “jetës private” në nenin 8 të Konventës është menduar kryesisht për të siguruar zhvillimin, pa ndërhyrje nga jashtë, të personalitetit të çdo individi. Në lidhje me nenin 10, Gjykata përsëriti se mbrojtja e tij përfshin informacion dhe ide që fyejnë, trondisin ose shqetësojnë dhe se kur informacioni ka të bëjë me çështje me interes publik, shtypi kanë për detyrë për të dhënë këtë informacion dhe publiku ka të drejtë për ta marrë atë . Gjykata vuri në dukje se mbrojtja e ofruar nga neni 10 mund të cedojë për shkak të kërkesave të nenit 8 të Konventës, kur informacioni është i natyrës private e intime dhe nuk ka interes publik për shpërndarjen e tij.

Më tej, Gjykata iu referua kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e saj të mëparshme për të shqyrtuar ekuilibrin e të drejtave konkurruese. Kriteret relevante janë: kontributi në një debat me interes publik, fama të personit në fjalë, objekti i raportimit në media, sjellja paraprake e personit në fjalë, përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit, si edhe në rastet kur është e përshtatshme, rrethanat në të cilat janë marrë fotografitë. Gjykata ka deklaruar edhe më parë se kur shqyrton një kërkesë të parashtruar sipas nenit 10 të Konventës, do të analizohet mënyra në të cilën është marrë informacioni, vërtetësia e tij dhe pesha e sanksionit të marrë ndaj gazetarëve apo botuesve.

Gjykata pranoi se nuk kishte asnjë dyshim se botimi i marrë si një i tërë dhe në kontekst, duke u analizuar në dritën e precedentëve të jurisprudencës së saj të mëparshme, përbënte një çështje të interesit publik. Në kohën e zhvillimit të

ngjarjeve lindja e këtij fëmije nuk ishte pa pasoja të mundshme dinastike dhe financiare e për rrjedhojë, informacioni i kundërshtuar ishte me rëndësi politike, pasi ai mund të ngjallte interesin e publikut në lidhje me rregullat e trashëgimisë në fuqi të Principatës.

Gjykata theksoi se duke pasur parasysh se princi ishte një figurë publike, garantimi i së drejtës së tij sipas nenit 8 do të mund të ndikohet. Fakti i ushtrimit të një funksioni publik domosdoshmërisht ekspozon një individ ndaj kontrollit e publikut, duke përfshirë edhe median. Gjykata vërejtë se publikimi i kontestuar kishte të bënte me jetën private të princit. Megjithatë, elementi thelbësor i përmbajtjes së informacionit të publikuar - ekzistenca e fëmijës - shkonte përtej sferës private, duke pasur parasysh natyrën e trashëgueshme të funksioneve të princit, si kryetarit i shtetit. Për më tepër, vërtetësia e deklaratave të Znj. Coste në lidhje me atësisë e fëmijës së saj nuk u kundërshtua as nga vetë princi, i cili e pranoi publikisht atë menjëherë pas botimit të artikullit të parë. Së fundi, Gjykata u shpreh se fotografitë ishin dorëzuar për Paris Match nga Znj. Coste vullnetarisht dhe pa pagesë, ato nuk janë marrë pa lejen e princit dhe nuk paraqesin asnjë pamje të pafavorshme të tij.

Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata vlerësoi se argumentet e parashtruara nga qeveria në lidhje me mbrojtjen e jetës private të princit Albert dhe të drejtës së tij për ruajtjen e imazhit nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen në fjalë. Gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë vëmendjen e duhur parimeve dhe kritereve për ekuilibrimin e duhur mes të drejtës për respektimin e jetës private dhe lirisë së shprehjes. Në këtë drejtim, Gjykata vërejtë se gjykatat e brendshme kishin dështuar në vlerësimin e intervistës në mënyrë të tillë që të përcaktonin peshën e duhur të aspekteve të jetës private të princit dhe çfarë mund të cilësohej në mënyrë legjitime çështje me interes publik. Gjykatat e brendshme kanë mohuar se ka pasur ndonjë “vlerë diskutimi” lajmi për ekzistencën e djalit të princit dhe kështu arritën në përfundimin se artikulli nuk ishte pjesë e “një debati mbi një çështje të interesit publik e cila do të justifikohet duke u raportuar mbi bazën e transmetimit të ligjshëm të informacionit për publikun”. Pra, Gjykata arriti në përfundimin se gjykatat e brendshme dështuan të arrijnë një ekuilibër të arsyeshëm proporcional midis masave që kufizojnë të drejtën e kërkuesit për t’u shprehur lirisht dhe qëllimit legjitim të ndjekur.

Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata rrëzoi pretendimet e kërkuesve për dëmshpërblim për shkak se ata nuk kishin mund të pretendonin një vlerë konkrete dëmi. Megjithatë, Gjykata i akordoi kërkuesve së bashku shumën prej 15,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

VENDIM PËR ÇËSHTJEN E DHOMËS SË MADHE BÉDAT K. ZVICRËS
(Kërkesa nr. 56925/08)
29 mars 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Z. Arnaud Bédát është një gazetar zviceran, i cili më 15 tetor 2003 botoi një artikull në revistën javore *L'Illustré*, me titull "Tragjedia në urën e Lozanës – versioni i shoferit të pakujdesshëm - Pyetja e shoferit çmendur ". Ky artikull kishte të bënte me procedimin penal kundër M.B. i cili më 8 korrik 2003, e kishte shtyrë makinën e tij drejt këmbësorëve, duke vrrarë tre dhe plagosur tetë persona, e më pas duke u hedhur vetë nga ura e Lozanës. M.B. mbijetoi dhe u mbajt në paraburgim. Gjyqi ndaj tij nisi dy vjet më vonë. Artikulli përmbante informacione sensitive, të tilla si pyetjet e bëra nga oficerët e policisë dhe gjyqtarit hetues; përgjigjet M.B. për ato pyetje; akuza kundër M.B. dhe fotografitë e letrave të dërguara nga M.B. përpara gjykatësit hetues. Gjithashtu, gazetari pohoi se M.B. "nuk shfaqte asnjë shenjë keqardhjeje" dhe kishte deklaruar se kishte "bërë gjithçka me qëllim që të mos kishte mundësi të mbrohej".

Kërkuesi e kishte marrë informacionin në mënyrë të ligjshme dhe në mirëbesim – njëra prej palëve që kërkonte dëmshpërblim nga M.B. kishte humbur një fotokopje të dosjes së rastit M.B. në një qendër tregtare. Kjo është gjetur nga një person i pidentifikuar i cili pastaj e kishte dërguar atë në zyrën e *L'Illustré*. Çështja u soll nga prokurori përpara gjykatës duke pretenduar se publikimin e dokumenteve sekrete. Kërkuesi u dënua për shkelje të Kodit Penal zviceran dhe me gjobë në përputhje me rrethanat.

2. Vendimi i Gjykatës

Z. Bédát pretendoi se dënimi i dhënë ndaj tij kishte shkelur të drejtën e tij për tu shprehur lirisht në bazë të nenit 10 të Konventës. Në vendimin saj Dhoma të 1 korrik 2014, vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 10. Një kërkesë nga qeveria zvicerane ia referoi çështjen Dhomës së Madhe.

Neni 10

Dhoma e Madhe vërejti se palët binin dakord se dënimi i kërkuesit përbënte një ndërhyrje në lirinë e tij të shprehjes në bazë të nenit 10 dhe se një ndërhyrje e tillë ishte e parashikuar me ligj. Dhoma e Madhe konfirmoi përfundimin e

arritur nga Dhoma se masa e kundërshtuar kishte ndjekur qëllim legjitim duke ndaluar përhapjen e informacioneve konfidenciale, mbështetur në autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit dhe ruajtjen reputacionin dhe të drejtat e qytetarit.

Gjykata u ndal në shqyrtimin nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme”. Gjykata konfirmoi se një nivel i lartë i mbrojtjeje dhe një hapësirë e ngushtë vlerësimi, ekziston për fjalimet politike dhe çështjet me interes publik. Ajo theksoi se shtypi luan një rol të pazëvendësueshëm në një shoqëri demokratike, por edhe se mbrojtja e ofruar nga neni 10 i Konventës varet nga gazetarët që veprojnë në mirëbesim në dhënien e informacionit të saktë dhe të janë të besueshëm në përputhje me parimet e gazetarisë së përgjegjshme. Për të përcaktuar nëse një gazetar ka vepruar me përgjegjësi nëse ka shkelur ose jo ligjin bëhet një vlerësim i përgjithshëm.

Shtypi ka detyrë për të diskutuar objektin e gjykimeve penale dhe publiku ka të drejtë të marrë një informacion të tillë. Megjithatë, e drejta për një gjykim të drejtë dhe në një proces penal konform garancive të nenit 6, të siguron të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe të drejtën e prezumimit të pafajësisë. Kjo duhet të jetë në vëmendje të një gazetari kur komenton një çështje penale, e cila nuk ka përfunduar së gjykuari. Gjykata vërejt se të drejtat e garantuara nga Konventa gëzojnë mbrojtje të barabartë dhe në këtë mënyrë duhen ekuilibruar garancitë e nenit 6 dhe 10 të Konventës, sikurse është shqyrtuar ekuilibri i të drejtave të garantuara nga nenet 8 dhe 10 në jurisprudencën e Gjykatës. Për të bërë këtë, Gjykata specifikoi gjashtë kritere që duhet të marreshin në konsideratë.

Së pari, Gjykata duhet të marrë parasysh se si kërkuesi mori në posedim informacionin në fjalë. Në këtë drejtim, Gjykata vërejt se edhe pse kërkuesi e kishte marrë informacionin në mënyrë të ligjshme, Z. Bédat nuk mund të ketë qenë në dijeni se informacioni ishte i fshehtë.

Së dyti, Gjykata duhet të shqyrtojë përmbajtjen e artikullit të kundërshtuar. Nuk është detyrë e organeve gjyqësore të diktojnë se çfarë teknikash raportimi duhet të përdorin gazetarët dhe liria gazetareske përfshin një shkallë ekzagjerimi, ose edhe provokimi. Gjykata Federale e Zvicrës ka kryer një vlerësim të plotë të shkrimit dhe konsiderohet se ai ishte tejet negativ ndaj M.B.. Është përdorur një “ton pothuajse tallës” dhe ishte komentuar besueshmëria e deklaratave të M.B. përpara autoriteteve gjyqësore.

Së treti, Gjykata duhet të analizojë kontributin e artikullit të kundërshtuar ndaj një debati me interes publik. Gjykata theksoi se pavarësisht se përmbajtja e shkrimit kishte shkaktuar një reagim emocional të publikut të gjerë, pyetja ishte nëse përmbajtja e tij dhe posaçërisht, informacioni sekret mund të kontribuojë në debatin publik për këtë çështje. Në këtë drejtim, Gjykata u pajtua me Gjykatën

Federale të Zvicrës në përfundimin se artikulli nuk ka kontribuar në debatin publik në lidhje me procesin penal, që nuk kishte përfunduar ende.

Së katërti, Gjykata duhet të vlerësojë ndikimin e artikullit të kontestuar në procesin penal. Edhe pse nenet 6 dhe 10 të Konventës duhet të respektohen në mënyrë të njëjtë, fshehtësisë së një hetimi gjyqësor duhet t'i jepet një mbrojtje e veçantë për shkak të seriozitetit të procesit penale. Një fshehtësi e tillë është e nevojshme për të minimizuar rreziqet e marrëveshjeve të fshehta dhe të provave kundërshtuese, por edhe për të garantuar prezumimin e pafajësisë të të pandehurit dhe për të mbrojtur paanshmërinë e gjyqësorit. Në këtë drejtim, artikulli përmbante një rrezik të qenësishëm për të ndikuar procesin gjyqësor.

Së pesti, Gjykatës i duhet të hetojë nëse jeta private e të akuzuarit është shkelur. Neni 8 i Konventës garanton të drejtën e mbrojtjes së dinjitetit dhe informacioneve personale, që individët në mënyrë legjitime presin të mos publikohen pa pëlqimin e tyre. Shtetet Palë në Konventë kanë detyrimin pozitiv për të mbrojtur të drejtat e individëve sipas nenit 8. Në përputhje me rrethanat e çështjes, autoritetet zvicerane kishin zbatuar saktë ligjin duke nisur një proces penal kundër kërkuesit. Për më tepër, informacioni i paraqitur në artikull kishte natyrë shumë personale dhe M.B. nuk kishte qenë një figurë publike. Kështu ai e meritonte nivelin më të lartë të mbrojtjes sipas nenit 8 të Konventës.

Dhoma e Madhe nuk u pajtua me vendimin e Dhomës, e cila kishte konkluduar se mbrojtja e jetës private M.B. mund të ishte garantuar përmes përdorimit të mjeteve juridike civile, në vend të dënimit penalisht të kërkuesit. Ekzistenca e këtyre mjeteve ligjore civile nuk përjashton shtetin nga detyrimi i tij pozitiv. M.B. ishte në burg, në një situatë të disfavorshme dhe ndoshta vuante nga sëmundje të shëndetit mendor. Pra, autoritetet zvicerane nuk mund të prisnin, që M.B. të niste një proces gjyqësor civil dhe kishin përmbushur detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën e M.B. për një jetë të qetë private.

Së gjashti, Gjykatës i duhet të hetojë nëse jeta private e të akuzuarit është shkelur. Neni 8 i Konventës garanton të drejtën e mbrojtjes së dinjitetit dhe informacioneve personale, që individët në mënyrë legjitime presin të mos publikohen pa pëlqimin e tyre. Shtetet Palë në Konventë kanë detyrimin pozitiv për të mbrojtur të drejtat e individëve sipas nenit 8. Në përputhje me rrethanat e çështjes, autoritetet zvicerane kishin zbatuar saktë ligjin duke nisur një proces penal kundër kërkuesit. Për më tepër, informacioni i paraqitur në artikull kishte natyrë shumë personale dhe M.B. nuk kishte qenë një figurë publike. Kështu ai e meritonte nivelin më të lartë të mbrojtjes sipas nenit 8 të Konventës.

Së fundi, Gjykata duhet të vlerësojë proporcionalitetin e dënimit të vendosur. Për

të bërë këtë vlerësim duhet marrë parasysh natyra dhe pesha e dënimit të dhënë. Dënimet e tilla nuk mund të përfaqësojnë asnjë formë të censurës, që synon ndalimin e kritikave dhe të frenojnë gazetarët për të kontribuar në diskutimet mbi çështjet e interesit publik. Për më tepër, Gjykata konstatoi se publikimi i informacioneve të klasifikuara si sekret hetimor ishte një vepër e dënueshme në tridhjetë prej Shteteve Palë në Konventë. Z. Bédat i është dhënë fillimisht një dënim me kusht me një muaj burgim. Megjithatë, ky dënim ishte zëvendësuar me një gjobë prej 4,000 frangash zvicerane. Kjo shifër do t'i zbritej kërkuesit nga të ardhurat e pagës. Gjykata vlerësoi se procedimi penal dhe dënimi i kërkuesit me gjobë nuk përbënte një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e tij garantuar nga neni 10 i Konventës. Gjykata u shpreh se një dënim i tillë nuk mund të konsiderohet se ka një efekt parandalues mbi lirinë e shprehjes të Z. Bédat apo gazetarë të tjerë, të cilët kanë shkruar në lidhje me procese penale ende të pa përfunduara.

Për rrjedhojë në kuadër të parashtrimeve më sipër dhe duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit lejuar shtetit në këto rëste, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KHUZHIN DHE TË TJERËT K. RUSISË
(Kërkesa nr. 13470/02)
23 tetor 2008

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, të tre vëllezër mes tyre janë shtetas rusë: Amir Khuzhin i cili ka lindur në vitin 1975; vëllai i tij binjak Damir Khuzhin, i cili kishte ndërruar jetë; dhe Marat Khuzhin, i lindur në vitin 1970.

Të tre vëllezërit u arrestuan në prill të vitit 1999 dhe më pas u akuzuan për rrëmbim dhe torturë. Ata u akuzuan se kanë rrëmbyer një endacak dhe e kishin detyruar të bënte punë fizike të detyruar në këmbim të një pagese jashtëzakonisht të ulët, të cilin e kishin rrahur dhe torturuar me tela elektrik në momentin kur ai ishte munduar të largohej të ikte. Pak ditë përpara gjyqit të tyre në korrik të vitit 1999, një kanal televiziv kombëtar transmetoi një bisedë gjatë së cilës tre zyrtarë të prokurorisë diskutuan në hollësi rastin e vëllezërve. Një nga zyrtarët i ishte referuar atyre si kriminelë të regjur dhe se “krimi” që kishin kryer ishte karakteristikë e “mizorisë dhe brutalitetit të pakuptimtë”. Një gazetë lokale botoi një artikull në lidhje me këtë çështje. Vëllezërit paraqitën disa ankesa në lidhje me mbulimin mediatik të procesit kundër tyre, por pa sukses. Të tre vëllezërit ngritën një padi civile për shpifje kundër autorit të artikullit në gazetë. Ky pretendim u rrëzua gjatë seancave pa prezencën e kërkuesve ose përfaqësuesit të tyre sepse ligji rus nuk lejonte personat e dënuar të silleshin nga kolonitë korrektuese deri në vendin ku padia e tyre civile ishte duke shqyrtuar. Në shenjë proteste kundër kësaj praktike, përfaqësuesi i kërkuesve refuzoi të merrte pjesë në seancë.

Në përfundim vëllezërit u shpallën fajtorë dhe u u dënuan në mars të vitit 2001. Marat Khuzhin u dënua me pesë vjet e një muaj heqje lirie. Ndërkohë, vëllezërit e tij binjakë me shtatë vjet dhe u detyruan të qëndronin në një burg të sigurisë së lartë.

2. Vendimi i Gjykatës

Ankimet e kërkuesve në çështjen objekt gjykimi kanë të bëjnë me: deklaratat e bëra nga autoritetet e prokurorisë gjatë emisioneve televizive vesonin procesin penal ndaj tyre; në lidhje me fotografitë Amir Khuzhin që u transmetuar në televizion; për faktin se ata nuk ishin lejuar të merrnin pjesë në procesin civil në të cilin ishin palë; si edhe sekuestrimi i furgonit të Marat Khuzhin pasi ai ishte

paraqitur për marrjen në pyetje. Ata u mbështetën në nenin 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt), nenin 6 § 2 (prezumimi i pafajësisë), nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe korrespondencës) dhe nenit 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës). Gjithashtu, kërkuesit u ankuan për shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues), si edhe për kushtet e tyre të paraburgimit dhe të transportit, veçanërisht ekspozimit ndaj motit të ftohtë pa veshje të përshatshme. Kërkuesit pretenduan se ndaj tyre ishte shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë, për shkak të faktit se përfaqësues të prokurorisë kishin bashkëpunuar me masmedian gjatë procesit gjyqësor.

Neni 3

Gjykata shqyrtoi faktet e çështjes objekt gjykimi dhe arriti në përfundimin se autoritetet vendase nuk kishin dështuar në detyrën e tyre për të siguruar mbrojtjen e kërkuesve nga kushtet atmosferike.

Neni 6

Gjykata vërejti se tre zyrtarë të prokurorisë kishin deklaruar si një fakt të sigurt se kërkuesit kishin kryer një krim; ata nuk e kishin përmendur se kërkuesit kishin mohuar përfshirjen e tyre në veprën penale në fjalë. Këto thënie deklarorin fajësinë e kërkuesve, duke derivuar kështu një paragjykim në vlerësimin e fakteve të çështjes nga organi gjyqësor kompetent, duke inkurajuar publikun për të besuar se kërkuesit ishin fajtorë përpara se fajësia e tyre të ishte provuar në bazë të ligjit. Gjykata çmoi se prezumimi i pafajësisë së kërkuesve ishte shkelur duke derivuar cenim të nenit 6 § 2 të Konventës.

Gjykata vërejti se refuzimi i gjykatave të brendshme për t'u dhënë kërkuesve mundësinë të paraqiteshin në seancat gjyqësore të zhvilluara në lidhje me pretendimet e tyre civile ka qenë paragjykes dhe nuk u mor asnjë masë ligjore efektive për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në proces. As proceset gjyqësore nuk ishin shtyrë për t'i dhënë kërkuesve mundësinë e përcaktimit të një përfaqësuesi tjetër. Në këto rrethana, Gjykata u shpreh se kërkuesit ishin privuar nga mundësia për të paraqitur efektivisht padinë e tyre civile përpara gjykatave vendase në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 8

Gjykata vërejti se policia kishte marrë një fotografi pasaporte të Z. Amir Khuzhin nga dosja e e çështjes penale dhe pa pëlqimin e tij ia kishte dhënë këtë foto një gazetari. Publikimi i kësaj fotoje në emisionin televiziv nuk ishte bërë me qëllim përcaktimin e vendndodhjes së tij pasi kërkuesi nuk ishte një i arratisur nga

drejtësia; as nuk ishte e nevojshme për të përforcuar karakterin publik të procesit gjyqësor pasi në kohën kur u transmetua emisioni televiziv gjykimi ndaj tij nuk kishte nisur ende. Gjykata vlerësoi se nuk ekzistonte ndonjë qëllim legjitim në ndërhyrjen e të drejtës së kërkuarit për të respektuar jetën e tij private, duke shtuar këtu faktin se qeveria nuk paraqiti ndonjë justifikim për këtë ndërhyrje. Gjykata çmoi se ndaj kërkuarit ishte shkelur e drejta e garantuar nga neni 8 i Konventës.

Neni 1 i Protokollit 1

Në lidhje me sekuestrimin e furgonit të njërit prej kërkuarëve, Gjykata vërejti se në akuzat për ushtrimin e torturës apo rrëmbimit kundër tij nuk ishte dhënë një urdhër për sekuestrimin e mjetit gjatë procesit gjyqësor penal dhe as atij civil. Kështu nuk ishte marrë asnjë nga masat e nevojshme në bazë të legjislacionit të brendshëm për këtë veprim. Gjykata çmoi se ka pasur një shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës për shkak të sekuestrimit të paligjshëm të automjetit të kërkuarit.

Neni 41

Gjykata rrëzoi pretendimet e kërkuarit për shpërblim të drejtë.

Nuk ka shkelje të nenit 10 kur mbulimi mediatik ka rrezikuar ndërhyrjen në administrimin e duhur të drejtësisë, autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN TOURANCHEAU DHE JULY K. FRANCËS

(Kërkesa nr. 53886/00)

24 nëntor 2005

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, Patricia Tourancheau dhe Serge July, janë shtetas francezë, të moshës 46 dhe 62, të cilët jetojnë në Paris.

Më 28 tetor 1996, gazeta e përditshme *Libération*, në të cilën Z. July është redaktor botoi një artikull nga Znj. Tourancheau në lidhje me vrasjen e një vajze të re e cila ishte goditur me thikë për vdekje në maj 1996. Në këtë kohë procesi i hetimor për veprën penale nuk kishte përfunduar ende. Dy të dyshuar shtetasi B. (19 vjeç) dhe e dashura e ti, A. (17 vjeç), ishin nën hetim. Secilit nga të akuzuarit fajësonte tjetrin për kryerjen e krimit, por i riu ishte liruar ndërkohë që dashura e tij ishte ende në paraburgim.

Artikulli përshkruante rrethanat e vrasjes dhe marrëdhëniet në mes dy të dyshuarve para se të kish ndodhur ngjarja. Në veçanti ai riprodhonte pjesë të deklaratave të shtetasit B. bërë përpara organeve të policisë dhe hetuesit të çështjes dhe komentet e bëra nga shtetësja B. Të përfshira në dosjen e çështjes ose të dhëna gjatë intervistës me Znj. Tourancheau.

Në bazë të nenit 38 të ligjit për Lirinë e Shtypit në Francë, ndaj kërkuesve nisi një hetim penal për shkak të publikimit në media të të dhënave për një çështje e cila ishte ende pezull pranë organeve gjyqësore. Kërkuesit nuk e kundërshtuan faktin se pyetjet dhe përgjigjet gjatë intervistës ishin transkriptuar identike me ato të dosjes penale, përjashto këtu disa ndryshime të vogla. Megjithatë, Znj. Tourancheau pohoi se ajo kurrë nuk kishte parë dosjen e rastit dhe kishte kopjuar ekstraktet e marra nga seancat gjyqësore dhe shënimet e shtetasit B.

Kërkuesit u deklaruan fajtor gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe ndaj secilit prej tyre u vendos një gjobë prej 10.000 franga franceze. Ky vendim u la në fuqi në apel edhe pse gjoba u pezullua. Në qershor të vitit 1999, Gjykata e Kasacionit mbajti të njëjtin qëndrim me gjykatat më të ulëta.

Në ndërkohë, më 10 qershor 1998, A. ishte dënuar me tetë vjet burgim për vrasje dhe B. kishte marrë një dënim me pesë vjet heqje lirie sepse nuk ndihmoi një person në rrezik.

2. Vendimi i Gjykatës

Në referim të nenit 10 kërkuesit pretenduan se dënimi kishte shkelur të drejtën e tyre për t`u shprehur lirisht.

Neni 10

Gjykata vërejti se dënimi i kërkuesve kishte derivuar një ndërhyrje në të drejtën e tyre për t`u shprehur lirisht.

Kërkuesit ishin dënuar në bazë të legjislacionit të fuqi, i cili konsiderohet i aksesueshëm për të gjithë. Gjykata nënvizoi se neni 38 i ligjit në fjalë përcaktonte fushëveprimin e ndalimeve ligjore në mënyrë të qartë dhe të saktë, përsa i përket përmbajtjes dhe kohëzgjatjes, si ai është projektuar për të ndaluar publikimin e dokumenteve që lidhen me krime të rënda ose procese të tjera penale deri në ditën kur do të mbahej seanca gjyqësore. Për më tepër, jurisprudenca kishte thelluar qëndrimin se ndalime të tilla shtriheshin edhe mbi ekstraktet e dokumenteve gjyqësore.

Në këto rrethana, kërkuesit, të cilët ishin gazetarë profesionistë, duhet të kishin dijeni mbi legjislacionin në fuqi dhe praktikën gjyqësore dhe mund të kishin kërkuar konsulencë juridike nga një avokat. Për rrjedhojë, ndërhyrja në fjalë mund të konsiderohen si “e parashikuar me ligj”.

Gjykata vlerësoi se qëllimet e ndërhyrjes kanë qenë për të mbrojtur “reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve”, si edhe për të ruajtur “autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.

Në këtë rast Gjykatës i mbetej për të përcaktuar nëse ndërhyrja kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Gjykata theksoi se, ndërsa hetimi i çështjes nuk kishte arritur në përfundimin për fajësinë e A. ose B., artikulli kishte mbështetur versionin e ngjarjeve të dhëna nga B., i cili ishte intervistuar nga kërkuesja, në dëm të një të miture të mbajtur në paraburgim.

Sipas Gjykatës, arsyet e dhëna nga gjykatat franceze për të justifikuar ndërhyrje në lirinë e shprehjes së kërkuesve ka qenë “relevante dhe e mjaftueshme” për qëllim të nenit 10 (2) të Konventës. Gjykatat vendase kanë theksuar pasojat e dëmshme të publikimit të artikullit në lidhje me mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të A. dhe B., për të drejtën e tyre të konsiderohen të pafajshëm, si edhe për autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit, për shkak të mundësisë së ndikimit të anëtarëve të jurisë.

Gjykata mbajti qëndrimin se interesi i kërkuesve në dhënien e informacionit në lidhje me ecurinë e procisit penal dhe fajësinë e të dyshuarve në një kohë kur

hetimi gjyqësor ishte ende në vazhdim, si dhe interesi i publikut në marrjen e një informacion të tillë, nuk ishin të mjaftueshme për të ndryshuar vlerësimin e bërë nga gjykatat vendase. Gjykata më tej vlerësoi se gjobat e vëna kërkesve nuk ishin në disproporcion me qëllimet legjitime të ushtruara nga autoritetet.

Në këto rrethana, Gjykata u shpreh se dënimi i kërkesve kishte derivuar një ndërhyrje në të drejtën e tyre për t' u shprehur lirisht, e cila kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për të mbrojtur reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve, si edhe për të ruajtur autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Prandaj, ajo vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN CRAXI k. ITALISË (nr. 2)

(Kërkesa nr. 34896/97)

5 dhjetor 2002

1. Faktet kryesore

Z. Benedetto Craxi ishte një shtetas italian i lindur në vitin 1934. I njohur më mirë me emrin Betino Craxi, ishte sekretar i Partisë Socialiste italiane dhe kryeministër i Italisë. Ai vdiq në Tunizi në janar të vitit 2000. E veja e tij dhe dy fëmijët shprehën vullnetin për të vazhduar procedurën.

Ndaj kërkuesit kishte nisur një procedim penal pas parregullsive serioze që u zbuluan në lidhje me negociatat për marrëveshje mes grupeve Eni dhe Montedison për të formuar kompaninë Enimont. Në vitin 1992 kërkuesi dhe shumë të tjerë u akuzuan për pasqyra financiare të rreme, financim të paligjshëm të partive politike, korrupsion, zhvatje dhe kundravajtje të tjera penale, të cilat ishin kryer veçanërisht gjatë kohës së shitjes së aksioneve të kompanisë Montedison ndaj Enimont. Në tërësi, ndaj tij u bënë 26 komunikime për nisje të procedimeve penale. Procedimet penale kundër kërkuesit dhe figurave të tjera politike dhe ekonomike u publikuan në shtyp.

Kërkuesi ishte thirrur për gjykim në Gjykatën e Qarkut të Milanoa në gjashtë procese gjyqësore. Ai u dënua në të gjitha proceset, por në njërin prej tyre i dhanë dënim me burg deri në tetë vjet e gjysmë.

Në rastin Eni-Sai pjesë e këtyre proceseve, kërkuesi u akuzua për korrupsion. Ai u akuzua se kishte ndikuar dhe lehtësuar një sipërmarrje të përbashkët të planifikuar në mes tri kompanive, që i përkasin sektorit të sigurimeve. U pretendua se ai dhe disa nga të pandehurit e tjerë kishin paguar në mënyrë të paligjshme shuma të mëdha për zyrtarët publikë dhe drejtorët e kompanive të sipërpërmendura.

Sipas avokatëve të tij, kërkuesi nuk kishte marrë pjesë në seancën e parë gjyqësore të zhvilluar kundër tij për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore dhe vënies në rrezik të sigurisë së tij personale. Ai nuk mori pjesë në asnjë nga 55 seancat e tjera mes prillit dhe dhjetorit të vitit 1994 për shkak të transferimit në Tunizi më 16 maj 1994. Gjatë procesit një sërë nga të pandehurit e tjerë deklaruan se dëshironin të heshtin, këto deklaratat e tyre iu bashkëlidhën dosjes gjyqësore.

Në një vendim të datës 6 dhjetor 1994, kërkuesi u dënua në mungesë me pesë vjet e gjysmë burgim. Ai apeloj pa sukses kundër këtij vendimi, duke sfiduar në mënyrë të

veçantë përdorimin e transkripteve të deklaratave të dëshmitarëve, të cilët ai i kishte shqyrtuar. Gjykata e Kasacionit rrëzoi apelin e kërkuetit më 12 nëntor 1996, duke mbajtur qëndrimin se dënimi i tij nuk ishte i bazuar ekskluzivisht në këto deklarime pasi këto thënie ishin vërtetuar edhe përmes dëshmive të dëshmitarëve.

2. Vendimi i Gjykatës

Në referim të nenit 6 të Konventës kërkueti u ankua për parregullsisë e proceseve penale kundër tij. Ai pohoi se nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe se nuk ishte qenë në gjendje për të marrë në pyetje dëshmitarët e prokurorisë ose anasjelltas. Kërkueti pretendoi gjithashtu se fushata mediatike e kryer ndaj tij kishte ndikuar tek gjyqtarët për të përcaktuar fajësinë e tij.

Neni 6 (1) dhe 6 (3) (b)

Gjykata vërejti se ankimi i kërkuetit u shpall i pranueshëm vetëm në lidhje me padrejtësitë e pretenduara gjatë procesit penal në çështjen Eni-Sai.

Gjykata nënvizoi se nga 18 tetori 1994 deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në themel, më 6 dhjetor 1994, seancat gjyqësore ishin caktuar sipas një orari për të cilin ishte rënë dakord me avokatët e kërkuetit. Për këtë arsye kërkueti nuk mund të ankohej në lidhje me faktin se seancat gjyqësore ishin caktuar pa pëlqimin e mbrojtësit të tij. Për sa i përket periudhës para 18 tetorit 1994, Gjykata vërejti se tridhjetë e tetë seanca gjyqësore janë zhvilluar për rastin e Eni-Sai, në të njëjtë ose pothuajse të njëjtën kohë, me seancat e tjera në të cilat kërkueti ishte i pandehur.

Gjykata vërejti se kërkueti nuk kishte marrë pjesë në seancën e parë gjyqësore kundër tij, pasi kishte zgjedhur me dëshirë të largohej nga Italia në Tunizi, duke zgjedhur kështu lirisht të mos paraqitej në gjykatë. Rrejdhimisht mbrojtja e kërkuetit ishte kryer nga avokatët e tij, të cilët kishin dashur të merrnin pjesë në një numër të madh seancash gjyqësore brenda një hapësire kohe të shkurtër. Megjithatë, nga provat e paraqitura përpara Gjykatës nuk u vërejt se përfaqësimi i tyre kishte qenë i mangët ose i paefektshëm. Për më tepër, avokatët e kërkuetit nuk kishin paraqitur përpara Gjykatës ndonjë shpjegim se përse ata nuk i kishin parashtruar autoriteteve deri më 9 nëntor 1994 problemet që po hasnin në përgatitjen e mbrojtjes së kërkuetit. Gjykata konstatoi se në përputhje me rrethanat e rastit se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

Neni 6 (1) dhe 6 (3) (d)

Gjykata vërejti se Kodi i Procedurës Penale italiane ka parashikuar mundësinë e përdorjes së deklaratave të të pandehurve të tjerë si prova për të fajësuar një

person gjatë gjykimit në themel të çështjes. Megjithatë, ky fakt nuk privonte të akuzuarin të paraqiste prova të tjera materiale gjatë procesit kontradiktor. Në rastin konkret, Gjykata vërejtí se vendimi i Gjykatës së Kasacionit shprehte se kërkuesi ishte dënuar vetëm në bazë të deklaratave të bëra gjatë seancave nga ana e të pandehurve të tjerë, të cilët kishin zgjedhur të mos jepnin dëshmi në gjykatë, si edhe nga një person i cili më pas kishte ndërruar jetë. Kërkuesi dhe avokatët e tij nuk kishin pasur mundësi të merrnin në pyetje dëshmitarët në fjalë dhe për pasojë nuk kishin mundur të kundërshtonin deklaratat mbi të cilat ishte vendosur fajësia e kërkuesit.

Gjykata vërejtí se avokatët e kërkuesit nuk kishin ngritur ndonjë kundërshtim në Gjykatën e Qarkut të Milanos për të kontestuar ligjshmërinë e deklaratat në dosjen në fjalë. Megjithatë, deklaratat i ishin bashkangjitur dosjes në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi në kohën materiale. Gjykata konsideroi se çdo kundërshtim nga kërkuesi do të kishte pak shanse për të qenë i suksesshëm dhe mos ngritja e një pretendimi të tillë nuk mund të interpretohet si heqje dorë në mënyrë të heshtur nga e drejta e tij për të marrë në pyetje dëshmitarët e prokurorisë, veçanërisht pas apelimit të çështjes prej tij në gjykatat e apelit dhe kasacionit. Në përputhje me këto rrethana Gjykata konstatoi se ndaj kërkuesit ka pasur shkelje të nenit 6 (1) dhe 3 (d) të Konventës.

Neni 6

Gjykata vërejtí se interesi i medias dhe publikut për rastin e Eni-Sai kishte derivuar nga posti i rëndësishëm që mbante kërkuesi, konteksti politik në të cilin veprat e pretenduara kishin ndodhur dhe natyra e gravitetit e tyre. Sipas Gjykatës, ky fakt ishte i pashmangshëm në një shoqëri demokratike, që shtypi të bëjë ndonjëherë komente të ashpra në raste të ndjeshme të tilla si çështja objekt gjykimi, e cila vendos në pikëpyetje moralin e zyrtarëve të lartë publik dhe marrëdhëniet midis politikës dhe botës së biznesit. Gjykata më tej theksoi se gjyqtarët, që ishin marrë me çështjen e kërkuesit ishin gjyqtarë profesionistë dhe se kërkuesi ishte dënuar pas zhvillimit të një procesi kontradiktor. Duhet pranuar, se Gjykata gjeti shkelje të garancive për një proces të rregullt gjyqësor, por që kishin rezultuar nga zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi në kohën e zhvillimit të procesit. Në çështjen objekt gjykimi nuk ekzistonte asnjë fakt i cili të vërtetonte se gjyqtarët, që kishin vendosur për çështjen të ishin ndikuar nga deklaratat e bëra në shtyp. Gjykata në përputhje me rrethanat konstatoi se në këtë aspekt nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

Neni 41

Gjetja e një shkelejeje të Konventës derivon në vetvete një shpërblim për kërkuesin.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN DU ROY DHE MALAURIE k. FRANCËS

(Kërkesa nr. 34000/96)

3 tetor 2000

1. Faktet kryesore

Kërkuesit Albert Du Roy dhe Guillaume Malaurie, janë shtetas francezë.

Kërkuesi i parë ishte redaktor dhe kërkuesja i dytë është një gazetare në *L'Evènement du Jeudi*, një revistë javore në Francë. Në numrat e saj ndërmjet datave 11 dhe 17 shkurt 1993, revista botoi një artikull në llogari të kërkuesit të dytë, i cili ishte kritik Michel Gagneux, ish-kreut të Sonacotra (kompanisë kombëtare të akomodimit të punëtorëve) dhe të lidhjeve të tij me menaxhimin e ri të Sonacotra-s, pasi kompania kishte ngritur një kallëzim penal dhe kish bërë një kërkesë, që të bëhej palë në çështjen civile kundër Z. Gagneux për keqpërdorim të aseteve të kompanisë.

Z. Gagneux parashtrroi ankesë ndaj kërkuesve për publikimin e informacionit pjesë e një procesi gjyqësor, një vepër penale kjo sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata Penale e Parisit i shpalli kërkuesit fajtorë dhe urdhëroi secilin prej tyre që të paguajë një gjobë prej 3,000 frangash franceze. Ata janë gjithashtu të detyruar për të paguar dëmet në lidhje me padinë civile të Z. Gagneux dhe për të publikuar vendimin. Gjykata penale vendosi se ndalimi i parashikuar në ligjin francez kishte karakter të përgjithshëm dhe absolut. Gjithashtu, gjykata penale vuri në dukje se ndalimi kishte për qëllim të garantonte prezumimin e pafajësisë dhe të parandalonte ndonjë ndikim të jashtëm në vendimamrrjen e drejtësisë. Kërkuesit apeluan kundër dënimit të tyre, por Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin. Të njëjtin qëndrim mbajti dhe Gjykata e Kasacionit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan për cenim të së drejtës së tyre për t' u shprehur lirisht garantuar nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 10

Gjykata vërejti se gazetarët që raportojnë në lidhje me procese penale të cilat nuk kanë përfunduar ende janë të detyruar të mos kalojnë kufijtë e përcaktuara në interes të administrimit të mirë të drejtësisë, si dhe për të respektuar të drejtën e

të pandehurit për t`u konsideruar i pafajshëm. Megjithatë, Gjykata çmoi se ndërhyrja në çështjen në fjalë mori formën e një ndalimi absolut dhe të përgjithshëm, duke mos lejuar publikimin e çdo forme të informacionit.

Gjykata vlerësoi se justifikimi i gjykatave franceze, duke e cilësuar ndalimin të justifikuar me qëllim mbrojtjen e dinjitetit të të tjerëve dhe garantimin e autoritetit gjyqësor, nuk ishte i mjaftueshëm, ai lidhet vetëm me procesin penal pas paraqitjes së një ankese nga ana e kërkuësve për t`u bërë palë në procesin civil dhe nuk përfshijnë hetimet e sjella nga zyra e prokurorit ose ankimet e zakonshme. Një ndërhyrje e tillë në të drejtën për informim nuk rezulton të bazohet në asnjë gjetje objektive dhe e zhvesh të gjithë shtypin nga e drejta për të informuar publikun në lidhje me bashkimin e proceseve penale me padi civile të cilat mund të jetë në interes të publikut.

Në përfundim, dënimi i gazetarëve nuk përfaqësonte një mjet të arsyeshëm të ndërmarrë në proporcion me qëllimet legjitime të ndjekura në funksion të interesit publik në një shoqëri demokratike për sigurimin dhe ruajtjen e lirisë së shtypit. Pra, ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vlerësoi se gjetja e një shkeljeje të Konventës në çështjen objekt gjykimi ishte një shpërblim i mjaftueshëm. Gjykata i akordoi kërkuësve 50,000 franga franceze për shpenzimet gjyqësore.

Cenim i nenit 10 kur ndalimi kategorik i publikimit të fotografisë së kërkuesit nuk ishte proporcional me qëllimin për të cilën ishte marrë masa

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN NEWS VERLAGS GmbH & Co. KG k. AUSTRISE

(Kërkesa nr. 31457/96)

11 janar 2000

1. Faktet kryesore

Kërkuesi News Verlags GmbH & CoKG, është një kompani me seli qëndrore në Tulln, Austri, e cila është pronare dhe botuese e një reviste të quajtur News.

Në dhjetor të vitit 1993 shoqëria ankuese botuar artikuj në revistën në fjalë në lidhje me një seri letrash bombë dërguar politikanëve dhe personave të tjerë në Austri, të cilat kishin shkaktuar disa viktima të plagosura rëndë. Artikujt, të cilët përmendnin edhe lobin austriak neo-nazist, përfshirë fotografitë e të dyshuarit, B., shoqëruar nga komente, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e quanin atë si “kryerësit” e veprave në fjalë. Pas ankimit të shtetasit të B-së, Gjykata e Apelit të Vjenës vendosi edhe në vendimin e ndërmjetëm edhe në atë përfundimtar se shoqëria kërkuese ndalohej të publikonte fotografitë e B. në zbatim të ligjit për pronësinë intelektuale dhe industriale në kontekst të procesit penal pezull kundër tij. Vendimi u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kompania kërkuese u ankua për cenim të lirisë së shprehjes garantuar nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtës për të mos u diskriminuar garantuar nga neni 14 i Konventës marrë sëbashku me nenin 10.

Neni 10

Gjykata vlerësoi se ndalimi i publikimit të fotove të B. në kontekstin e raportimit të procesit penal kundër tij përbënte një ndërhyrje në të drejtën e kompanisë kërkuese për t’u shprehur lirisht garantuar nga neni 10 (1) i Konventës. Gjykata vërejti se ndërhyrja ishte e “parashikuar me ligj” dhe ndiqte një qëllim legjitim në bazë të nenit 10 § 2 të Konventës përkatësisht “mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve”, si dhe “garantonte autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.

Në lidhje me pyetjen nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata mbajti në vëmendje kontekstin në të cilin janë shkruar artikujt që kanë ndikuar në proceset gjyqësore, përkatësisht ato për një seri të letrave bombë. Gjykata vërejti se B. ishte një ekstremist i krahut të djathtë i cili kishte hyrë

në skenën publike edhe përpara serisë së letrave-bombë dhe se veprat e tij ishin dyshuar si veprat penale dhe ndihmë ndaj sulmeve me anë të letrave bombë, ishin vepra me prapavijë politike drejtuar kundër themeleve të një shoqërie demokratike. Në këto rrethana, publikimi i fotografive të B., i cili për më tepër nuk bëri të ditur asnjë detaj të jetës së tij private, nuk cenonte të drejtën e B. për privatësi.

Gjykata vërejti më tej se Gjykata e Apelit të Vjenës kishte cituar argumentet për vendimet, ku theksohej se publikimi i fotove të B. nuk ishte në vetvete problemi, por ky publikim i kombinuar edhe me komentet fyese ndaj këtij individ i cenonin parimin e prezumimit të pafajësisë për të.

Megjithatë, Gjykata e Apelit në Vjenë ndaloi shoqërinë kërkuese të publikonte foto të B. në lidhje me çështje mbi procesin penal kundër tij, pavarësisht nga teksti shoqërues.

Gjykata pranoi se mund të ketë arsye të vlefshme për të ndaluar publikimin e fotove të të dyshuarit, në varësi të natyrës së veprës në fjalë dhe rrethanave të veçanta të rastit.

Megjithatë, Gjykata vërejti se pavarësisht arsyeve të paraqitura nga gjykata vendase, kjo gjykatë nuk kishte kryer një balancim mes të drejtës së B. për të mos publikuar fotot ndaj interesit publik në publikimin e këtyre fotove, të cilat sipas ligjit austriak kërkonin paraprakisht miratim sipas të drejtës së autorit.

Së fundi, Gjykata konsideroi se urdhërat e kontestuara kishin kufizuar zgjedhjen e shoqërisë kërkuese në paraqitjen e raporteve të saj. Ndërkohë, është i pakontestueshëm fakti se mediat e tjera kanë qenë të lira të publikonin foto të personit në fjalë gjatë gjithë kohës së zhvillimit të procesit penal kundër tij. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se ndalimi absolut i publikimit të fotove të B. ishte në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura.

Për rrjedhojë, Gjykata gjeti shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 14 i Konventës marrë sëbashku me nenin 10

Gjykata nuk e vlerësoi të nevojshëm shqyrtimin e këtij ankimi meqenëse ajo kishte vendosur se në çështjen në fjalë kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kompanisë kërkuese dëmshpërblimin prej 276,105 shilingash austriake për shpenzimet gjyqësore. Gjykata vërejti se gjetja e shkeljes së nenit 10 ishte në vetvete e mjaftueshme për dëmshpërblim material dhe jo material për kompaninë kërkuese.

Nuk ka cënim të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 kur një autor dënohet për publikimin e një artikulli që mund të ndikonte një procedim penal ndaj një figure publike

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN WORM k. AUSTRISË

(Kërkesa nr. 22714/93)

29 gusht 1997

1. Faktet kryesore

Kërkuesi Z. Alfred Worm, i lindur në vitin 1945, ishte një gazetar. Ai jetonte në Vjenë, Austri.

Kërkuesi punonte për *Profil*, një revistë periodike austriake që trajtonte kryesisht tema politike. Për disa vite, kërkuesi kishte hetuar dhe raportuar mbi rastin e Z. Hannes Androsch, një ish-zëvendës kancelar dhe ministër i financave, i cili ishte i përfshirë në procese penale që kishin të bënin me evazion fiskal dhe deklarime të rreme.

Më 1 korrik 1991, revista *Profil* botoi një artikull të shkruar nga kërkuesi, në lidhje me seancat e mbajtura më 25-26 maj 1991, në kuadër të procedimit penal për evazion fiskal. Ky artikull analizoi sjelljen e kryetarit të trupit gjykues, prokurorit, avokatit dhe në veçanti, të pandehurit Z. Androsch. Artikulli la të nënkuptohet se Z. Androsch ishte shprehur se hetimet e kryera nga organet tatimore ishin të sakta dhe ai kishte nënshkruar deklaratat e bëra nga të akuzuarit në gjykim në një situatë psikologjike kritike.

Pas kësaj, kërkuesi u akuzua në bazë të ligjit për median se kishte ushtruar ndikim në procedimin penal në fjalë, por më pas u lirua nga Gjykata Rajonale e Vjenës më 12 maj 1992. U vërejt se artikulli nuk ishte në gjendje të ndikonte në rezultatin e procesit gjyqësor kundër Z. Androsch dhe se qëllimi i kërkuesit nuk kishte qenë i tillë.

Gjithësesi, Gjykata e Apelit të Vjenës e dënoi kërkuesin për ushtrim ndikimi në një proces penal, duke vërejtur se kërkuesi kishte komentuar në mënyrë të negative përgjigjet e dhëna nga Z. Androsch gjatë gjyqit dhe se ishte e mundur që gjykatësit e çështjes të lexonin artikullin. Ajo gjithashtu vërejti se përfshirja për një kohë të gjatë e kërkuesit në hetime për çështjen përforconte idenë se artikulli ishte shkruar me qëllim për të ndikuar në rezultatin e procesit gjyqësor. Vendimi deklaronte se në vlerësim të gjykatës vendase “i akuzuari dëshironte të zinte pozitën e gjyqtarëve që gjykonin çështjen”, dhe se ai ishte i bindur se Z. Androsch kishte kryer evazionin fiskal, duke bërë edhe parashikim për dënimin e tij. Si

pasojë, ai u dënua të paguante një gjobë brej 1,200 shilingash austriake në ditë për një periudhë prej dyzetë ditës ose të kryente njëzetë ditë burgim.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi se dënimi i tij për shkak se botoi një artikull duke komentuar për një proces gjyqësor ndaj Z. Androsch përbën shkelje të lirisë së shprehjes në bazë të nenit 10 të Konventës.

Neni 10

Gjykata theksoi se ishte e pakontestueshme se dënimi ndaj kërkuesit përbën një ndërhyrje në lirinë e tij të shprehjes garantuar nga neni 10 (1) të Konventës. Gjykata u ndal për të shqyrtuar nëse ndërhyrja ishte e justifikuar në bazë të nenit 10 (2) të Konventës. Në mënyrë që një ndërhyrje në nenin 10 të Konventës të cilësohet e justifikuar, ajo duhet të jetë “e parashikuar me ligj”, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike, kushte këto të kërkuara nga paragrafi i dytë i kësaj dispozite.

Të dyja palët pranuan se neni 23 i ligjit mbi median “ndalonte ndikimin në proceset penale”. Gjykata vërejti se një ligj duhet të formulohet me saktësi të mjaftueshme për t’i mundësuar personave të interesuar të parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre. Është detyrë e gjykatave vendase të interpretojnë dhe të zbatojnë legjislacionin. Gjykata arriti në përfundimin se Gjykata e Apelit në Vjenë përmes vendimit të saj nuk ka shkuar përtej parashikimeve të ligjit vendas. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se dënimi i kundërshtuar është “parashikuar me ligj”.

Në lidhje kushtin nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim legjitim, Gjykata vërejti se nuk mund të vihej në diskutim se dënimi i kërkuesit kishte për qëllim “të garantonte autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”; një qëllim legjitim ky sipas Konventës. Për më tepër ky kriter lidhet parimisht me nenin 6 të Konventës, i cili pasqyron parimin më të rëndësishëm të shtetit të së drejtës. Sipas Gjykatës, “autoriteti i gjyqësorit” përfshin respektin dhe besimin e publikut në kapacitetin e gjykatave për të përmbushur funksionin e tyre për të qenë autoriteti i duhur në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore dhe përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së një personi. Në anën tjetër, “paanshmëria”, ka të bëjë me mungesën e paragjykimave dhe ndikimeve të gjyqësorit.

Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se argumentimi dhe dënimi i dhënë nga gjykata vendase, e cila përfshinte faktin se gjyqtarët e çështjes kishin pasur mundësi të lexonin shkrimin e kërkuesit mbi rastin dhe

njihnin ekspertizën e tij profesionale, kishin pasur për qëllim “të garantonin autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit”.

Së fundi, në lidhje me kriterin nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata përsëriti se liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike dhe se garancitë, që i duhen dhënë shtypit janë të një rëndësie të veçantë. Në mbrojtjen e kësaj lirie, Gjykata deklaroi se roli i saj ishte për të përcaktuar nëse arsyet dhëna nga autoritetet kombëtare për të justifikuar ndërhyrjen ishin “të rëndësishme dhe të mjaftueshme”. Gjykata theksoi se meqenëse gjykata vendase kishte vlerësuar se artikulli ishte në gjendje të ndikonte në rezultatin e procesit masa e marrë ishte “e rëndësishme”.

Në lidhje me faktin nëse arsyet ishin “të mjaftueshme” për të justifikuar ndërhyrjen, Gjykata çmoi se gjykatat nuk mund të veprojnë në një vakum; ka vend për diskutimin e çështjeve penale në revista të specializuara, në shtypin e përgjithshëm ose në publik. Ky fakt kontribuon në kërkesën që seancat gjyqësore të jenë publike në bazë të nenit 6 të Konventës, kjo është veçanërisht e vërtetë kur personi në fjalë është një figurë publike. Rrjedhimisht, kufijtë për të komentuar janë më të gjerë në lidhje me figura publike.

Megjithatë, Gjykata ka në vëmendje se figurat publike kanë të drejtë të gëzojnë garancitë e gjykimit të drejtë të përcaktuara në nenin 6, duke përfshirë këtu të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Kështu, kufijtë lejuar për komente nuk duhet të shtrihen në deklarata të cilat ka të ngjarë të paragjykojnë me apo pa qëllim, shanset e një personi t’ju nënshtruar një gjykimi të drejtë, ose për të minuar besimin e publikut në rolin e gjykatave për të administruar drejtësinë penale.

Më tej, Gjykata shqyrtoi arsyetimin e gjykatës së apelit në lidhje me mundësinë e artikullit për të ndikuar rezultatin e gjyqit. Gjykata çmoi se vendimi nuk ishte i drejtuar kundër të drejtës së kërkuarit për të informuar në mënyrë objektive. Përkundrazi, artikulli ishte një vlerësim në disfavor të Z. Androsch dhe përgjigjet e tij drejtonin lexuesin për të arritur në përfundimin se i pandehuri ishte fajtor për akuzat kundër tij. Gjykata u fokusua edhe në faktin se ekzistonte mundësia, që gjyqtarët në favor të Z. Androsch të ndikoheshin pas leximit të artikullit, duke marrë në konsideratë këtu profesionalitetin dhe ekspertizën e kërkuarit në fushën në fjalë. Së fundi, në lidhje me vërejtjen e gjykatës së apelit se “nga artikulli mund të arrihej në përfundimin se këruesi kishte dashur të zinte pozitën e gjyqtarëve që shqyrtonin çështjen”, Gjykata vërejtë se ajo nuk ka nevojë të provohet ndikimi, që pati artikulli në procesin penal në lidhje me mundësinë e ndërhyrjes në autoritetin e gjyqësorit. Kështu, Gjykata arriti në përfundimin se arsyetimi i dhëna nga Gjykata e Apelit të Vjenës për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e kërkuarit

për t`u shprehur lirisht ishin të mjaftueshme për qëllimet e nenit 10 (2) të Konventës. Për më tepër, Gjykata ka konfirmoi fakti që revista botuese ishte urdhëruar të jetë bashkërisht dhe individualisht përgjegjëse me kërkuesin për pagesën e saj, ishte në proporcion me qëllimin e synuar.

Pra, Gjykata vendosi se në rastin konkret nuk kish pasur cenim të së drejtës për tu shprehur lirisht.

Mbarimi i parakohshëm i mandatit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë si pasojë e shprehjes së pikëpamjeve profesionale duke mohuar edhe të drejtën e ankimit përbën shkelje të neneve 6 dhe 10

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN BAKA k. HUNGARISË

(Kërkesa Nr. 20261/12)

23 qershor 2016

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Z. András Baka, është një shtetas Hungarez i cili ka lindur në vitin 1952 dhe jeton në Budapest, Hungari.

Z. Baka, një ish gjyqëtar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, u zgjodh më 22 qershor 2009 si Kryetar i Gjykatës Supreme të Hungarisë. Ai qëndroi në detyrë për gjashtë vite për shkak se mandati tij mbaroi paraprakisht. Gjithashtu, Z. Baka mbante postin e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Drejtësisë dhe kishte kompetencë të plotë të shprehte mendimin e tij për çështje legjislative, që prekin sistemin gjyqësor.

Midis muajve shkurt dhe nëntor, Z. Baka kritikoi shumë nga reformat që preknin gjykatat, përfshirë edhe propozimin për të zvogëluar moshën e detyrueshme të daljes në pension të gjyqtarëve. Mendimet e tij u bënë publike nëpërmjet zëdhënësit të tij si dhe nëpërmjet fjalimeve të mbajtura në parlament.

Në dhjetor të 2011, u miratuan ndryshimet kushtetuese në Hungari, duke i hapur kështu rrugën krijimit të *Kuria* (emri historik i gjykatës më të lartë në hungari), që do të zëvendësonte ligjërisht Gjykatën Supreme, duke sjellë kështu përfundimin e mandatit të kryetarit saj, fill pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri themeltar.

Për pasojë, mandati i Z. Baka mbaroi më 1 janar 2012, tre vite e gjysëm përpara kohës normale të përfundimit. Sipas Kushtetutës së re kandidatët duhet të përmbushnin kriterin e të pasurit të një eksperience të paktën 5 vjeçare si gjykatës në Hungari për t' u përzgjedhur kryetar të Kuria-s.

Eksperienca si gjykatës në gjykata ndërkombëtare nuk do të merrej parasysh në përlllogaritjen e ekperiencës së kërkuar. Për rrjedhojë Z. Baka gjendej në kushtet e pamundësisë për të aplikuar për postin e kryetarit të *Kurias*.

Z. Baka pretendon se i është cenuar e drejta e tij për akses në gjykatë, duke qenë se përfundimi i parakohshëm i mandatit tij kishte ardhur si pasojë e një reforme të re kushtetuese. Kërkuesi pretendoi se për shkak të mendimeve dhe kritikave që ai

kishte shprehur për reformën e re kushtetuese, kishin ndikuar në shkarkimin e tij nga këto detyra. Ai pretendoi gjithashtu shkelje të nenit 13 të Konventës, si edhe mos respektim të nenit 14 të saj.

2. Vendimi i Gjykatës

Neni 6 § 1

Përsa i përket zbtimit të nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata vuri në dukje faktin që Z. Baka ishte zgjedhur si gjyqtar i Gjykatës Supreme në bazë të ligjit, për një mandat gjashtë vjeçar, i cili do të përfundonte në bazë të kriterëve të parashikuara nga një listë shteruese. Gjykata vërejtë se ekzistonte një mënyrë ligjore që gjykatësit të qëndronin në detyrë deri në fund të mandatit tyre normal. Ajo vuri në dukje se e drejta e kërkuarit për të vazhduar të qëndronte në detyrë deri sa mandati i tij të përfundonte sipas afateve normale ligjore ishte një e drejtë, që buronte nga parimet kushtetuese, si dhe pavarësia e gjyqësorit. Gjykata çmoi se fakti që mandati i kërkuarit mbaroi përpara afatit ligjor për shkak të hyrjes në fuqi të Kushtetutës të re nuk mund t' i ndalonte atij të kërkonte të drejtat e siguruara nga ligjet e mëparshme, në kohën e zgjedhjes së tij.

Gjykata ripërsëriti se në bazë të jurisprudencës së saj, funksionarëve publik nuk mund t' i pengohej e drejta e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës në rastet kur plotësoheshin dy kushte: së pari ligji i brendshëm duhet të përjashtojë në mënyrë të dukshme aksesin në gjykatë për kategorinë e nënëpunësve civilë si dhe kjo masë duhet të justifikohet vetëm për arsye objektive që mbrojnë interesat e Shtetit.

Për kushtin e parë, Gjykata saktësoi se Z. Baka përpara konfliktit me shtetin, nuk ishte përjashtuar shprehimisht nga e drejta e tij për akses në gjykatë. Përkundrazi, ligji i brendshëm i shtetit hungarez i jepte atij të drejtën për të kundërshtuar pushimin nga puna të një nënpunësi civil përpara Tribunalit të Punës. Megjithatë, përfundimi i parakohshëm i mandatit të kërkuarit kishte ardhur si pasojë e ligjit të ri themeltar. Pavarësisht se ai ishte larguar nga puna me anë të ligjit të vjetër në fuqi, ligji i ri i pengonte atij të drejtën për të kundërshtuar largimin nga detyra përpara tribunalit të punës.

Gjykata duhet të vendoste nëse e drejta e tij për akses në gjykatë ishte penguar nga ligji i brendshëm përpara se të merreshin masat e largimit nga detyra ndaj Z. Baka apo pasi masa e tij kishte marrë fuqi ligjore.

Gjykata doli në përfundimin se ligji i brendshëm nuk i pengonte shprehimisht kërkuarit të drejtën për të aksesuar një gjykatë dhe kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të marrë ndaj tij. Si pasojë e mosplotësimin të kushtit të parë, Gjykata

nuk mori parasysh shqyrtimin e kushtit të dytë dhe vendosi se neni 6 § 1 ishte i zbatueshëm në këtë rast. Gjykata arriti në përfundimin se mbarimi i parakohshëm i mandatit të tij nuk ishte shqyrtuar as nga gjykatat e zakonshme dhe as nga një intucion tjetër në sistemin e drejtësisë, madje nuk ishte penguar të kishte shqyrtim ligjor.

Gjykata mendonte se pengesa ligjore për shqyrtimin e çështjes vjen si pasojë e Kushtetutës së dhe se ky ligj nuk përmbush cilësitë, që duhet për të siguruar zbatimin e parimit të shtetit të së drejtës. Ajo nuk mund të linte pa përmendur rëndësinë që kishin mjetet ndërkombëtare të përdorura nga Këshilli i Evropës, si dhe ato organizata të tjera ndërkombëtare apo çështje që lidheshin me zgjidhjen sa më të drejtë të problemeve nga shkarkimet dhe largimet e gjyqtarëve, duke kërkuar ndërhyrjen e një autoriteti që ishte i pavarur nga ekzekutivi apo legjislativi në dhënien e vendimeve të kësaj natyre.

Në këto kushte Gjykata e konsideroi si të pamjaftueshme plotësimin e detyrimeve që kishte shteti për të siguruar të drejtën e Z. Baka për akses në gjykatë, dhe kjo do të konsiderohej shkelje e të drejtave të njeriut sipas neni 6 § 1 të Konventës.

Neni 10

Gjykata vuri në dukje faktin se Z. Baka kishte gjithë aftësitë dhe kompetencat për të bërë publike mendimet e tij, veçanërisht në fjalimin që mbajti në parlament në 3 nëntor 2011, për reformat parlamentare që preknin sistemin gjyqësor. Më tejherë pas bërjes publike të mendimeve të tij, në palament u propozua shkarkimi e tij nga posti i kryetarit të Gjykatës Supreme dhe mori miratimin brenda një periudhë shumë të shkurtër.

Më 9 nëntor 2011, në amendamentin kushtetues për organizimin dhe administrimin e sistemit gjyqësor, rregullat që ishin përcaktuar për zgjedhjen e kryetarit të Kuria-s përjashtonin mundësinë që Z. Baka të merrte pjesë. Duke marrë, në konsideratë të gjithë rrethanat dhe faktin që autoritet vendase nuk kishin marrë parasysh mundësinë që Z. Baka ishte kompetent për bërjen e atyre deklaratave, gjykata me shikim të parë e konsideroi si provë, lidhjen midis bërjes publike të mendimeve nga ana e Z. Baka dhe mbarimit të parakohshëm të mandatit të tij.

Për pasojë, Gjykata e konsideroi përfundimin e parakohshëm të mandatit të Z. Baka, si rezultat i mendimeve dhe kritikave që ai kishte shprehur publikisht për reformën mbi sistemin gjyqësor, pavarësisht se ai ishte brenda kompetencave të tij duke shprehur mendimin e tij lirisht. Gjykata u shpreh se një parti vendase nuk mund të legjitimohet të kërkojë pavarësinë e gjyqësorit, duke përdorur si justifikim marrjen e masës së përfudimit të mandati të Z. Baka, që ishte kryetari i Gjykatës

Supreme, përpara afateve ligjore, duke qenë se kërkuesi nuk ndodhej përpara rastit të paaftësisë profesionale ose kryerjen e një sjellje jo të përshtatshme. Në këndvështrimin e Gjykatës kjo masë nuk i shërbente qëllimit për rritjen e pavarësisë së gjyqësorit, duke qenë se vinte si pasojë e ushtrimit të kompetencave të Z. Baka për të shprehur mendimin e tij lirshëm. Në këto rrethana, Gjykata e konsideroi përfundimin e parakohëshëm e mandatit të kërkuesit, si një veprim që ishte në kundërshtim me qëllimin e rritjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe si një veprim të paligjshëm.

Gjykata vuri në dukje se mendimet e bëra publike nga Z. Baka mbi reformën në drejtësi, kishin të bënin me çështje si funksionimi dhe reformimi i sistemit gjyqësor, pavarësinë dhe garancitë ligjore, që gjyqtarët kishin për statusin e tyre si dhe për uljen e moshës së daljes në pension për 5 gjyqtarë.

Sipas Gjykatës mendimet kritike të kërkuesit nuk e tejkalonin kompetencën e tij profesionale, si dhe ishin në interes të publikut. Për rrjedhojë, mendimet e Z. Baka duhet të kishin një mbrojtje ligjore të nivelit të lartë dhe nuk duhet të kishte asnjë lloj ndërhyrje.

Në këndvështrimin e Gjykatës, ky veprim ishte i papajtuëshëm me natyën e pavarur që duhet të ketë një sistem gjyqësor, ku moscenimi i statusit të gjyqtarit është cilësia kryesore për garantimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor.

Për ta përmbledhur, përfundimi i parakohëshëm i mandatit të Z. Baka do të kishte efekte dekurajuese jo vetëm tek ai, por dhe tek gjyqtarë apo kryetarë gjykatash të tjerë, duke bërë që ato të mos merrnin pjesë në debate publike mbi temat e reformave legislative për gjyqësorin dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor. Përsa i përket anës procedurale, kufizimi i të drejtës së kërkuesit për t'u shprehur nuk ishte shoqëruar me masa mbrojtëse efektive për ta siguruar atë kundër abuzimeve mbi këtë të drejtë. Për pasojë, Gjykata e konsideroi si të pamjaftueshme arsyen që solli shteti hungarez për ndërhyrjen në të drejtën e Z. Baka për t'u shprehur lirshëm, duke mos e konsideruar atë si një mjet të duhur në shoqëritë demokratike.

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10 të Konventës. Gjykata nuk e konsideroi si të nevojshme shqyrtimin e ankesave të tjera të bëra nga kërkuesi.

Neni 41

Gjykata kërkoi që shteti Hungarez t'i paguajë kërkuesit 70,000 euro si dëmshpërbim material dhe jomaterial dhe 30,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN RADOBULJAC k. KROACISË
(Kërkesa nr. 51000/11)
28 qershor 2016

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Z. Radobuljac, ka lindur në vitin 1963 dhe jeton në Zagreb, Kroaci.

Gjatë ushtrimit të profesionit të tij si avokat, kërkuesi përfaqësuar disa paditës në një proces civil përpara Gjykatës Komunale të Vukovarit. Seanca ishte planifikuar nga gjykata për 17 dhjetor 2009. Megjithatë, kërkuesi nuk kishte pasur mundësi të merrte pjesë në këtë seancë për shkak të një defekti në automjetet edhe pse ai ka bërë çdo përpjekje të mundur për të lajmëruar gjykatën dhe përfaqësuesit e palës kundërshtare. Në këtë seancë, gjykata mori vendim për pushimin e procesit gjyqësor në bazë të nenit 216 (1) të Procedurës Civile.

Gjatë procesit në apel kërkuesi ka shpjeguar arsyen e mungesës së tij dhe gjithashtu ka deklaruar se pavarësisht se përfaqësuesi i palës kundërshtare kishte kërkuar që çështja të mos pushohej, gjykata kishte vendosur të pezullonte procesin. Kërkuesi gjithashtu bëri parashtrim mbi kompetencën e gjyqtarit, që kishte trajtuar çështjen. Ai deklaroi se “sjellja e gjyqtarit është absolutisht e papranueshme. Një sjellje e tillë jap përshtypjen se gjyqtari thjesht po vazhdonte me shqyrtimin e rastit. Ndërkohë, në thelb seanca u zhvillua thjeshtë për procedurë pa asnjë përmbajtje substanciale”. Kërkuesi u gjosit me 1,500 kuna kroate për shkak të bërjes së këtyre deklaratave. Në vendimin e tij gjyqtari i çështjes deklaroi se vërejtja e bërë nga kërkuesi ishte “fyese për gjykatën dhe gjyqtarin” dhe kështu “përbën një komunikim të papranueshëm mes gjykatës dhe një avokati që përfaqëson një nga palët në proces.”

Kërkuesi apeloj kundër këtij vendimi, duke parashtruar se vërejtja nuk ka qenë ofenduese apo fyese. Ai pohoi se qëllimi i tij ishte të nxirrte në pah paafësinë e gjykatës së shkallës së parë në kryerjen e procesit. Në korrik të vitit 2010, kjo ankese është hedhur poshtë nga Gjykata e Qarkut të Vukovarit. Gjykata Kushtetuese rrëzoi gjithashtu apelin e kërkuesit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut se vendimi i Gjykatës Komunale të Vukovarit ka shkelur lirinë e tij të shprehjes, një e drejtë e garantuar me nenin 10 të Konventës.

Gjatë shqyrtimit të nenit 10, Gjykata përsëriti se kjo dispozitë vlen si për “informacionet” ashtu edhe për “ide”, që merren në mënyrë të favorshme ose që konsiderohen si të padëmshme, por edhe për ato që fyejnë, trondisin ose shqetësojnë. Për më tepër, liria e shprehjes është e zbatueshme për avokatët, dhe mbron jo vetëm thelbin e informacionit, por edhe formën në të cilën ai përcillet. Pra, Gjykata arriti në përfundimin se gjobitja e kërkuarit përbënte ndërhyrje në lirinë e tij të shprehjes.

Në mënyrë që një ndërhyrje të jetë e justifikueshme, ajo duhet të jetë e parashikuar me ligj, të ndjek një qëllim legjitim dhe të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata konstatoi se kriteri i parë dhe i dytë janë përmbushur, sepse në rastin në fjalë ndërhyrja ishte detyrim sipas seksionit 110 (1) të Procedurës Civile dhe ndiqte qëllimin legjitim për të ruajtur autoritetin e gjyqësorit brenda kuptimit të nenit 10 (2) të Konventës. Kështu, çështja e mbetur për të vlerësuar nga Gjykata ishte nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Për këtë duhej të përcaktohej nëse ndërhyrja në fjalë ishte në proporcion me “nevojën sociale të ngutshme” që kërkohet të mbrohej.

Gjykata kreu një analizë të rolit, që avokatët luajnë në administrimin e drejtësisë, si edhe për të siguruar që gjykatat të gëzojnë besimin e publikut. Gjykata theksoi se në mënyrë që publiku të ketë besim në administrimin e drejtësisë, ata duhet të kenë besim në aftësinë e profesionistëve ligjor për të siguruar një përfaqësim efektiv. Kështu, liria e shprehjes së avokatëve ka të bëjë me pavarësinë e profesionit ligjor dhe ka një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tyre për të mbrojtur me zell interesat e klientëve. Avokatët kështu mund të thirren për të kundërshtuar apo të ankohen për sjelljen e gjykatës në mbrojtje të klientit të tyre, brenda kufijve të caktuar. Gjykata theksoi se duhet bërë një dallim mes kritikave dhe një fyerje.

Më tej, Gjykata u ndal për të shqyrtuar kontekstin, qëllimin dhe natyrën e vërejtjeve të kërkuarit, për të vlerësuar proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e tij për t`u shprehur lirisht. Gjykata vuri në dukje se vërejtja ishte bërë nga kërkuari në kontekst të procesit gjyqësor, në të cilën ai kishte qenë avokat, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të klientit të tij. Vërejtjet e kërkuarit u bënë në sallën e gjyqi dhe nuk përbënin një sulm të hapur të autoritetit të gjyqësorit. Pra, Gjykata arriti në përfundimin se gjykatat vendase nuk vendosën vërejtjet e kërkuarit brenda kontekstit dhe formës në të cilën ato janë shprehur.

Për të shqyrtuar qëllimin e deklaratave të kërkuarit, Gjykata vërejti se ishte e vështirë për të pranuar pretendimin e qeverisë se qëllimi i vetëm i këtyre vërejtjeve ishte për të diskredituar publikisht gjyqtarin. Gjykata çmoi se gjasat e pakta

të ankesës kundër vendimit të pezullimit nuk mund të interpretoheshin si një fyerje e gjyqtarit në fjalë nga kërkuesi. Gjithashtu, Gjykata rrëzoi pretendimin e qeverisë se vërejtjet nuk kishte qenë me vend ose të nevojshme. Në lidhje me natyrën e vërejtjeve të kërkuesit, Gjykata nuk çmoi se ato ishin fyese. Në anën tjetër, komentet ishin ndalur në mënyrën e zbatimit të procedurës në rastin konkret nga gjyqtari dhe nuk kishin kritikuar aftësitë e tij profesionale në mënyrë të përgjithshme.

Gjykata përsëriti se procesi i rregullt dhe garancitë procedurale të ofruara, janë faktorë që duhet të merren parasysh kur vlerësohet proporcionaliteti i një ndërhyrjeje. Duke mbajtur parasysh këtë fakt, Gjykata konstatoi se vendimi për të gjobitur kërkuesin ishte bërë nga i njëjti gjyqtar që u ndje i fyer nga vërejtjet në fjalë.

Në bazë të kësaj analize, Gjykata konkludoi se gjykatat vendase dështuan në vendosjen e balancës së duhur ndërmjet nevojës për të mbrojtur autoritetin e gjyqësorit dhe garantimit të lirisë së shprehjes së kërkuesit. Për rrjedhojë, kjo ndërhyrje nuk mund të konsiderohej si “e nevojshme në një shoqëri demokratike” dhe derivon shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi se Kroacia duhet t`i paguante kërkuesit 205 euro në kuadër të dëmit material dhe 13 euro për shpenzimet gjyqësore.

VENDIM I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN KYPRIANOU k. QIPROS

(Kërkesa nr. 73797/01)

15 dhjetor 2005

1. Faktet kryesore

Rasti ka të bëjë me një kërkesë të ngritur nga një shtetas qipriot, Michalakis Kyprianou, i cili ka lindur në vitin 1937 dhe jeton në Qipro. Ai është avokat.

Më 14 shkurt 2001, Z. Kyprianou ishte përfaqësues i një të pandehuri në një gjykim për vrasje, në Gjykatën e Assize të Limasolit. Gjatë seancës gjyqësore, ai deklaroi se ishte ndërprerë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të prokurorisë, dhe kërkoi leje për tu tërhequr, dhe duke qenë se leja nuk ju aprovua, ai pretendoi se anëtarët e trupit gjykues ishin duke biseduar me njëri -tjetrin dhe duke shkëmbyer shënime mes tyre (“ravasakia” - të cilat nënkuptojnë, ndër të tjera, letra/shënime të shkurtra dhe sekrete, apo mesazhe me përmbajtje të pakëndshme).

Gjyqtarët u shprehën se ishin “fyer thellësisht” si “njerëz” nga kërkuesi. Ata shtuan se nuk mund të “konceptonin një rast kaq të qartë dhe të papranueshëm për-buzje ndaj gjykatës nga çdo person, jo më nga një avokat” dhe se “nëse reagimi i gjykatës nuk do të ishte i menjëhershëm dhe drastik, ne mendojmë se drejtësia do të kishte pësuar një goditje katastrofike”. Ata e vunë kërkuesin para zgjedhjes, ose të mbronte atë që kishte deklaruar dhe të jepte arsyet pse ai nuk duhej dënuar ose të tërhiqej. Kërkuesi nuk bëri asnjë nga kërkesat.

Më tej Gjykata vijoi se Z. Kyprianou kishte shpërfillur gjykatën dhe e dënoi atë me pesë ditë burg, dhe urdhëroi zbatimin e menjëhershëm të vendimit si e “vet-mja përgjigje e përshtatshme”.

Kërkuesi kreu dënimin me burg menjëherë, edhe pse ishte liruar më herët, në përputhje me legjislacionin përkatës. Ankesa e tij u hodh poshtë nga Gjykata e Lartë më 2 prill 2001.

2. Vendimi i Gjykatës

Në vendimin e Dhomës të datës 27 janar 2004, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1, § 2 dhe § 3 (a) dhe se nuk ishte e nevojshme për të shqyrtuar kërkesën e kërkuesit e sipas nenit 10. Gjykata i akordoi kërkuesit 15,000 euro për dëmin jomaterial dhe 10,000 euro për kostot dhe shpenzimet.

Më 19 prill 2004, Qeveria qipriote kërkoi referimin e çështjes në Dhomë të Madhe, e cila pranoi kërkesën më 14 korrik 2004.

Parashtrimet e palëve të treta u morën nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës dhe Maltës.

Kërkuesi ankohej se në bazë të nenit 6 ai nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e cila ishte e njëjta gjykatë që kishte pretenduar se ai e kishte përbuzur dhe dënuar atë.

Neni 6 § 1

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do të shqyrtoj së pari ankimin e kërkuesit, se në rrethanat e veçanta të rastit të tij, fakti se të njëjtët gjyqtarët ndaj të cilëve kërkuesi ishte shprehur vendosën si në lidhje mbi akuzën për përbuzje kundër kërkuesit. Ky fakt ngre dyshime të justifikuara në mënyrë objektive në lidhje me paanshmërinë e kësaj gjykate.

Gjykata vërejti se ky problem procedural derivon vesim të procedimit në fjalë. Në lidhje me këtë, Gjykata mori parasysh trendin e rritjes në një numër të juridiksioneve common law duke pranuar nevojën për të përdorur një procedurë përmblledhëse në lidhje me mospërfillje të jurisprudencës së Gjykatës në masë. Megjithatë, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme apo të dëshirueshme për të shqyrtuar në përgjithësi parashikimet e ligjit vendas për përbuzjen dhe praktikën e procedurës së gjykimit të shkurtuar në Qipro dhe sistemet e tjera të të drejtës zakonore. Detyra e Gjykatës ishte për të përcaktuar nëse përdorimi i procedurës të shkurtuar në lidhje me Z. Kyprianou derivoi një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Rasti i kërkuesit lidhet me shprehje të përbuzjes për një gjykatë, me qëllim kritikimin personalisht të gjyqtarëve. Ata kishin qenë objekt i drejtpërdrejtë i kritikave të kërkuesit në lidhje me mënyrën në të cilën këta gjyqtarë zbatonin procedurën. Më pas të njëjtët gjyqtarë mori vendimin për të ndjekur kërkuesin penalisht, duke e shpallur është fajtor dhe duke e burgosur. Në një situatë të tillë ngatërrimi i roleve midis kërkuesit, dëshmitarit, prokurorit dhe gjykatësit mund të vërejë, që shkaktonte një frikë të justifikuar në mënyrë objektive si lidhje me zbatimin e procedurave ashtu edhe me parimin se askush nuk duhet të jetë gjyqtar në çështjen e tij ose të saj. Për rrjedhojë duke cenuar kështu parimin e paanshmërinë së trupit gjykues. Prandaj, Gjykata konstatoi se në bazë të fakteve të çështjes objekt gjykimi dhe duke pasur parasysh defektin funksional të gjetur, procesi ndaj kërkuesit linte hapësirë për dyshim së parimi i paanshmërisë së gjyqsorit ishte shkelur.

Gjykata më pas mori në shqyrtim ankimin e kërkuesit se gjyqtarët në fjalë kanë

grykuar mbi baza të paragrykimeve personale, një ankesë kjo drejtuar në mënyrë direkte ndaj sjelljes personale të gryqtarëve.

Grykata vërejti se gryqtarët vendas kishin shprehur në vendimin dhënë prej tyre se kërkuesi i “fyer thellë” si “individë”. Përveç kësaj, duhet theksuar se gryha e përdorur nga ana e gryqtarëve në të gjithë vendimin e tyre përcolli një ndjenjë të indinjatës dhe shokut, e cila u zhvillua në kundërshtim me qasjen që pritet nga deklarimet gryqësore. Gryqtarët pastaj vazhduan të impononin një dënim me pesë ditë burgim, të cilin ata e konsideruan të “vetmen përgjigje të përshtatshme” në lidhje me ngjarjen.

Duke pasur parasysh në veçanti elementet e ndryshme të sjelljes personale të gryqtarëve të marra së bashku, Grykata konstatoi se mosbesimi i kërkuesit në lidhje me paanshmërinë e grykatës vendase ishte i justifikuar. Së fundi, Grykata konstatoi se Grykata Supreme e Qipros nuk e kishte konstatuar dhe më pas ndrequr shkeljen në fjalë.

Grykata konkludoi se Grykata e Assize të Limassolit nuk ishte e paanshme në kuptimin e nenit e 6 § 1.

Neni 10

Grykata vlerësoi se, në rrethanat e rastit objekt grykimi një shqyrtim i veçantë i ankesës së kërkuesit për shkelje të nenit 10 është e rëndësishme.

Mund të konsiderohet se sjellja e kërkuesit ka treguar mungesë respekti ndaj gryqtarëve të grykatës vendase. Megjithatë, edhe pse komentet e kërkuesit ishin të pasjellshme ato kufizoheshin në mënyrën në të cilën gryqtarët ishin duke trajtuar çështjen, veçanërisht në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarit për të mbrojtur klientin e tij kundër një akuze për vrasje.

Prandaj, Grykata konsideron se një dënim i kërkuesit me pesë ditë burgim ishte disproporcional dhe i rëndë, duke qenë në gjendje për të shkaktuar një “efekt dekurajues” në punën e avokatëve gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si mbrojtës. Gjetjet e Grykatës për parregullsi padrejtësi procedurale në procedurën e grykimit të shkurtuar shkaktojnë në kompleks mungesë të respektimit të parimit të proporcionalitetit.

Duke qenë kështu, Grykata vlerësoi se Grykata Krimeve të Rënda ka dështuar për të arritur ekuilibrin e duhur mes nevojës për të mbrojtur autoritetin e gryqësorit dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes. Fakti që aplikanti kryer vetëm një pjesë e dënimit me burg nuk ka ndryshuar këtë përfundim.

Gjykata konkludoi se dënimi joproportional dhënë ndaj kërkuesit kishte shkelur neni 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 15,000 për dëmin jomaterial dhe 35,000 euro për shpenzimet gjyqësore.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN SALOV k. UKRAINËS

(Kërkesa nr. 65518/01)

6 shtator 2005

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Sergey Petrovich Salov, është shtetas ukrainas, i cili ka lindur në vitin 1958 dhe jeton në Ukrainë. Ai është avokat dhe, në kohën e ngjarjeve në fjalë, ishte përfaqësuesi ligjor i Olexander Moroz, kandidatit për president të Ukrainës në zgjedhjet e 1999.

Më 30 dhe 31 tetor Z. Salov dyshohej se kishte shpërndarë disa kopje të falsifikuara të një botimi special të gazetës së Parlamentit, e cila përmbante një deklaratë që i atribuonhej kryetarit të Parlamentit, duke pohuar se kandidati për president dhe presidenti aktual Leonid Kuchma kishin vdekur. Më 1 nëntor 1999 Z. Salov u arrestua dhe u dërgua në paraburgim për shpërndarjen e informacionit të rremë në lidhje me Z. Kuchma.

Më 10 nëntor 1999 ai paraqiti një kërkesë, duke kërkuar para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor lirim të tij nga burgu, kërkesë e cila u rrëzua më 17 nëntor 1999. Më 7 mars 2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor urdhëroi nisjen e një hetimi shtesë lidhur me rrethanat e rastit, pasi nuk gjeti prova për të dënuar kërkuesin lidhur me veprat penale për të cilat akuzohej. Megjithatë, më 5 prill 2000 Presidiumi i Gjykatës Rajonale, pranoi një akuzë të paraqitur nga prokuroria kundër vendimit të datës 7 mars 2000, duke e rikthyer çështjen për shqyrtim të mëtejshëm gjyqësor.

Kërkuesi u lirua nga burgu më 16 qershor 2000.

Më 6 korrik 2000 ai u dënua me 5 vjet burg me kusht për ndërhyrje në të drejtën e qytetarëve për të votuar, pasi kishte ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve përmes mashtrimit. Si rezultat i kësaj ai humbi dhe licencën e tij për ushtrimin e profesionit si avokat për tre vjet e pesë muaj.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi ankohej se ai nuk kishte dalë menjëherë përpara një gjyqtari apo një autoritet tjetër gjyqësor në mënyrë që arrestimi i tij të rishikohej. Ai gjithashtu pohoi se nuk kishte pasur një proces të rregullt gjyqësor, veçanërisht, për shkak se Presidiumi i Gjykatës Rajonale anuloi vendimin e datës 7 mars 2000. Më tej,

ai shprehu dyshime për paanësinë e gjyqtarit, duke pretenduar se legjislacioni i brendshëm i Ukrainës dhe sistemi për financimin e gjykatave nuk pengonte ndikimin e presionit të jashtëm ndaj gjyqtarëve. Ai gjithashtu pohoi se nuk e kishte ditur nëse informacioni në lidhje me vdekjen e kandidatit Z. Kuchma kishte qenë i vërtetë apo jo dhe se ai kishte bërë përpjekje për të verifikuar vërtetësinë e tij. Ai u mbështet në nenin 5 § 3 (e drejta për liri dhe siguri), nenin 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) dhe nenin 10 (liria e shprehjes) të Konventës.

Neni 5 § 3

Gjykata vuri në dukje se kërkuesi u kap nga policia më 1 nëntor 1999, por vlerësimi i masës së sigurisë me burg nuk u mor në shqyrtim nga një gjykatë deri më 17 nëntor të vitit 1999, pra 16 ditë pas arrestimit të tij. Edhe nëse Gjykata do të pranonte argumentin e qeverisë ukrainase se kërkuesi kishte ndikuar në vonimin e lirit të tij duke mos aplikuar deri më 10 nëntor, mbajtja në paraburgim e tij edhe për shtatë ditë pa ndonjë kontroll gjyqësor bie jashtë fushës së veprimit të Konventa . Për këto arsye, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 5 § 3.

Neni 6 § 1

Gjykata konstatoi se dyshimet e kërkuesit mbi paanshmërinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor mund të thuhet se janë të justifikuar objektivisht, duke marrë parasysh garancitë e pamjaftueshme ligjore dhe financiare ndaj presionit të jashtëm në procesin gjyqësor të gjyqtarit dhe, në veçanti mungesën e garancive të tilla lidhur me presionin e mundshëm nga Kryetari i Gjykatës Rajonale, natyrën detyruese të udhëzimeve të dhëna nga Presidiumi i Gjykatës Rajonale dhe arsyetimin e vendimeve të ndërmjetme gjyqësore në rastin në fjalë.

Përveç kësaj, parimi i barazisë së armëve parashikon se akt-akuza që prokurori publik kishte paraqitur para Kryesisë së Gjykatës Rajonale, duhej t'ia kishte komunikuar kërkuesit dhe/ose avokat të tij, i cili duhet të kishte mundësi objektive për të përgatitur argumentet rreth saj para se të pranohej nga Kryesia. Për më tepër, kërkuesi duhet të ishte i pajisur me një kopje të akt-akuzës të Kryesisë së Gjykatës Rajonale në mënyrë që ti jepte atij mundësinë për të përgatitur mbrojtjen e tij në gjyq. Meqenëse kjo nuk ndodhi dhe as kërkuesi e as avokatët e tij nuk ishin të pranishëm, kur akt-akuza u pranua nga Kryesia, kërkuesi u gjend para një disavantazhi të konsiderueshëm vis-à-vis kundërshtarit të tij, shërbimit të prokurorisë së shtetit.

Më tej, Gjykata konstatoi se gjykatat e brendshme nuk kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për arsye se Gjykata e Rrethit Gjyqësor fillimisht nuk kishte gjetur asnjë provë për të dënuar kërkuesin për veprat pëenale për të cilat akuzohej dhe më pas, më 6 korrik 2000, e shpalli atë fajtor për ndërhyrje në të drejtaën e votuesve.

Mungesa e një vendimi të arsyetuar pengoi edhe kërkuesin për ankimimin e çështjes në apel.

Së fundmi, zgjidhja nga Kryesia e Gjykatës Rajonale për pranimin e kërkesës së prokurorisë për të shqyrtuar zgjidhjen e 7 marsit 2000 dhe përjashtimi i saj një muaj pas miratimit mund të cilësohet si arbitrare, duke cenuar në këtë formë procesin e rregullt.

Prandaj, Gjykata konstatoi se proceset penale në tërësinë e tyre ishin të padrejta dhe për rrjedhojë konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Neni 10

Gjykata vërjeti se artikulli i kontestuar, shpërndarja e kopjeve të një gazete të falsifikuar, çështjet që kishin të bënin me interesin publik, zgjedhjet në përgjithësi dhe çështja e mbështetjes së një kandidati të caktuar.

Gjykata vërejti se, kërkuesi kishte theksuar se nuk kishte qenë në dijeni nëse informacioni ishte i vërtetë apo i rreme, ndërkohe që ai ishte duke diskutuar atë me të tjerët. Ai pretendonte se ishte përpjekur të verifikonte vërtetësinë e tij. Për më tepër, ndikimi i informacioneve që përmbante gazeta ishte i vogël pasi ai kishte shpërndarë vetëm tetë kopje të gazetës së falsifikuar dhe kishte folur me një rreth të kufizuar njerëzish, fakt ky që duhet të ishin marrë në konsideratë nga gjykatat e brendshme. Liria e shprehjes dhe diskutimi i lirë i informacionit të garantuara në nenin 10, duke pasur parasysh dhe kontekstin e veçantë të zgjedhjeve presidenciale, gjithashtu, duhet të ishin marrë parasysh nga gjykatat e brendshme për rastin e kërkuesit.

Gjykata përsëriti se, kur bëhet vlerësimi i proporcionalitetit të një ndërhyrje, natyra dhe ashpërsia e dënimeve të vendosura janë gjithashtu faktorë që duhet të merren parasysh. Në rastin e kërkuesit, dënimi i dhënë nga Shoqata e Avokatëve për heqjen e licencës në ushtrimin e profesionit të tij ka qenë një dënim shumë i rëndë.

Gjykata konstatoi se ndërhyrja në rastin konkret nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Për më tepër, vendimi për të dënuar kërkuesin për diskutimin e informacionit dhe shpërndarjen e kopjeve të një gazete të falsifikuar në lidhje me vdekjen e Presidentit Kuchma ishte haptazi joproporcionale me ndjekjen e një qëllimi legjitim. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 227.55 euro për dëmin material dhe 10,000 euro për dëmin jomaterial.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN AMIHALACHIOAIE K. MOLDOVISË

(Kërkesa nr. 60115/00)

20 prill 2004

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Gheorghe Amihalachioaie, është shtetas moldav, i cili ka lindur në 1949 dhe jeton në Chişinău. Ai është avokat dhe Kryetar Shoqatës së Avokatëve të Moldavisë.

Në rastin e referuar kundër tij nga një grup deputetësh dhe Avokati i Popullit të Moldavisë, Gjykata Kushtetuese, më 15 shkurt 2000 dha një vendim duke deklaruar antikushtetuese dispozitat ligjore që i kërkojnë avokatëve të jenë anëtarë të Shoqatës së Avokatëve të Moldavisë.

Kërkuesi kishte kritikuar vendimin në një intervistë të dhënë për një gazetë, e cila u botua në gazetën "Analiza ekonomike". Në një vendim të formës së prerë të datës 6 mars 2000, Gjykata Kushtetuese i akordoi kërkuesit një gjobë administrative ekuivalente me 36 euro për fyerje ndaj saj. Ajo e arsyetoi dënimin e saj duke u bazuar në faktin se si pasojë e botimit të vendimit "në profesionin e ligjit do të mbretërojë një kaos i plotë" dhe për shkak të kësaj ngrihej çështja nëse Gjykata Kushtetuese ishte kushtetuese. Gjithashtu, Gjykata e dënoi atë edhe për deklaratën se gjyqtarët e saj "ndoshta nuk e kanë konsideruar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut si një autoritet".

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se në bazë të nenit 10, dënimi i dhënë ndaj tij përbënte ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e tij për tu shprehur lirisht.

Neni 10

Gjykata vuri në dukje se dënimi i kërkuesit përbënte një ndërhyrje në lirinë e tij të shprehjes dhe se kjo ndërhyrje ishte e parashikuar në nenin 82 (e) të Kodit të Procedurës Kushtetuese. Ndërhyrja në fjalë kishte ndjekur një qëllim legjitim, që ishte garantimi i autoritetit dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor.

Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja në fjalë ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", Gjykata vërejti se deklaratat e kërkuesit kishin të bënin me një

çështje të interesit të përgjithshëm, e cila ishte objekt i një polemike të ashpër mes avokatëve, që ishte nxitur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për statusin e profesionit dhe e cila kishte vendosur një kufi për organizimin e avokatëve në një strukturë të vetme, Shoqatën e Avokatëve të Moldavisë, në të cilën kërkuesi ishte kryetari.

Në këtë kontekst, edhe në qoftë se mendohet se deklaratat e Z. Amihalachioaie kanë shprehur një mungesë të caktuar konsiderate ndaj Gjykatës Kushtetuese, ato nuk mund të konsiderohen si serioze apo fyese ndaj gjyqtarëve të kësaj gjykate. Për më tepër, pasi kërkuesi kishte mohuar më pas një pjesë të deklaratave që i atribuohen atij nga shtypi, Gjykata konsideroi se ai nuk mund të jetë përgjegjës për çdo gjë që ishte botuar në intervistë. Për sa i përket gjobës së vendosur ndaj tij, edhe pse shuma nuk ka qenë e konsiderueshme, ajo kishte pasur si qëllim të ndëshkonte rëndë kërkuesin, pasi Gjykata Kushtetuese ka aplikuar një gjobë që i përafrohet dënimit maksimal ligjor.

Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur një “nevojë të ngutshme shoqërore” për të kufizuar të drejtën e kërkuesit për tu shprehur lirisht dhe se autoritetet vendase nuk kanë dhënë arsye “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” që justifikojnë ndërhyrjen. Për sa kohë që kërkuesi nuk kishte tejkalluar kufijtë e kritikës të lejuar në bazë të nenit 10 të Konventës, ndërhyrja nuk mund të konsiderohej si “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Neni 41

Gjykata vlerësoi se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çdo lloj dëmi jomaterial të shkaktuar nga kërkuesi.

Kufizimet e vendosura ndaj një avokati përbënin shkelje të lirisë së shprehjes në bazë të nenit 10

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN STEUR k. HOLLANDËS

(Kërkesa nr. 39657/98)

28 tetor 2003

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Peter Steur, me profesion avokat, është shtetas holandez, i cili ka lindur në vitin 1951 dhe jeton në Oegstgeest.

Ai përfaqësonte një klient, i cili ishte akuzuar për përfitimin e sigurimeve shoqërore përmes mashtrimit. Ndaj klientit të Z. Steur ishin ngritur akuza civile dhe penale, pasi ai kishte bërë një deklaratë ndaj Z. W., një oficer gjyqësor për sigurinë sociale, në një intervistë të zhvilluar pa praninë e një përkthyesi apo avokati.

Në procesin civil, Z. Steur pretendoi se Z. W. duhet ti ketë marrë deklaratat duke ushtruar presion të papranueshëm ndaj klientit e tij. Z. W. konsideroi se këto deklaratat njëlloshnin nderin dhe dinjitetin e tij profesional dhe i parashtrroi një ankesë dekanit e shoqatës së avokatëve vendorë, i cili ja përçolli atë këshillit disiplinor.

Në vendimin e datës 1 korrik 1996, këshilli disiplinor pranoi pjesërisht ankesën e Z. W., duke konstatuar se pretendimet e Z. Steur ishin të pambështetura, dhe se ai kishte shkelur kufijtë e sjelljes së pranueshme dhe kishte dështuar në respektimin e standardeve të pritshme nga një avokat. Z. Steur parashtrroi një ankesë kundër këtij vendimi, por ai u hodh poshtë. Gjykata Disiplinore e Apelit, duke vënë në dukje se kërkuesi nuk kishte asnjë provë që mbështeste pretendimet e tij në kohën kur ishin ngritur (më pas, duke pasur vetëm konfirmimin e marrë nga klienti i tij), u shpreh se një avokati nuk i lejohej të ngrinte pretendime të tilla pa pasur asnjë bazë faktike.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua, se në bazë të nenit 10 të Konventës, vendimi i Gjykatës Disiplinore të Apelit, arsyetonte se avokatët nuk lejohen që gjatë një seance të argumentojnë duke u bazuar në fakte, për të cilat nuk kanë qenë në dijeni, se ndaj klientit të tyre është ushtruar një presion i papranueshëm.

Neni 10

Gjykata vuri në dukje se për sa kohë që kërkuesit nuk i ishte dhënë një dënim,

ai ende nuk ishte shpallur fajtor për shkelje të standardeve profesionale të aplikueshme. Kjo mund të ketë pasur një efekt dekurajues mbi të, në kuptimin që ai mund të ketë ndërë kufizimin në zgjedhjen e argumenteve për mbrojtjen e klientëve në çështjet e ardhshme. Për rrjedhojë ishte e arsyeshme të merrej parasysh se liria e shprehjes e kërkuetit ishte penguar për shkak të një “formaliteti” ose “kufizimi”.

Ajo kishte një bazë të përbashkët se ndërhyrja ishte parashikuar me ligj dhe ndoqi një qëllim legjitim, pra mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve. Gjykata vuri në dukje se komentet e kërkuetit e bënë përgjegjës për diskreditimin e Z. W. Në lidhje me këtë, ai përsëriti se kufijtë e kritikës së pranueshme në disa rrethana mund të jenë më të gjera në lidhje me ushtimin e detyrave zyrtare të nëpunësit civil se sa në raport me individë privatë. Megjithatë, nëpunësit civilë nuk privoheshin nga të gjitha llojet e mbrojtjes. Në rastin para Gjykatës, kritika e kërkuetit ishte e kufizuar për Z. W. në cilësinë e tij si oficer gjyqësor në një rast të veçantë. Ajo kishte qenë e kufizuar në sallën e gjyqimit dhe nuk përbënte fyerje personale. Kritika bazohej në faktin se klienti i kërkuetit nuk kishin kuptuar plotësisht deklaratën e tij inkriminuese, duke pasur parasysh mungesën e një përkthyesi gjatë marrjes në pyetje.

Gjykata vuri në dukje se autoritetet disiplinore nuk ishin përpjekur të vërtetonin nëse pretendimet e kërkuetit ishin të vërteta apo ishin bërë në mirëbesim. Ndërsa ishte e vërtetë se asnjë dënim nuk ishte dhënë ndaj kërkuetit, kërcënim i një shqyrtimi *ex post facto* të kritikës së tij në lidhje me mënyrën sesi ishin marrë provat nga klienti i tij vështirë të pajtohej me detyrën e tij si avokat për mbrojtjen e interesave të klientëve të tij, e cila mund të ndikonte negativisht në mënyrën se si ai ushtronte detyrat e tij profesionale. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se kufizimet në lirinë e shprehjes së kërkuetit nuk përmbushin një nevojë të ngutshme sociale dhe ishin në kundërshtim me nenin 10.

Shkelje e nenit 10 pasi kufizimet në lirinë e shprehjes së një avokati mund të pranohen vetëm në raste “të nevojshme në një shoqëri demokratike”

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN NIKULA K. FINLANDËS

(Kërkesa nr. 31611/96)

21 mars 2002

1. Faktet Kryesore

Anne Nikula, është shtetase finlandeze, e lindur në vitin 1962 me profesion avokate, e cila jeton në Helsinki. Në vitet 1992-3 ajo ka përfaqësuar si avokate mbrojtëse dy grupe në proceset penale para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në lidhje me likuidimin e kompanive, në të cilën klienti i saj akuzohej për bashkëpunim dhe nxitjen e mashtrimit dhe abuzimit për shkak të pozicionit të besuar. Një ish i dyshuar si bashkëpunor u thirr për të dëshmuar nga prokurori publik T. Kërkuesja e kundërshtoi këtë fakt dhe përgatiti parashtrime në të cilën ajo denonconte faktin se taktikat e prokurorit T. përbënin “manipulum të funksionit dhe paraqitjen e provave të kundraligjshme”, dhe “shkelje të detyrave të tij zyrtare”. Kundërshtimi i saj u refuzua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, e cila kishte marrë në shqyrtim rastin në shkallë të parë, dhe në përfundim klienti i saj u dënua.

Më tej, Prokurori T. denoncoi deklaratat e kërkueses, para Këshillit të Ndjekjes Penale të Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e akuzave të mundshme për shpifje. Këshilli i Ndjekjes Penale vlerësoi se kërkuesja ishte fajtores për shpifje, por vendosi të mos të mos e akuzojë atë, pasi vepra kishte një rrezikshmëri të ulët shoqërore.

Megjithatë, duke vënë në zbatim të drejtën e tij për ngritjen e padisë privatisht, prokurori T. paraqiti padi penale kundër kërkueses në Gjykatën e Apelit. Më 22 gusht të vitit 1994 ajo u dënua për shpifje “mosnjohjen në mënyrën e duhur”, d.m.th. thjesht duke i shprehur opinionin dikujt në lidhje me sjelljen e dikujt dhe duke i atribuar një vepër penale, ndërsa është në dijeni se kjo vepër nuk është kryer. Ndaj saj u vendos një gjobë dhe detyrimi për pagimin e dëmeve të shkaktuara ndaj prokurorit dhe shpenzimet e gjyqit. Si kërkuesja ashtu dhe prokurori ankimuan çështjen në Gjykatën e Lartë, e cila la në fuqi vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit, por i anuloi gjobën, duke pasur parasysh se shkelja kishte pasur një rrezikshmëri të ulët; dhe detyrimi për të paguar dëmet dhe shpenzimet gjyqësore mbeti po i njëjtë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua për shkelje të nenit 10.

Gjykata përsëriti se statusi i veçantë i avokatëve u jep atyre një pozicion qendror në administrimin e drejtësisë, si ndërmjetës mes publikut dhe gjykatave. Një qëndrim i tillë shpjegon kufizimet e zakonshme për sjelljen e anëtarëve të Shoqatës së Avokatëve. Për më tepër, gjykatat - garantuesit e drejtësisë, roli i të cilave është thelbësor në një shtet të bazuar në shtetin e së drejtës - duhet të gëzojnë besimin e publikut. Duke pasur parasysh rolin kyç të avokatëve në këtë fushë, është e arsyeshme të mendojmë se ata kontribuojnë në administrimin e duhur të drejtësisë, dhe për rrjedhojë ruajtjen e besimit të publikut në ta.

Më tej, Gjykata risolli në vëmendje se neni 10 mbron jo vetëm thelbin e ideve dhe informacionin e shprehur, por edhe formën në të cilën ato janë përçuar. Ndërsa avokatët kanë sigurisht të drejtën të komentojnë në publik lidhur me administrimin e drejtësisë, kritika e tyre nuk duhet të kalojë disa kufij. Në lidhje me këtë, duhet të merret parasysh nevoja për gjetjen e ekuilibrit të duhur midis interesave të ndryshme të përfshira, ndër të cilat hyn e drejta e publikut për marrjen e informacionit në lidhje me pyetje që ngrihen për vendimet gjyqësore, dhe kërkesave të administrimit të duhur të drejtësisë dhe dinjitetit të profesioneve të ligjit. Autoritetet kombëtare kanë një kufi të caktuar vlerësimi për të përcaktuar nevojën e një ndërhyrje, por ky kufi është subjekt i mbikëqyrjes evropiane si për rregullat respektive ashtu dhe për vendimet ku ato zbatohen.

Gjykata vërejti se kufijtë e kritikës së pranueshme në disa rrethana mund të jenë më të gjera lidhur me ushtrimin e kompetencave të nëpunësve civilë sesa në lidhje me individët privatë. Megjithatë, nuk mund të thuhet, se nëpunësit civilë me vetëdije rrezikojnë për të shmangur shqyrtimin e imtësishëm të çdo fjale të tyre dhe të veprojnë në të njëjtën mënyrë si politikanët e për rrjedhojë të trajtohen në mënyrë të barabartë me këta të fundit, kur vjen fjala për kritikën dhe veprimet e tyre. Nga ana tjetër, mbrojtja e nëpunësve civilë mund të jetë e nevojshme nga sulmet verbale fyese dhe abuzive kur ata janë në krye të detyrës.

Kërkuesja ishte dënuar pasi kishte kritikuar prokurorin për vendimet e marra në cilësinë e tij si palë në procesin penal në të cilën kërkuesja mbronte një nga të akuzuarit. Ishte e vërtetë se kërkuesja akuzonte prokurorin T. për veprime të paligjshme, por kjo kritikë i është drejtuar strategjisë së qëllimshme të zgjedhur nga prokurori T., që do të thotë, se ai kishte marrë dy vendime të veçanta në gjykim dhe që, nga këndvështrimi i kërkueses, përbënin “manipulim të funksionit ... shkelje të detyrës së tij zyrtarë”. Edhe pse disa nga kushtet ishin të papërshtatshme, kritika e saj ishte e kufizuar në mënyrë rigorozë në performancën e T. si prokuror në rastin kundër klientit të kërkueses, në dallim nga kritika e fokusuar në cilësitë e përgjithshme profesionale ose cilësi të tjera të T-së. Në këtë kontekst procedural

T. duhej të toleronte kritikën e ngritura nga kërkuesja në cilësinë e avokatit mbrojtës. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje, se parashtrimet e kërkueses ishin të kufizuara brenda sallës së gjyqit, në krahasim me kritikën kundër një gjyqtari apo prokurori të shprehura për shembull në media. As Gjykata nuk gjeti shkelje të kritikës së kërkueses ndaj prokurorit, duke pasur karakter procedural, kështu për qëllim fyerjen personale.

Më tej, Gjykata ritheksoi se, edhe nëse kërkuesja nuk ishte anëtare e Shoqatës së Avokatëve dhe për rrjedhojë nuk i nënshtrohej procedurave disiplinore, ajo ende ishte objekt mbikëqyrje dhe shqyrtimi nga ana e gjykatës. Nuk kishte asnjë tregues se prokurori T. i kërkoi kryetarin të trupit gjykues për të reaguar ndaj kritikave të kërkueses në ndonjë formë tjetër se sa duke vendosur mbi kundërshtimin procedural të mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit të prokurorit në çështjen në fjalë. Në fakt, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, u vetëkufizua për hedhjen poshtë të këtij konstatimi. Megjithatë, kryetari i trupit gjykues mund të kishte ndërprerë parashtrimet e kërkueses dhe bërë vërejtje, edhe në mungesë të një kërkesë për këtë qëllim nga ana e prokurorit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor mund edhe të kishte revokuar emërimin e saj si avokate sipas skemës së ndihmës ligjore apo përjashtimin e saj si avokate në gjyq. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se roli i gjykatave dhe kryetarit të trupit gjykues është drejtimi i procesit në mënyrë të tillë që të garantojë mbarëvajtjen e duhur të palëve në proces dhe mbi të gjitha preocesin e rregullt dhe të paanshëm - në vend që të lërë hapësira diskutimi lidhur me përshtatshmërinë e deklaratave të një pale në sallën e gjyqit në proceset vijuese.

Pas padisë të iniciuar privatisht nga prokurori T., kërkuesja u dënua vetëm për shpifje nga pakujdesia. Gjykata e Lartë e hodhi poshtë dënimin kundër saj, duke e konsideruar shkeljen si një kundravajtje të lehtë. Edhe në qoftë se gjopa e vënë ndaj saj u hoq, detyrimi i saj për të paguar dëmet dhe shpenzimet gjyqësore mbeti i po i njëjti. Pavarsisht nga kjo, rreziku i shqyrtimit ex post facto të kritikave të avokatit të palës tjetër në një proces penal - të cilat pa dyshim që prokurori publik duhet ti marrë në konsideratë - vështirë të pajtohet me detyrën e avokatëve mbrojtës për të mbrojtur interesat e klientëve të tyre me zell. Ndjekur kjo nga fakti se në radhë të parë vetë avokati duhet të jetë, objekt i mbikëqyrjes nga ana e trupit gjykues, për të vlerësuar rëndësinë dhe dobinë e një argumenti të mbrojtjes, pa u ndikuar nga një "dekurajim" i mundshëm madje edhe një sanksion relativisht i lehtë penal, ose një detyrim për të paguar kompensim për dëmin apo shpenzimet e shkaktuara.

Prandaj vetëm në raste të veçanta kufizimi - edhe me anë të një dënim penal të lehtë - i lirisë së shprehjes së avokatit mbrojtës mund të pranohej si i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Të dyja vendimet, si ajo e Këshillit të Ndjekjes Penale, duke mos ngritur akuza kundër kërkueses dhe mendimi i pakicës së Gjykatës së

Lartë, bëjnë me dije se autoritetet vendase kanë qenë shumë larg unanimitetit për ekzistencën e arsyeve të mjaftueshme për rastin në fjalë. Sipas opinionit të Gjykatës arsye të tilla nuk ishin provuar se ekzistonin dhe për rrjedhojë kufizimi i lirisë së shprehjes së Znj. Nikula nuk i përgjigjej një “nevoje të ngutshme sociale”. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 10, për sa kohë që vendimi i Gjykatës së Lartë la në fuqi dënimin e kërkuësës dhe urdhëroi atë të paguajë dëmet dhe shpenzimet gjyqësore, të cilat nuk ishin në proporcion me qëllimin legjitim që kërkohet të arrihet.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuësit 5,042 euro për dëmin jomaterial, 1,900 euro për dëmin material dhe 6,500 euro për kostot dhe shpenzime gjyqësore.

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN MORICE k. FRANCËS

(Kërkesa nr. 29369/10)

23 prill 2015

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Z. Oliver Morice ishte avokat francez dhe anëtar i Shoqatës së Avokatëve. Ai përfaqësonte Znj. Borrel, të venë e gjyqtarit francez Bernard Borrel, trupi i vdekur i të cilit u gjet 80 km larg qytetit të Dijoboutit në tetor 1995.

Në vitin 1997 hetimi për këtë çështje iu ishte caktuar gjyqtarëve M. dhe L.L. Sipas kërkesës të parashtruar nga Z. Morice dhe kolegut të tij në 21 qershor 2000, Seksioni i Padive të Gjykatës së Apelit të Parisit rrëzoi vendimin e gjyqtarëve, të cilët nuk pranuan të bënin rikrijimin e skenës së krimit në prani të palëve civile, duke u hequr në këtë mënyrë çështjen dhe transferimin e saj një gjyqtari të ri, gjyqtarit P.

Në 1 gusht të vitit 2000, gjyqtari i ri përgatiti një raport me vërejtjet e mëposhtme lidhur me rastin e Z. Borrel: një video-inçizim i bërë në Djibouti në mars të vitit 2000 gjatë hetimit në terren nga ana e gjyqtarëve dhe ekspertëve nuk i ishte bashkangjitur dosjes hetimore gjyqësore dhe nuk ishte regjistruar si provë materiale; më pas, me kërkesën e tij, atij i ishte dhënë një kasetë, nga gjyqtarja M., në një zarf që i ishte dërguar kësaj gjyqtareje së bashku me një letër të shkruar me dorë nga prokurori publik i Dijboutit; ku ishte përdorur një gjuhë joformale (duke ju drejtuar me “ti”), e cila shpifte për Znj. Borrel dhe avokatët e saj, duke i akuzuar ata për “organizimin e manipulimit”.

Më 6 shtator 2000 Z. Morice dhe kolegët e tij i shkruan Ministrin Francez të Drejtësisë, duke u ankuar për mangësitë e vërejtura në raportin e gjyqtarit P. dhe duke i referuar sjelljes së Gjyqtarëve M. dhe L.L., të cilat ishin “në kundërshtim të plotë me parimin e paanshmërisë dhe drejtësisë”.

Ata kërkuan kryerjen e një hetimi nga Inspektorati i Përgjithshëm i Shërbimeve Juridike në lidhje me “mangësitë e shumta ... që u sollën në dritë në rrjedhën e hetimit gjyqësor”. Një ditë më pas, pjesë të kësaj letre së bashku me deklaratat e bëra para një gazetari nga Z. Morice, u botuan në një artikull në gazetën *Le Monde*. Gjithashtu, artikulli i referohej procesit disiplinor ndaj gjyqtarës M., e cila ishte përgjegjëse dhe në pritje para Komisionit Kombëtar të Shërbimit Ligjor, në veçanti për zhdukjen e dokumenteve të Z. Morice, i cili kishte kërkuar largimin

e Gjyqtares M. nga hetimi dhe në 2000, në një vendim kundër Shtetit për neglizhencën e madhe nga ana e gjykatave për zhdukjen e dosjes “Scientology” nga zyra e gjyqtares M.

Në tetor të vitit 2000 gjyqtarët M. dhe L.L. paraqitën një ankesë penale kundër kryeredaktorit të *Le Monde*, gazetarit që kishte shkruar artikullin dhe Z. Morice, duke i akuzuar ata për veprën e shpifjes publike ndaj një nëpunësi civil. Në vitin 2008, Z. Morice u shpall fajtor nga Gjykata e Apelit të Rouenit për kryerjen e kësaj veprë në bashkëpunim.

Z. Morice ankimoi vendimin në Gjykatësn e Apelit të Rouenit. Më 10 nëntor 2009, Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë ankesën në paragrafet e ligjit, duke konstatuar veçanërisht se kufijtë e lejuar mbi lirinë e shprehjes dhe kritikën e drejtuara ndaj veprimeve të gjyqtarëve ishin tejkaluar. Përbërja e Gjykatës së Kasacionit ishte e ndryshme nga ajo shpallur fillimisht para palëve: prania e gjyqtarit J.M. i dha shkas paraqitjes së një ankese nga ana e kërkuarit për shkak se ky gjyqtar, më 4 korrik të vitit 2000, në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të Parisit, ka shprehur mbështetjen e tij për gjyqtaren M. në kuadër e procesit disiplinor për çështjen “Scientology”.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 7 maj 2010. Më 11 qershor 2013, Seksioni i Pestë konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Z. Morice bëri kërkesë për referimin e çështjes në Dhomë të Madhe në bazë të nenit 43.

Kërkuesi pretendonte se ka pasur shkelje të parimit të paanshmërisë në bazë të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt) të Konventës në procedurat para Gjykatës së Kasacionit dhe se liria e tij e shprehjes e parashikuar në nenin 10 (liria e shprehjes) të Konventës ishin shkelur për shkak të dënimit të tij për veprën penale të shpifjes në bashkëpunim.

Neni 6 § 1

Sipas jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë duhet të përcaktohet në bazë të një testi subjektiv, ku duhet të mbahet parasysh bindja personale dhe sjellja e gjyqtarit të caktuar, që lidhet me faktin, nëse gjyqtari ka pasur njëashmëri personale ose ka paragjykuar çështjen në një rast të caktuar; si dhe në bazë të një testi objektiv, duke sqaruar se dhe gjykata vetë, ndër të tjera përbërja e saj, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në lidhje me paanshmërinë e saj.

Gjykata vuri në dukje se Z. Morice kishte pranuar se nuk ishte vërtetuar që gjyqtari J.M. kishte shfaqur ndonjë paragjykim personal kundër tij. Megjithatë, ai argumentoi se prania e gjyqtarit J.M. kishte krijuar një situatë, e cila justifikonte frikën e tij për mungesën e paanshmërisë, pasi ai kishte shprehur mbështetjen e tij ndaj gjyqtarës M., 9 vjet më parë për çështjen Scientology. Për rrjedhojë Gjykata mori në shqyrtim çështjen nga këndvështrimi i testit objektiv të paanshmërisë, duke ju referuar faktit nëse dyshimet e Z. Morice mund të konsiderohen si objektivistisht të justifikuar referuar rrethanave të çështjes në fjalë.

Së pari, gjuha e përdorur në vitin 2000 nga gjyqtari J.M. në mbështetje të gjyqtarës M., ankesa e të cilës kishte çuar para një gjykimi penal Z. Morice, linte vend për dyshime në mendjen e kërkuesit lidhur me paanshmërinë e trupit gjykues në çështjen e tij. Sipas Gjykatës nuk mund të anashkalohej konteksti shumë i veçantë i çështjes, që kishte të bënte me një avokat dhe një gjyqtar, i cili kishte qenë i përfshirë edhe në fazën e hetimit gjyqësor, në veçanti në dy raste të profilit të lartë. Duke vepruar në këtë formë, pasi duke theksuar se kërkuesi ishte dënuar në bazë të një ankese të ngritur nga gjyqtarja M., Gjykata vërejti se vendimi i Gjykatës së Apelit qartazi kishte krijuar një lidhje midis vërejtjeve të Z. Morice në rastin Borrel dhe zhvillimeve në rastin e Scientology, të cilat derivonin në bindjen se ekzistonin armiqësi personale nga ana e Z. Morice ndaj gjyqtarës M. Ishte pikërisht vendimi për të cilin kërkuesi kishte apeluar në paragrafet e ligjit, që ishin shqyrtuar nga Gjykata e Kasacionit, në të cilën pjesë e trupit gjykues ishte dhe gjyqtari J.M.

Përveç kësaj, Z. Morice nuk ishte informuar se gjyqtari J.M. do të ishte pjesë e trupit gjykues dhe nuk kishte asnjë arsye për të besuar se ai mund të ishte pjesë e këtij trupi gjykues, dhe në këtë mënyrë nuk kishte asnjë mundësi për të kundërshtuar praninë e gjyqtarit J.M. ose për të bërë parashtrime lidhur me parimin e paanshmërisë.

Gjykata u shpreh se frika e Z. Morice mund të konsiderohej objektivistisht e justifikuar dhe se për këto arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 10

Nuk ishte në diskutim fakti nëse dënimi i Z. Morice përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së tij për lirinë e shprehjes, siç parashikohet në Lirinë e Aktit të Mediave të Shkruara të 1881, me qëllim mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve. Për rrjedhojë, Gjykata pranoi këtë dhe vazhdoi me shqyrtimin nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, nëse ishte në përpjesëtim me ndjekjen e qëllimit legjitim, dhe nëse arsyet e dhëna nga gjykatat e brendshme ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme.

Nisur nga statusi i kërkuesit si avokat dhe debati për një çështje të interesit publik, Z. Morice mbështetej në të drejtën e avokatëve për të mbrojtur klientët e tyre nëpërmjet shtypit. Sipas Gjykatës, në lidhje me statusin dhe lirinë e shprehjes së avokatëve, duhej bërë dallimi në varësi të faktit nëse vërejtjet e avokatit ishin bërë brenda apo jashtë sallës së gjyqit. Avokatët nuk mund të barazohen me gazetarët, duke qenë pozicionet e tyre respektive dhe funksionet në proceset gjyqësore janë të ndryshme në thelb, ku vërejtjet e bëra në sallën e gjyqit kanë një shkallë tolerance më të lartë. Në një kontekst tjetër avokatët duhet të shmangnin komentet në kuadrin e një kritike të panevojshme personale, pa pasur një lidhje të drejtpërdrejtë me faktet e rastit. Pra, në rastin konkret, Gjykata ka dështuar në shqyrtimin e faktit sesi deklaratat e Z. Morice mund të kenë ndikuar drejtpërdrejt në detyrën e tij për të mbrojtur klienten e tij, Znj. Borrel, për sa kohë që hetimi gjyqësor deri në atë kohë i ishte besuar një gjyqtari tjetër, i cili nuk ishte subjekt i kritikave.

Më tej, kërkuesi e kishte mbështetur të drejtën e tij në informimin e publikut lidhur me mangësitë e procedurave të vazhdueshme, për të kontribuar në një çështje me interes publik. Gjykata mbajti qëndrim se vërejtjet e tij, të cilat kishin të bënin me funksionimin e gjyqësorit dhe trajtimin e çështjes Borrel, binin brenda kontekstit të një debati mbi një çështje të kësaj natyre, pasi publiku ka pasur një interes legjitim për t'u informuar lidhur me proceset penale.

Në këtë kontekst, autoritetet kishin një hapësirë të ngushtë vlerësimi lidhur me kufizimin e lirisë së shprehjes.

Lidhur me natyrën e vërejtjeve të kontestuara të kërkuesit mbi integritetin profesional dhe moral të gjyqtarëve M. dhe LL, Gjykata mbajti qëndrim se ato ishin kritika mbi vlerat, dhe si të tilla nuk mund të konsideroheshin si prova, por megjithatë duhet të kishin një bazë faktike të mjaftueshme. Gjykata konstatoi se në rastin në fjalë ekzistonte një bazë e tillë dhe se ishte e mjaftueshme. Ajo kishte marrë në shqyrtim provat, përkatësisht video-inçizimi i bërë në Djibouti, nuk i ishte bashkangjitur dosjes që i ishte dërguar gjyqtarit të ri, i cili kishte hartuar një raport për të regjistruar këtë fakt. Përveç kësaj, pasi gjyqtari P. kishte bërë një sërë vrojtimesh faktike, në mënyrë të veçantë në lidhje me mungesën e provave materiale të vulosura dhe prania e letrës së shkruar me dorë që tregonte dashamirësi të veçantë nga ana e prokurorit publik të Djiboutit ndaj gjyqtarës M. dhe ë fund duke akuzuar palët civile në "organizimin e manipulimit".

Së fundmi, Z. Morice kishte vepruar në cilësinë e tij si avokat në dy raste të profilit të lartë, në të cilën gjyqtarja M. ishte gjyqtarja hetuese, dhe në dy prej rasteve, janë identifikuar mangësi në procedurë, duke çuar në tërheqjen e çështjeve nga gjyqtarja M. me kërkesën e kërkuesit. Sipas vërejtjeve të Z. Morice, ata konsideroheshin se kishin lidhje mjaft të ngushta me faktet e çështjes dhe nuk mund të

ishin çorientuese apo të pajustificuara. Gjykata theksoi se në lidhje me këtë fakt, jo vetëm që autoritetet e Djiboutit e kishin mbështetur që nga fillimi teorinë e vetëvrasjes, por edhe disa përfaqësues të atij shteti ishte implikuar personalisht në hetim e mëtejshëm.

Gjykata përsëriti se, në kuadër të nenit 10, ajo duhet të merrte në konsideratë rrethanat dhe natyrën e përgjithshme kundër të cilit janë drejtuar deklaratat në fjalë. Në rastin në fjalë, natyra e përgjithshme e çështjes mund të shpjegohet jo vetëm me sjelljen e gjyqtarëve të çështjes dhe marrëdhënien e Z. Morice me njërin prej tyre, por edhe nga rasti tepër i veçantë, i cili kishte pasur një shtrirje ndër-shtetërore dhe një mbulimi mediatik të gjerë. Edhe pse rasti në fjalë ishte i një rëndësie dhe konteksti të veçantë, Gjykata e Apelit ka bërë një interpretim të zgjeruar të gjuhës së përdorur nga Z. Morice, për të cilën Gjykata nuk ishte dakord, duke qenë se termi “bashkëpunim i heshtur” në vetvete nuk do të mund të përbënte një sulm serioz ndaj nderit dhe dinjitetit të personave të përfshirë.

Gjykata arsyetoi se komentet e Z. Morice nuk mund të merreshin thjesht si shprehje e thjeshtë e armiqësisë së tij personale ndaj gjyqtarës M., edhe pse përfshinin një kontekst më të gjerë, ku gjithashtu përfshiheshin një avokat dhe një gjyqtar tjetër. Përveç kësaj, edhe pse komentet e Z. Morice reflektonin disa pakënaqësi, ato lidheshin me mangësitë e pretenduara në hetimin gjyqësor - çështje për të cilën një avokat duhet të jetë në gjendje të tërheqë vëmendjen e publikut.

Për të garantuar autoritetin e gjyqësorit, Gjykata pranoi se vërejtjet e Z. Morice nuk mund të dëmtonin mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore. Edhe pse gjyqtarët janë të detyruar të jenë të rezervuar, pasi mund të jetë e nevojshme mbrojtja e tyre nga sulmet e rënda, të dëmshme dhe të pabazuara, kjo nuk mund të ndalojë individët të shprehin pikëpamjet e tyre mbi çështjet me interesi publik në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë, përmes gjykimit të vlerave duke u bazuar në fakte të mjaftueshme. Më tej, për të njëjtat arsye, dënimi i kërkuesit nuk mund të konsiderohet se i shërben garantimit të autoritetit të pushtetit gjyqësor. Megjithatë, Gjykata theksoi nevojën e garantimit të autoritetit të gjyqësorit dhe garantimin e marrëdhënieve të bazuara në konsideratë të ndërsjellë dhe respektin mes aktorëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë.

Përsa i përket argumenteve të parashtruara nga Autoritetet se Z. Morice duhet të kishte përdorur mjetet juridike në dispozicion dhe jo median për të mbrojtur klientin e tij, Gjykata vuri në dukje se qëllimi fillestar i kërkuesit kishte qenë zgjidhja e çështjes duke përdorur mjetet juridike në dispozicion. Gjykata vuri në dukje se referimi i çështjes në Seksionin e Padive të Gjykatës së Apelit të Parisit tregoi se qëllimi fillestar i Z. Morice kishte qenë zgjidhja e çështjes duke përdorur mjetet juridike në dispozicion, por në atë fazë Seksioni i Padive nuk mund të shqyrtonte

ankesa të tilla, për shkak se ajo ua kishte hequr çështjen gjyqtarëve M dhe L.L. Për më tepër, kërkesa për një hetim drejtuar Ministrit të Drejtësisë nuk ishte një mjet juridik, por një kërkesë e thjeshtë për hetimin e një subjekti administrativ ndaj vendimit diskret të ministrit. Më tej, Gjykata vuri në dukje se kundër Z. Morice nuk ishte ngritur asnjë proces disiplinor. Për më tepër, kërkesa për kryerjen e një hetimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nuk mund të cilësohet si një mjet gjyqësor, por si një kërkesë e thjeshtë për një shqyrtim administrativ. Gjykata më tej vuri në dukje se kundër Z. Morice nuk ishin ngritur gjykime disiplinore për shkak të deklaratës së tij në shtyp.

Në lidhje me masat e marra Gjykata përsëriti se në vlerësimin e proporcionalitetit të një ndërhyrje natyra dhe ashpërsia e gjobave mund të jenë faktore që duhet të merren parasysh. Gjykata vuri në dukje se dënimi i Z. Morice nuk ishte një dënim penal: ky sanksion i vendosur ndaj tij nuk ishte “më i lehti i mundshëm”, po ishte i një rëndësie të veçantë, dhe statusi i tij si avokat e bënte më të besueshëm dhe justifikonte ashpërsinë e madhe.

Për sa më sipër, Gjykata konstatoi se vendimi kundër Z. Morice për veprën penale të shpifjes në bashkëpunim, mund të konsiderohet si një ndërhyrje joproportionale në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes, e panevojshme në një shoqëri demokratike dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi se Franca duhet ti paguante kërkuarit 15,000 euro për dëmin jomaterial dhe 4,270 euro në lidhje me dëmin material dhe 14,400 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

Nuk ka pasur shkelje të lirisë së shprehjes kur një avokat u gjobit për mashtrim të autoriteteteve dhe shpifje ndaj betimit të një eksperti

VEDNIMI PËR ÇËSHTJEN FUCHS k. GJERMANISË

(Kërkesat nr. 29222/11 & 64345/11)

27 janar 2015

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Ulrich Fuchs, është shtetas gjerman i cili ka lindur në 1958 dhe jeton në Miesbach. Ai është me profesion avokat.

Kërkuesi kishte në pronësi një apartament në Mynih, të cilin ia dha me qira shoqatës H., e cila nga ana e saj ia lëshoi me nën-qira një grupi njerëzish që luftonion tendencat ndaj pedofilve. Më 11 dhjetor 2003, apartamenti u kontrollua nga policia. Një ditë më pas, kërkuesi shkoi në stacionin e policisë, ku për pak kohë u lëshua një urdhër kontrolli nga një gjykatë, duke ju drejtuar një grupi të quajtur “AG Pado”. Për sa kohë që kërkuesi nuk mund të paraqiste autorizimin e përfaqësimit të grupit me këtë emër, atij i ishte refuzuar dhënia e një kopje të urdhër-kontrollit. Më 15 dhjetor 2003, kërkuesi, përfaqësoi shoqatën H., ku depozitoi një ankesë penale tek prokurori publik, duke pretenduar se klientit të tij nuk i ishte paraqitur një urdhër-kontrolli, dhe për rrjedhojë nuk ishte ekzekutuar nga policia.

Prokurori publik inicioi hetimet penale kundër personave të panjohur, të cilat u ndërprejnë më 10 mars të vitit 2004, pasi policia kishte siguruar informacionin se incidenti nuk kishte qenë një vjedhje, por një kërkim i kryer nga policia në bazë të një urdhër-kontrolli.

Më tej, ndërsa, përfaqësonte një klient të akuzuar se ka shkarkuar pornografi me fëmijë në kompjuterin e tij, në tetor të vitit 2004, Z. Fuchs pretendoi me shkrim para gjykatës, se një ekspert privat i caktuar nga prokuroria për të deshifruar të dhënat e fotografive - i cili kishte bërë betimin para marrjes së detyrës tek autoritetet ligjore - mund të ketë manipuluar këto fotografi në mënyrë që të marrë rezultatin e kërkuar nga prokuroria. Në veçanti, Z. Fuchs deklaroi se kompania për të cilën eksperti ka punuar kishte një interes personal në daljen e rezultate të suksesshme, pa marrë parasysh nëse rezultatet ishin të sakta.

Eksperti parashtrroi një padi penale kundër Z. Fuchs, i cili si përfundim ishte dënua për mashtrim të autoriteteteve në lidhje me kryerjen e një vepre penale dhe shpifjes, dhe ishte dënua me gjobë nga një vendim përfundimtar, që u la në fuqi në apel në shtator të vitit 2007. Në një proces vijues para një gjykate disiplinore për avokatët, ndaj Z. Fuchs ju tërhoq vërejtje dhe ju vendos një gjobë për shkelje

të detyrës së tij në ushtrimin e profesionit në mënyrë të përgjegjshme dhe të qenit i denjë për statusin e tij profesional. Përfundimisht, ky vendim u la në fuqi në apel, në shkurt 2011.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se dënimet penale dhe disiplinore të vendosura ndaj tij kishin shkelur të drejtën e tij për tu shprehur lirisht në bazë të nenit 10 të Konventës dhe se proceset kryesore të këtyre dënimeve shkelnin të drejtat e tij sipas nenit 6 të Konventës.

Neni 10

Gjykata pranoi se dënimi i kërkuesit cenonte të drejtën e tij për tu shprehur lirisht. Për një ndërhyrje të justifikuar, ajo duhet të jetë “e parashikuar me ligj”, në ndjekje të një qëllimi legjitim të përcaktuar në nenin 10 § 2 të Konventës, dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Gjykata pranoi se ishte “e parashikuar me ligj”, sepse dënimi ishte i bazuar në dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit Federal për Profesionin e Ligjit. Për më tepër, Gjykata pranoi se dënimi i kërkuesit për mashtrimin e autoriteteve i shërbente qëllimit për mbrojtjen e funksionit të prokurorisë publike në parandalimin e rrëmujave apo krimeve dhe se dënimi për shpifje ndiqej nga një qëllim legjitim për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të ekspertit të betuar.

Në lidhje me faktin nëse masat ishin “të nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata theksoi se pyetja që ngrihej ishte nëse ndërhyrja i përgjigjej një “nevoje shoqërore urgjente”, nëse ishte në përpjesëtim me ndjekjen e qëllimit legjitim dhe nëse arsyet e sjella nga autoritetet vendase për të justifikuar atë ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Në këtë kontekst, Gjykata bëri të ditur se në rastin në fjalë kërkuesi ishte avokat profesionist dhe dënimi ndaj tij lidhej me ushtrimin e këtij profesioni. Gjykata iu referua rastit të tij të mëparshëm, rast i cili nxirrte në pah parimet specifike që duhen zbatuar nga profesionistët e ligjit. Statusi i veçantë i avokatëve u akordon atyre një pozicion qendror në administrimin e drejtësisë si ndërmjetës mes publikut dhe gjykatës. Për më tepër, gjykatat, garantuesit e drejtësisë, duhet të gëzojnë besimin e publikut. Duke pasur parasysh rolin thelbësor të avokatëve, është e arsyeshme të presim që ata të kontribuojnë në administrimin e duhur të drejtësisë, dhe duke bërë të mundur ruajtjen e besimit të publikut ndaj gjykatave.

Duke zbatuar parimet e mësipërme të fakteve të këtij rasti, Gjykata vërejti se gjykatat vendase, e bazuan dhënien e dënimit penal dhe disiplinor të kërkuesit për mashtrim të autoriteteve, ë faktin se kërkuesi me vetëdije ka paraqitur

informacion jo të plotë dhe për rrjedhojë mashtrues në kërkim të vëmendjes publike, duke shkaktuar në këtë formë nxitjen e hetimeve të kota nga ana e prokurorisë publike. Gjykata vuri në dukje se dënimi i kësaj vepre është i arsyetuar në bazë të Konventës për ruajtjen e funksionimit të prokurorisë publike për mbrojtjen e rendit publik dhe parandalimit të krimit.

Në lidhje me dënimin për shpifje të kërkuesit, Gjykata vërejtë se gjykatat vendase kishin konstatuar se parashtrimet e kërkuesit si mbrojtës përmbanin deklarata se eksperti H., kishte propozuar të dhëna të reja për marrjen e rezultatit të dëshiruar nga prokuroria publike dhe se ai kishte një interes personal në falsifikimin e provave. Gjykata vërejtë se deklaratat fyese nuk përmbanin asnjë kritikë objektive të punës së ekspertit në rastin konkret, por kishin për qëllim zhvlerësimin total të punës të tij dhe konstatimin si të pavlefshme të gjithë rezultateve të ekspertit për të mbuluar në këtë mënyrë paaftësinë e tij në shpalljen të pafajshëm të klientit të tij përmes mjeteve juridike. Gjithashtu, Gjykata vërejtë se ekspertët e betuar duhet të jenë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre nga ndikime të jashtme të paligjshme nëse duan që kryerja e detyrave të tyre të jetë e suksesshme dhe për rrjedhojë duhet të mbrohen në përputhje me rrethanat e rastit.

Përfundimisht, Gjykata konstatoi se gjambat e vendosura ndaj kërkuesit nuk ishin në disproporcion me qëllimin e ndjekur dhe për rrjedhojë nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës për sa kohë që ndërhyrja ishte e parashikuar sipas Konventës. Më tej, Gjykata, hodhi poshtë kërkesën në përputhje me nenin 35 § 3 (a) dhe § 4 të Konventës.

Neni 6

Kërkuesi u ankua në lidhje me mospranimin nga ana e gjykatave disiplinore për të bërë rekurs për çështjen e tij lidhur me procesin penal kundër klientit të tij K., duke parashtruar se kjo do të kishte zbuluar faktin se urdhri për kontroll kishte qenë i paplotë dhe i paligjshëm dhe se ekspertiza e paraqitur nga eksperti H. në të vërtetë kishte qenë e pasaktë. Për më tepër, gjykatat vendase kishin dështuar në marrjen në shqyrtim të kërkesës së kërkuesit lidhur me faktin nëse të dhënat e raportuara në akuzën e tij penale kishin qenë të sakta, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e tij për t'u dëgjuar drejtësisht. Në lidhje me dënimin e tij për shpifje, kërkuesi u ankua se gjykatat kishin dështuar në marrjen parasysh të faktit që kritika ishte e bazuar në ekspertizën e ekspertëve.

Gjykata i shpalli këto kërkesa të papranueshme pasi i gjeti të pabazuara sipas nenit 6. Ajo konstatoi se nuk kishte asnjë të dhënë se argumentet e ndryshme nuk janë shqyrtuar si duhet nga gjykata gjermane dhe se procedurat nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

**VENDIMI PËR ÇËSHTJEN MUSTAFA ERDOGAN DHE TË TJERËT
k. TURQISË
(Kërkesat nr. 346/04 & 39779/04)
27 maj 2014**

1. Faktet Kryesore

Kërkuesit ishin Mustafa Erdogan, shtetas turk i lindur në vitin 1956, Z. Haluk Kursad Kopuzlu, shtetas turk i lindur në vitin 1975, dhe Liberte A. Ş., një shoqëri aksionere turke dhe botues dhe redaktori i “Liberal Thinking”, një revistë tre-mujore ligjore.

Në vitin 2001, Z. Erdogan, profesor i së drejtës kushtetuese, botoi një artikull në revistën tre-mujore ligjore, redaktuar nga Z. Kopuzlu, ku kritikonte gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese lidhur me vendimin e tyre për shpërndarjen e një partie politike të quajtur Fazilet, e cila dyshohej se kryente veprimtarinë e saj në kundërshtim me parimet e laicizmit. Artikulli ngrinte dyshime nëse, si një çështje e së drejtës, ishin plotësuar kushtet për shpërbërjen e partisë politike, dhe më tej linte të kuptohej se gjyqtarët ishin të paafte dhe potencialisht mungonte paanshmëria e tyre në këtë çështje.

Tre gjyqtarët në fjalë nisën tre procese të ndara kundër kërkuesve, duke pretenduar se artikulli ishte një sulm i rëndë personal i nderit dhe integritetit të tyre. Kërkuesit pretenduan se artikulli ishte i bazuar në fakte dhe se nuk i kalonte kufijtë e kritikës së lejueshme ndaj gjyqtarëve. Vendimet e gjykatave vendase hynë në fuqi nga viti 2002 deri në 2004, duke arsyetuar se shprehjet e përdorura në artikull përbën shpifje pasi shprehnin mungesën e pavarësisë dhe kompetencës nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesit u urdhëruan të paguanin dëmshpërblim për secilin gjyqtar.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit, duke u mbështetur në nenin 10 të Konventës, u ankuan se vendimet e gjykatave kombëtare, të cilat i urdhëronin ata të paguanin dëmet për shpifje ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kishin shkelur të drejtën për tu shprehur lirisht.

Neni 10

Gjykata konstatoi se ankimi ndaj vendimeve të gjykatave kombëtare nga kërkuesit

përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes. Për të qenë në një linjë me Konventën, ndërhyrja duhet të jetë e parashikuar në ligj, në ndjekje të një qëllim legjitim, dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata vuri në dukje se në të vërtetë masa ishte e parashikuar sipas legjisllacionit turk. Prandaj, çështja ngrihej nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikuar si “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve (qëllimin legjitim i parashikuar brenda kuptimit të nenit 10 § 2).

Në shqyrtimin nëse ndërhyrja ishte e justifikuar si “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata rikonfirmoi se mbrojtja që garanton neni 10 mbulon “informacion” ose “ide” që lidhen me fyerjen, tronditjen ose shqetësimet. Gjykata theksoi se testi “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”, kërkon përcaktimin nëse ndërhyrja konsiston në një “nevojë të ngutshme sociale”. Në veçanti, Gjykata duhet të përcaktonte nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për të justifikuar ndërhyrjen ishin “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” dhe nëse masa e marrë ishte “në proporcion me ndjekjen e qëllimeve legjitime”.

Gjykata u shpreh se çështjet në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë përbëjnë çështje të interesit publik, debati mbi të cilat gëzon mbrojtjen e nenit 10. Ajo gjithashtu vuri në dukje se jurisprudenca e mëparshme ka theksuar rëndësinë e punimeve akademike të pavarura. Për rrjedhojë, shtrimi për shqyrtim të kujdesshëm mbi çdo kufizim për lirinë e akademikëve për të kryerjen e kërkimeve dhe publikimit e rezultateve të tyre ishte në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës. Gjykata vijoi më tej se kjo liri, garantonte dhe pavarësinë e akademikëve për të shprehur lirshëm pikëpamjet dhe mendimet e tyre, edhe në rast se ato ishin të diskutueshme.

Më tej, Gjykata vërejtë se përmbajtja e artikullit në fjalë i referohej një çështje të rëndësishme dhe aktuale në një shoqëri demokratike, për të të cilat publiku kishte një interes legjitim në të drejtën për tu informuar dhe për këtë arsye artikulli në fjalë kontribuonte në një debat me interes të përgjithshëm, përkatësisht funksionimin e sistemi i drejtësisë, një institucion thelbësor për një shoqëri demokratike. Pra, kur bëhet fjalë për kritikën ndaj veprimeve të tyre, anëtarët e gjyqësorit që veprojnë në cilësinë e një zyrtari, si në rastin në fjalë, mund të jetë subjekt i kufizimeve më të gjera të kritikës së lejueshme sesa qytetarët e thjeshtë, ashtu sikurse politikanët vetëm në një masë pak më të vogël. Megjithatë, kjo duhet të jetë e balancuar me faktin se gjyqësori luan një rol të veçantë në shoqëri, si garantues i drejtësisë dhe për rrjedhojë duhet të gëzojë besimin e publikut. Gjykata deklaroi se mund të jetë e nevojshme mbrojtja e besimit ndaj sulmeve shkatërruese, të cilat në thelb janë të pabazuara.

Në vendosjen e ekuilibrit mes dy interesave (“e drejta për përçimin e opinionit të Erdoganit mbi një temë me interes të përgjithshëm me të drejtën e gjyqtarëve për

t'u mbrojtur ndaj fyerje), Gjykata vërejtë se ishte i nevojshëm qartësimi i dallimit mes kritikave dhe fyerjes, për shkak se nëse në parim, qëllimi i vetëm i çdo forme të shprehjes është të fyesh një gjykatë, ose anëtarë të kësaj gjykate, sanksioni i duhur nuk do të përbënte shkelje të nenit 10 të Konventës. Sipas Gjykatës, artikulli i kontestuar ishte i ashpër dhe fyesh, por opinionet ishin kryesisht gjykime mbi vlerat që ishin bazuar në mënyrën sesi Gjykata Kushtetuese kishte vendosur për çështje të caktuara dhe mbi debatin aktual publik rreth punimeve të saj, dhe për rrjedhojë mund të thuhet se kishin një bazë të mjaftueshme faktike. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se gjykatat vendase nuk arritën të dallonin gjykimet mbi vlerat nga deklaratat e faktit të përfshira në artikull. Gjykatat vendase as nuk kanë shqyrtuar nëse janë respektuar “detyrat dhe përgjegjësitë” që kërkohen prej kërkuesve brenda kuptimit të nenit 10 § 2 të Konventës, apo të kenë vlerësuar faktin nëse artikulli ishte botuar në mirëbesim.

Gjykata arriti në përfundimin se vërejtjet e forta dhe të ashpra akuzuese të përfshira në artikull, të përcaktuara në terma të përgjithshme, në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të interpretohen si një sulm i paarsyeshëm personal ndaj kërkuesve, duke pasur parasysh përmbajtjen e artikullit si një i tërë dhe kontekstin në të cilën është shprehur (një tremujor kuazi-akademik në krahasim me një gazetë të njohur). Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se ndërhyrja në lirinë e shprehjes të kërkuesve nuk ishte e bazuar në arsye të mjaftueshme për të treguar se ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve. Pra, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi se Turqia duhej t'i paguante kërkuesit, Z. Erdogan, një vlerë të caktuar në euro në lidhje me dëmin material të barabartë me dëmet e paguara prej tij në lidhje pretendimet e parashtruara nga ana e tre gjyqtarëve Znj. F.K., Z. Y.A. dhe Z. B.M., dhe 7500 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Në lidhje me pretendimin për shpërblimin e drejtë nuk është bërë asnjë kërkesë nga Z. Kopuzlu apo botuesi i kërkuesit dhe për këtë arsye nuk është akorduar asnjë vlerë për secilin prej tyre.

Nuk ka pasur shkelje të nenit 10 kur Kryetari i Gjykatës së Lartë u shkarkua pasi vendimi bazohej aftësitë për të ushtruar në mënyrën e duhur detyrën e tij, dhe jo ushtrimin e lirisë së shprehjes

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN HARABIN k. SLOVAKISË

(Kërkesa nr. 58688/11)

20 nëntor 2012

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Z. Štefan Harabin, shtetas sllovak, ishte gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Ai kishte qenë kryetari i Gjykatës së Lartë që nga qershori i 2009 (pas mbajtjes më parë të këtij prozicioni mes viteve 1998 dhe 2003) dhe po ashtu kishte qenë Ministri i Drejtësisë së Republikës së Sllovakisë nga korriku 2006 deri në qershor 2009.

Në korrik dhe gusht të vitit 2010, Z. Harabin, në cilësinë e Kryetarit të saj, pengoi një grup auditi të udhëzuar nga Ministri i Financave për kryerjen e auditimit në Gjykatën e Lartë, qëllimi i të cilit ishte shqyrtimi i përdorimit të fondeve publike, efikasitetit dhe menaxhimit financiar dhe eliminimit të mangësive të identifikuara në auditimin e mëparshëm. Pas kësaj kërkuesi njoftoi ministrin e financave se ministrisë i mungonte baza ligjore dhe fuqia për kryerjen e auditimit dhe se ajo ishte Zyra e Lartë e Auditimit, e cila kishte autoritetin për ta bërë këtë lidhur me parimin e pavarësisë së gjyqësorit.

Në nëntor të vitit 2010, pas kërkesës nga Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë inicioi një proces disiplinor para Gjykatës Kushtetuese kundër Z. Harabin për pengim të auditimit. Gjatë procesit, Ministri i Drejtësisë kundërshtoi tre gjyqtarë kushtetues për anshmëri, me arsyetimin se ata kishin pasur një marrëdhënie personale me Z. Harabin për disa vite dhe që ishin propozuar në ato poste nga e njëjta parti politike. Gjithashtu Z. Harabin kundërshtoi katër gjyqtarë të ndryshëm kushtetues për anshmëri. Ai argumentoi se dy prej tyre kishin bërë deklaratë negative ndaj tij në media për dy raste të ndryshme, që gjyqtari i tretë ishte anëtar i të njëjtës dhomës me dy gjyqtarët e tjerë, dhe se i katërti ishte dënuar për mospagim të taksave dhe ishte kritikuar për mos marrjen parasysh së një kërkesë nga Gjykata Kushtetuese që rishikimin e pozicionit të tij si gjyqtar. Në përgjigje të këtyre kundërshtimeve, asnjë prej gjyqtarëve nuk e konsideronte veten të njëanshëm dhe, në maj 2011, Gjykata Kushtetuese vendosi të mos përjashtojë asnjë nga shtatë gjyqtarët e caktuar për çështjen. Gjykata Kushtetuese theksoi se përcaktimi i shkeljes disiplinore që dyshohej se ishte kryer nga Z. Harabin ishte kompetencë ekskluzive e sesionit të tij plenar, dhe konsiderohej se formalizmi i tepruar për-bënte rrezik për kryerjen e një procesi joefektiv.

Më 29 qershor 2011, Z. Harabin u shpall fajtor dhe u dënua me një masë disiplinore, e cila konsistonte në reduktimin në masën 70% të pagës së tij vjetore.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 20 shtator 2011.

Duke u bazuar në nenin 6 (e drejta për një proces të rregullt), Z. Harabin ankohej se procedurat para Gjykatës Kushtetuese kishin qenë të padrejta, duke pretenduar se një numër i gjyqtarëve të cilët vendosën për rastin e tij ishin të njëanshëm. Ai gjithashtu parashtroi një sërë ankesash të tjera, duke përfshirë dhe faktin se Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar gabimisht dispozitat përkatëse për atë që përbëjnë elementët e një vepre të rëndë disiplinore. Ai më tej u ankua se ishte ndëshkuar për opinionet e tij ligjore; se e drejta e tij për respektimin e pasurisë ishte dëmtuar; se ishte diskriminuar në gëzimin e të drejtave të tij sipas neneve të mëparshme, dhe se nuk kishte pasur në dispozicion mjete efektive për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes), 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës), 13 (e drejta për zgjidhje efektive) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës.

Neni 6

Pasi theksoi se detyra e tij në çështjen konkrete ishte vetëm përcaktimi nëse të drejtat e kërkuarit ishin respektuar sipas Konventës në procesin para Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilës ai ishte dënuar për shkelje disiplinore, Gjykata vazhdoi të shqyrtojë kërkesën lidhur dyshimin mbi paanshmërinë e gjyqtarëve kushtetues.

Gjykata theksoi se ishte veçanërisht e rëndësishme që garantimi i së drejtës për proces të rregullt sipas nenit 6 është respektuar në gjykimin e filluar nga një qeveri kundër një gjyqtari në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, duke qenë se besimi i publikut në funksionimin e gjyqësorit në nivelin më të lartë kombëtar ishte në rrezik. Sipas ligjit slovak, procedurat disiplinore kundër Kryetarit të Gjykatës së Lartë mund të vendosen vetëm nga një shumicë plenare e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, e vendosur para një situatë ku shtatë nga trembëdhjetë gjyqtarët e saj ishin kundërshtuar nga palët për anshmëri, duhej të balancoje nga njëra anë nevojën për t'iu përgjigjur kërkesave për përjashtimin e këtyre gjyqtarëve dhe nga ana tjetër nevojën për të ruajtur pushtetin e saj për të vendosur për çështjen. Gjykata vlerësoi se, duke vepruar në këtë formë, Gjykata Kushtetuese nuk kishte arritur në mbajtjen e qëndrimit të duhur referuar garancive të nenit 6. Së pari, dy prej gjyqtarëve të kundërshtuar nga Z. Harabin dhe dy prej gjyqtarëve të kundërshtuar nga ministri ishin përjashtuar në një proces më

të hershëm gjyqësor para se Gjykata Kushtetuese të përfshinte Z. Harabin. Duke pasur parasysh se dyshimet kishin të ngjarë të lindin në lidhje me paanshmërinë e tyre; Gjykata Kushtetuese duhet të paraqiste në mënyrë të qartë argumente bindëse se pse kundërshtimet nuk do të mund të pranohen në një proces disiplinor. Së dyti, Gjykata Kushtetuese nuk ka mbajtur një qëndrim nëse ndonjë nga palët mund të kishte theksonte shkaqë të tjera.

Arsyet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese, që do të thotë nevoja për të garantuar pushtetin e saj për të vendosur mbi çështjen, nuk mund të justifikojë pjesëmarrjen e gjyqtarëve në lidhje me mungesën e supozuar të anshmërisë, për arsye se Gjykata Kushtetuese bindshëm nuk ka arritur të zhdukë dyshimet. Për rrjedhojë, e drejta e Z. Harabin për një proces të rregullt nga një gjykatë e paanshme ishte shkelur.

Duke pasur parasysh këtë përfundim, dhe duke marrë në konsideratë se ai kishte vetëm kompetenca të kufizuara për t'u marrë me gabimet e fakteve ose ligjit gjatë të zbatuar nga gjykatat vendase, gjykata nuk e pa të nevojshme shqyrtimin veçmas të kërkesave të tjera të Z. Harabin në lidhje me padrejtësinë e pretenduar ndaj procesit disiplinor të nisur kundër tij.

Për më tepër, kërkesat e tjera shtesë të Z. Harabin ishin shpallur të papranueshme, pasi ata ose ishin haptazi të pabazuara ose ai nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore në lidhje me to.

Neni 10

Z. Harabin ishte dënuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë edhe pasi Gjykata Kushtetuese të kishte konstatuar se ai kishte dështuar në respektimin e detyrimeve të tij lidhur me administrimin e gjykatave siç ishte përcaktuar në legjislationin përkatës të brendshëm. Kjo ishte sjellja profesionale e kërkuar në kuadër të administrimit të drejtësisë dhe në lidhje me një autoritet tjetër shtetëror, i cili përfaqësonte aspektin thelbësor të rastit dhe përcaktonte zbatimin e dënimit të kontestuar. Për rrjedhojë nuk përbën një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së kërkuar për lirinë e shprehjes siç garantohet në nenin 10 të Konventës.

Neni 1 Protokollit Nr. 1

Sipas Z. Harabin, dënimi i vendosur ndaj tij dhe masa e marrë në reduktim në 70% të pagës së tij vjetore, ishte joproporcional dhe në kundërshtim me të drejtën për respektimin e pasurisë së tij. Edhe pse dënimi përbente një ndërhyrje në të drejtën e lartpërmendur, ndërhyrja ishte e parashikuar në ligj (d.m.th. në Kushtetutë dhe nga gjyqtarët dhe nga Ligji për Ekspertët i vitit 2000) duke ndjekur një qëllim legjitim në interes të publikut (p.sh. për të siguruar monitorimin e përdorimit

të përshtatshëm të fondeve publike dhe pajtueshmërisë nga ana e kërkuarit mbi detyrimet e tij ligjore si Kryetar i Gjykatës së Lartë). Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se dënimi nuk ka qenë në kundërshtim me kërkesat sipas nenit 1 të Protokollit 1 dhe për rrjedhojë e rrëzoi këtë pjesë të kërkesës si e pabazuar.

Neni 14

Në shqyrtimin e shkeljes së pretenduar të së drejtës së kërkuarit për të mos diskriminimin e tij në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas Konventës ose Protokolleve të saj (në rastin në fjalë, përkatësisht e drejta për një proces të rregullt, liria e shprehjes dhe mbrojtja e pronës), Gjykata konstatoi se kërkuari nuk ishte trajtuar ndryshe në lidhje me individë të tjerë në situatë të njëjtë me të tijën. Po ashtu dhe kjo pjesë e kërkesës është rrëzuar nga Gjykata.

Neni 13

Gjykata përsëriti se kur kërkuari pretendon shkeljen e një të drejte sipas Konventës nga autoriteti më i lartë gjyqësor i sistemit të brendshëm ligjor, zbatimi i nenit 13 është i kufizuar në mënyrë absolute. Prandaj, Gjykata hodhi poshtë edhe këtë kërkesë.

Neni 41

Gjykata vendosi se Sllovakia duhet ti paguante Z. Harabin 3,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 500 euro për kostot dhe pagesat.

Shkelje e nenit 10 një redaktori iu vendos gjobë për botimin e një artikulli që kritikon profesionalizmin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN HRICO K. SLOVAKISË

(Kërkesa nr. 49418/99)

20 korrik 2004

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Andrej Hrico, ishte shtetas sllovak i cili kishte lindur në 1949 dhe jetonte në Košice, Sllovaki. Ai ishte botuesi kryeredaktori i revistës javore Domino efekt.

Në vitin 1994 dhe 1995 revista javore botoi tre artikuj në lidhje me një padi për shpifje që ishte depozituar në gjykatën sllovake nga Z. Dushan Slobodnik, një ministër i cili më vonë u bë një anëtar i Parlamentit, kundër Z. L'ubomír Feldek, një shkrimtar i cili kishte botuar një deklaratë duke parashtruar ndër të tjera, se Z. Slobodnik ka pasur një të kaluar fashiste.

Artikulli i titulluar “Sllovakia është e qeverisur nga një kaos absolut ligjor”, që përmbante dhe një intervistë me ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, i cili ishte edhe avokati i Z. Feldek në gjykimin për shpifje. Ai shprehu opinionin se gjyqtari Š., i cili kishte kryesuar dhomën e Gjykatës së Lartë dhe që kishte dëgjuar ankesën e Z. Slobodnik, ishte shprehur për vendimin e tij për rastin para se të merrej vendimi përfundimtar. Një artikull tjetër kritikonte vendimin e “përgatitur nga Gjyqtari Š.”, i cili përshkruhej si një “farsë juridike” dhe shqyrtimi i kërkesës me sukses vijoi në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Në shtator të vitit 1995, gjyqtari Š. paraqiti një padi kundër kërkuesit duke argumentuar se artikujt kishin dëmtuar dinjitetin e tij në jetën private dhe profesionale dhe dobësuar autoritetin e tij si gjyqtar të Gjykatës së Lartë.

Më 11 mars 1999, Gjykata Rajonale e Košice konstatoi se termat e përdorura, tregonin qartazi se qëllimi i deklaratave ka qenë të fyejë, poshtërojë dhe të diskreditojë personin që kritikohej dhe se gjyqtarit Š. në përputhje me rrethanat kishte të drejtë për kompensim për humbjen që ishte shkaktuar ndaj tij. Gjykata urdhëroi kërkuesin ti paguante 50,000 korunas sllovake (rreth 1,125 euro) për dëmin jomaterial.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi se gjoba e vendosur kundër tij përbënte shkelje të së drejtës së tij për tu shprehur lirisht të garantuar sipas nenit 10 të Konventës.

Gjykata përsëriti parimin themelor se çdo ndërhyrje në lirinë e shprehjes së një personi duhet të jetë “e parashikuar me ligj”, duhet të jetë në ndjekje të një qëllim legjitim parashikuar sipas Nenit 10 § 2 të Konventës dhe duhet të jetë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Gjykata rikonfirmoi hapësirën e vlerësimit të shteteve kontraktuese, kur vjen puna për të vlerësuar nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme”, por ajo theksoi se ishte roli i Gjykatës për të përcaktuar nëse ndërhyrja në fjalë ishte në proporcion me ndjekjen e qëllimit legjitim dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për të justifikuar ndërhyrjen ishin “të rëndësishme dhe të mjaftueshme”.

Për sa më sipër, Gjykata konstatoi se nuk është kontestuar nëse ndërhyrja, në formën e gjobës, ishte “e parashikuar në ligj”, siç është parashikuar në nenin 11 të Kodit Civil, dhe as ishte kontestuar nëse ndërhyrja kishte ndjekur një qëllim legjitim për të ruajtur autoritetin e gjyqësorit dhe mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të gjyqtarit në fjalë. Megjithatë, ajo që ngrihej si diskutim në këtë rast ishte nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Gjykata vuri në dukje se në thelb të dy intervistave dhe artikullit të kontestuar qëndronte fakti i padiskutuueshëm se gjyqtari Š. ishte kandidat për zgjedhje në listën e Bashkimit Kristian-Socialist, një parti e cila kishte qëndrim të qartë dhe gjerësisht të njohur në pozita dominuese nga autoritetet sllovaqe gjatë periudhës 1939 deri në 1945.

Këndvështrimi që është shprehur ose nënkuptuar si në intervistë dhe në artikull, ishte se një gjyqtar që kishte bërë publik qëllimin e tij për t’u përfshirë në politikë dhe për të mbështetur partinë në fjalë duhet të kishte hequr dorë nga procesi për shpifje, i cili prekte drejtpërdrejt të kaluarën e dyshuar fashiste të paditësit, një ish-ministër i Qeverisë, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjykata gjithashtu pranoi se gjuha e përdorur në artikullin e kontestuar, sidomos përshkrimi i gjykimit si “një farsë juridike”, ishte e fortë. Më tej artikulli vinte në dukje se gjyqtari Š. kishte qenë përgjegjës për vendimin, përsa kohë që ai kishte qënë pjesë e panelit të përbërë nga 3 gjyqtarë.

Pavarsisht të gjitha këtyre, Gjykata rikonfirmoi rëndësinë e shtypit në një shoqëri demokratike dhe detyrën e tij për të dhënë informacion dhe ide. Ajo vijoi me tej se liria gazetareske, përfshin tendencën e ekzagjerimit deri në një farë shkalle, dhe madje edhe provokimin. Për më tepër, Gjykata kujtoi se kufijtë e asaj që konsiderohen si kritikë e pranueshme për një gjyqtar që hyn në jetën politike janë më të gjera, se sa për një person privat. Çështje të interesit publik, duke përfshirë edhe pyetje në lidhje me funksionimin e gjyqësorit, janë me interes të veçantë

për publikun e gjerë; të cilët dhe vetë kanë të drejtë për të marrë këtë informacion. Megjithatë, Gjykata përsëriti se kjo nuk do të thotë, që gjykatat nuk duhet të mbrohen nga sulmet e pabazuara.

Gjykata arriti në përfundimin se nuk mund të thuhet që qëllimi i deklaratave në fjalë ishte për të ofenduar, fyer dhe për të diskredituar personin e kritikuar. Procesi gjyqësor, në të cilën gjyqtari që u kritikua kishte qenë i përfshirë dhe gjatë të cilit u komentuan artikujt e kontestuar në lidhje me një çështje me interes të përgjithshëm, ku ndër të tjera ka ekzistuar dhe një debat politik. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se arsyet e dhëna nga autoritetet publike për të justifikuar ndërhyrjen nuk mund të konsideroheshin si “të mjaftueshme”.

Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuarit 1,250 euro për dëmin material dhe 1,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Gjykata i akordoi 780 euro në lidhje me shpenzimet dhe pagesat.

Nuk ka shkelje të nenit 10, kur interesat në mbrojtjen e dinjitetit të gjyqtarëve porotë prevalojnë ndaj interesit të kërkuesit për t'u shprehur lirisht

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN BARFOD k. DANIMARKËS
(Kërkesa nr. 11508/85)
22 shkurt 1989

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi ishte qytetar danez, i lindur në vitin 1919. Profesionin e tij ishte punues i gurëve të çmuar. Ai banonte në Narssaq të Grenlandës.

Në vitin 1979, kur Qeveria Lokale e Grenlandës vendosi vënien e taksave ndaj shtetasve daneze që punojnë në bazën amerikane në Grenlandë, ku një numër i personave të prekur e kundërshtoi këtë vendim para Gjykatës së Lartë të Grenlandës. Ata argumentonin se vendimi ishte i paligjshëm për arsye se ata nuk kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet lokale në Grenlandë dhe nuk marrin ndonjë përfitim nga autoritetet e këtij vendi. Rasti u mbajt në Gjykatën e Lartë të përbërë nga një gjyqtar profesionist dhe dy gjyqtarëve porotë¹²⁹; këta dy të fundit të punësuar nga pushteti lokal. Në vendimin e saj të datës 28 janar 1981, Gjykata e Lartë në mënyrë unanime vendosi në favor të Pushtetit Lokal; më tej, më 8 shtator 1983, ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Lartë për Danimarkën Lindore.

Pasi mësoi lidhur me vendimin, kërkuesi shkroi një artikull, i cili u botua në revistën e quajtur “Grønland Dansk” në gusht 1982. Në artikull ai shprehte mendimin e tij se dy gjyqtarët porotë përjashtoheshin në bazë të nenit 62 të Kushtetutës daneze. Sipas Nenit 62, administrimi i drejtësisë duhej të mbetej i ndarë nga ekzekutivi dhe rregullat në lidhje me këtë duhej të përcaktoheshin me ligj. Ai gjithashtu vuri në pikëpyetje aftësinë dhe fuqinë e tyre për të vendosur në mënyrë të paanshme në një rast të ngritur kundër punëdhënësit të tyre. Gjyqtari profesionist i Gjykatës së Lartë konsideroi se vërejtjet ndaj dy gjyqtarëve porotë ishin të një lloji që mund të dëmtonin reputacionin e tyre në sytë e publikut dhe për rrjedhojë të dëmtonin në përgjithësi besimin në sistemin juridik. Si kreu i gjyqësorit Grenlandë, ai rrjedhimisht i kërkoi shefit të Policisë së Grenlandës, për nisjen e një hetimi penal.

Kërkuesi u akuzua për shpifje dhe ndaj tij u vendos një gjobë brej 2,000 korona daneze (269 euro).

¹²⁹ Një person që vepron si “gjyqtar” ose ndihmon një gjyqtar në një proces gjyqësor (sidomos në juridiksione që nuk kanë praktikën e jurive në gjyq)

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi parashtrroi se dënimi i tij për shpifje përbënte shkelje të lirisë së shprehjes garantuar nga neni 10 i Konventës.

Neni 10

Në shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit, Gjykata vërejti se nuk është kontestuar që dënimi i kërkuesit për shpifje, dhe gjoba e vendosur ndaj tij, përbënin një ndërhyrje nga autoriteti publik mbi të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Gjithashtu, nga Gjykata u pranua se ndërhyrja ishte e parashikuar në ligj dhe se niqte një qëllimin legjitim, të parashikuar në nenin 10 § 2 të Konventës, të mbrojtjes së dinjitetit të të tjerëve, dhe në mënyrë indirekte, garantimin e autoritetit të pushtetit gjyqësor. Prandaj, çështja e vetme që ngrihet është nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura, dhe nëse ishte në proporcion me qëllimin e synuar.

Gjykata vërejti se proporcionaliteti për qëllimet e këtij rasti ishte i nevojshëm që ndjekja e qëllimit për mbrojtjen e dinjitetit të të tjerëve dhe garantimi i autoritetit të gjyqësorit, duhet të peshoheshin kundrejt vlerës së diskutimit të hapur për tema të interesit publik. Gjykata vërejti se balancimi ishte i domosdoshëm dhe i një rëndësie të madhe për mos dekurajimin e anëtarëve të publikut, nga frika e sanksioneve penale ose sanksioneve të tjera, në shprehjen e mendimeve të tyre mbi çështjet me interes publik.

Në lidhje me artikullin e kontestuar, Gjykata vërejti se kishte dy elemente: së pari, një kritikë e përbërjes së Gjykatës së Lartë në çështjen e taksave të 1981 dhe, së dyti, deklarata se dy gjyqtarët porotë “bënë detyrën e tyre” d.m.th. ngrihej pyetja nëse ata ishin të pavarur dhe të paanshëm. Gjykata vërejti se kjo çështje mbi paanshmërinë dhe pavarësinë e dy gjyqtarëve porotë çonte në bindjen për shpifje. Baza e vendimit të Gjykatës së Lartë të Grenlandës ishte konstatimi se “fjalët e artikullit që vërtetonin se dy ... gjyqtarët porotë bënë detyrën e tyre - pikërisht detyrën e tyre si punonjës të pushtetit lokal për të vendosur në favor të tij - të përbënin një akuzë serioze, e cila kishte gjasa për të ulur vlerësimin publik ndaj tyre”.

Duke pasur parasysh këtë, dhe faktin se nuk ishin paraqitur prova për të mbështetur pretendimin e tij, gjykata ishte e kënaqur se ndërhyrja në lirinë e tij të shprehjes nuk ka pasur për qëllim kufizimin e të drejtave të tij në bazë të Konventës për të kritikuar publikisht përbërjen e Gjykatës së Lartë në çështjen e taksave të 1981. Nga ana tjetër, e drejta e tij për të shprehur mendimin për këtë çështje është bërë e ditur shprehimisht nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të 3 korrikut 1984, në të cilën Gjykata vërejti se kërkuesi nuk është kufizuar për shkak të dënimit. Gjykata

gjithashtu vuri në dukje se përbërja e Gjykatës së Lartë mund të vihej në pikëpyetje edhe, pa sulmuar personalisht dy gjyqtarët porotë. Konstatimi i Gjykatës së Lartë se nuk kishte prova për akuzat kundër gjyqtarëve porotë mbetet i pakundërshtueshëm dhe për këtë arsye, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesi (i akuzuar në çështjen e taksave të 1981), në përputhje me rrethanat e rastit, i ka bazuar akuzat e tij ndaj gjyqtarëve porotë në punësimin e tyre nga qeveria lokale. Gjykata pranoi se edhe pse ky fakt mund të çojë në ndryshim të opinionit, nëse përbërja e gjykatës ishte e duhura, ajo sigurisht nuk përbënte provë për anshmëri në rastin në fjalë.

Interesi ligjor i shtetit, në mbrojtjen e dinjitetit të dy gjyqtarëve porotë nuk binte ndesh me interesin e kërkuesit për të qenë në gjendje për të marrë pjesë në debatin e lirë publik mbi çështjen e paanshmërisë strukturore të Gjykatës së Lartë. Deklarata e ngritur nuk ishte një kritikë e arsyetimit në vendimin e 28 janarit 1981, por kjo një akuzë shpifëse kundër gjyqtarëve porotë personalisht, e cila kishte mundësi të ulte vlerësimin publik ndaj tyre dhe ishte paraqitur pa ndonjë provë mbështetëse. Gjykata konkludoi se duke përjashtuar kontekstin politik në të cilin u zhvillua çështja për taksat, me kujdes të veçantë duhej parë çështja e proporcionalitetit.

Si rrjedhim, Gjykata konkludoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Nuk ka shkelje të së drejtës për tu shprehur lirisht, kur interesi për mbrojtjen e dinjitetit të një gjyqtari dhe garantimi i autoritetit të gjyqësorit prevalojnë ndaj interesave të një gazetari

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN PRAGER DHE OBERSCHLICK k. AUSTRISË

(Kërkesa nr. 15974/90)

26 prill 1995

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Z. Prager dhe Z. Oberschlick ishin gazetarë të cilët jetonin në Vjenë, Austri. Z. Oberschlick ishte botuesi i forumit periodik.

Më 15 mars 1987, Forumi botoi një artikull të Z. Prager i titulluar “Rrezik! Gjyqtarë të rreptë!”, ku kritikoheshin gjyqtarët e gjykatave penale austriake. Si burime mbështetëse për artikullin e tij, përveç përvojës së fituar në një sërë gjyqesh, kishte marrë dhe deklarata nga avokatë dhe korrespondentë të ligjit dhe sondazheve të kryera nga hulumtuesit në universitete. Në artikull ai e përshkruante në detaje qëndrimin e nëntë anëtarëve të Gjykatës Rajonale Penale të Vjenës, duke përfshirë edhe qëndrimin e gjyqtarit J.

Z. Prager shkruante në këtë artikull se gjyqtarët vjenez “e trajtonin çdo të akuzuar nsi të ishte fajtor”, dhe se disa gjyqtarë ishin “të aftë për çdo gjë”. Ai gjithashtu i atribuoi gjyqtarit J. si “arrogant” dhe “bullist” për qëndrimin që kishte në kryerjen e detyrave të tij. Për pasojë, kërkuesi i akuzonte personat në fjalë për shkelje të ligjit, si gjyqtarë, ose më së paku për shkelje të detyrimeve të tyre profesionale.

Më 23 prill 1987, gjyqtari J. ngriti padi kundër Z. Prager për shpifje dhe kërkoi dëmshpërblim nga botuesi dhe një urdhër që përcaktonte gjobën e këtij të fundit bashkërisht dhe individualisht me autorin dhe u akordoi atyre pagimin e shpenzimeve ligjore. Më 11 tetor 1988, Gjykata Rajonale dënoi Z. Prager me një gjobë prej 120 ditësh në masën prej 30 shilingash (ATS) (2.20 euro) në ditë dhe gjashtëdhjetë ditë burg në rast mospagimi.

Z. Oberschlick u detyrua ti paguajë gjyqtarit J. dëmin prej 30,000 ATS (2,180 euro) dhe u shpall bashkëfajtor me kërkuesin e parë dhe përgjegjës individualisht në lidhje me kostot dhe gjobat ligjore. Gjykata në vendimin e saj vendosi po ashtu konfiskimin e artikujve të mbetur të çështjes në fjalë të Forumit dhe ekstraktet e botuara. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit të Vjenës më 26 qershor 1989, por dëmet u reduktuan në masën prej 20,000 ATS (1,453 euro).

Kërkuesit pretenduan se dënimi dhe masat e tjera të akorduara ndaj tyre përbënin shkelje të së drejtës së tyre për tu shprehur lirisht të garantuar në nenin 10 të Konventës.

Neni 10

Gjykata vuri në dukje se nuk ishte në diskutim se dënimi i Z. Prager për shpifje dhe masat e tjera për të cilat u ankuan kërkuesit përbënin një “ndërhyrje” me ushtrimin e lirisë së shprehjes. Megjithatë, kjo “ndërhyrje”, duhet të jetë “e parashikuar me ligj”, në ndjekje të një qëllimi të ligjshëm të përcaktuar në nenin 10 § 2 të Konventës, dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Gjykata pranoi se në të vërtetë ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj (neni 111 i Kodit Penal dhe nenit 29 të Ligjit për Mediat) dhe ndiqte një qëllim legjitim të mbrojtjes së dinjitetit të të tjerëve (gjqqtarit J. në rastin konkret) dhe se garantonte autoritetin e gjyqësorit, të dyja të legjitimuara sipas parashikimeve të nenit 10 § 2 të Konventës.

Nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata përsëriti se shtypi luan një rol thelbësor në një shtet që udhëhiqet nga shteti i së drejtës. Është detyra e tij për të dhënë informacion dhe ide mbi çështjet politike dhe çështje të tjera me interes publik. Gjykata vërejt se kjo përfshin pyetje në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë, një institucion thelbësor për një shoqëri demokratike. Megjithatë, Gjykata përsëriti se duhet ti kushtohet vëmendje rolit të veçantë të gjyqësorit në shoqëri. Si garantues i drejtësisë, ai duhet të gëzojë besimin e publikut në se kryen me sukses detyrat e tij. Për rrjedhojë, mund të jetë e nevojshme për ruajtjen e besimit kundër kritikave destruktive që në thelb janë të pabazuara.

Sipas Gjykatës, akuzat në artikullin e kontestuar, ishin aq serioze sa dëmtonin dinjitetin e gjyqtarëve vjeneze, duke përfshirë gjyqtarin J, por ata gjithashtu dobësonin besimin e publikut në integritetin e gjyqësorit në tërësi. Gjithashtu, Gjykata vërejt se vendimet e brendshme kundër kërkuesve nuk ishin drejtuar kundër ushtrimit të lirisë së shprehjes së kërkuesit në lidhje me sistemin e drejtësisë, apo dhe për faktin se ai kishte kritikuar gjyqtarë të caktuar të cilët i kishte identifikuar me emra, ku ndaj tyre ishin drejtuar akuza të tepruara, të cilat, në mungesë të një baze të mjaftueshme faktike, ishin dukshëm paragjyquese. Për më tepër, Gjykata, deklaroi se Z. Prager nuk mund justifikohet për shkak të mirëbesimit apo respektimit të etikës gazetareske ndonëse studimi që kishte ndërmarrë nuk mjaftonte për të provuar akuzat e tij.

Gjykata vërejtë se pavarësisht faktit se neni 10 zbatohet për “informacione” dhe “ide” që shokojnë apo shqetësojnë, ndërhyrja e kontestuar nuk ishte në proporcion me ndjekjen e qëllimit legjitim. Kështu, Gjykata arriti në përfundimin se masa e marrë është “e domosdoshme në një shoqëri demokratike” e për rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 10.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN DE HAES DHE GIJSELS k. BELGJIKËS

(Kërkesa nr. 19983/92)

24 shkurt 1997

1. Faktet Kryesore

Këruesi, Z. Leo De Haes dhe Z. Hugo Gijssels, jetonte në Antwerp, Belgjikë, dhe ka punuar si redaktor dhe gazetar, për revistën javore “Humo”.

Më 26 qershor, 17 korrik, 18 shtator dhe 6 dhe 27 nëntor 1986, kërkuesit botuan pesë artikuj në të cilat kritikonin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Antwerp-it në terma të ashpra për një gjykim për divorc ku kujdestaria për fëmijët u vendos në favor të babait, Z. X, një noter belg. Kjo u vendos pavarësisht faktit se në vitin 1984, gruaja e noterit dhe vjerri dhe vjerra e tij kishin paraqitur një akuzë penale ku akuzonin atë për incest dhe për abuzim me fëmijët.

Më 17 shkurt 1987, tre gjyqtarë dhe një avokat i Përgjithshëm i Gjykatës të Apelit të Antwerp, Znj. [YA], Z. [YB], Z. [KV] dhe Z. [YD], nisën procese kundër Z. De Haes dhe Z. Gijssels dhe kundër kryeredaktorit, botuesit, përfaqësuesit ligjor, stampuesit dhe shpërndarësit të revistës “Humo” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Brukselit. Ata kërkuan kompensim për dëmin e shkaktuar nga deklaratat e bëra në artikujt respektivë, duke pretenduar se ato ishin shpifje të tepruara.

Më 29 shtator 1988, Gjykata e Shkallës së Parë urdhëroi Z. De Haes dhe Z. Gijssels ti paguajnë secilit paditës një frangë në lidhje me dëmin jomaterial dhe të botojnë vendimin e plotë në revistën Humo; ajo gjithashtu ju dha lejën paditësve që të botonin vendimin me shpenzimet e të paditurve në gjashtë gazeta të përditshme. Së fundmi, ajo shpalli të papranueshme padinë për sa kohë që drejtohej kundër të pandehurve të tjerë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit të Brukselit më 5 shkurt 1990 dhe pas një rekursi në Gjykatën e Kasacionit u rrëzua më 13 shtator 1991.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Brukselit dhe Gjykatës së Apelit kundër tyre ishte një shkelje e të drejtës së tyre për lirinë e shprehjes në bazë të nenit 10 të Konventës.

Gjykata vërejtë se nuk është kontestuar se vendimi kundër kërkuesve përbënte një “ndërhyrje” në ushtrimin e lirisë së shprehjes. Gjithashtu u pranua se ajo ishte “parashikuar me ligj” dhe ka ndjekur të paktën një qëllim legjitim të përmendur në nenin 10 § 2 të Konventës, d.m.th. mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve. Megjithatë, në mënyrë që të justifikohet si një ndërhyrje e ligjshme për qëllimet e Konventës, ajo duhet të jetë “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për arritjen e qëllimit.

Në këtë kontekst, Gjykata përsëriti se shtypi luan një rol thelbësor në një shoqëri demokratike. Edhe pse ai nuk duhet të kalojë disa kufij, në veçanti për sa i përket dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve, gjithsesi detyra e tij është të kujtojë - në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e tij - informacione dhe ide mbi të gjitha çështjet me interes publik, duke përfshirë ato që lidhen për funksionimin e gjyqësorit. Gjykatat, nga ana e tyre, si garantues të drejtësisë, roli i së cilës është thelbësor në një shtet të bazuar në shtetin e së drejtës - duhet të gëzojnë besimin e publikut. Ata duhet që në përputhje me rrethanat të jenë të mbrojtura nga kritikata destruktive.

Më tej Gjykata vuri në dukje se artikujt përmbanin informacion tepër të detajuar në lidhje me rrethanat në të cilat ishin marrë vendimet për kujdestarinë e fëmijëve të Z. X. Ky informacion ishte bazuar në hulumtimin e plotë të akuzave të ngritura kundër Z. X, dhe në opinionet e disa ekspertëve, të cilët ju ishin dhënë si këshillë kërkuesve për të kontribuar në interesin më të lartë të fëmijëve. Për rrjedhojë, Gjykata u shpreh, se kërkuesit nuk mund të akuzoheshin se kishin dështuar në detyrën e tyre profesionale.

Gjykata përsëriti se është detyrë e shtypit për të dhënë informacione dhe ide me interes publik. Jo vetëm shtypi ka për detyrë dhënien e “informacioneve” dhe “ideve” të tilla, por edhe publiku ka të drejtën t’i marrë ato. Në këtë rast, Gjykata theksoi se, artikujt ishin veçanërisht të rëndësishëm duke pasur parasysh se akuzat në fjalë ngrinin shqetësime si për fatin e fëmijëve të vegjël ashtu dhe për funksionimin e sistemit të drejtësisë në Antwerp.

Gjithashtu, Gjykata përsëriti se është e domosdoshme që të bëhet një dallim midis fakteve dhe vlerave të vendimeve, sepse ekzistenca e fakteve mund të demonstronhet, ndërsa e vërteta e vlerave të vendimit nuk është një provë e prekshme. Për më tepër, liria e shprehjes aplikohet gjithashtu edhe për “informacione” ose “ide” që dëmtojnë ose shqetësojnë, dhe ku liria gazetareske përfshin edhe përdorimin e ekzagjerimit apo edhe provokimin, deri në një farë shkalle.

Në një përmbledhje të akuzave në fjalë, Gjykata vërejt se, e vërteta e përkufizimit nuk është një dëshmi e prekshme. Megjithatë, një opinion i tillë mund të jetë i tepruar, veçanërisht në mungesë të ndonjë baze faktike, por në këtë rast nuk ishte dhe aq i pabazuar. Më pas Gjykata bëri një dallim mes rastit në fjalë nga Prager dhe *Oberschick kundër Austrisë*¹³⁰. Gjykata shprehu se edhe pse komentet ishin jashtëzakonisht kritike, ato ishin në përpjesëtim me seriozitetin e përmbajtjes së artikujve. Për më tepër, Gjykata deklaroi se neni 10 mbron edhe thelbin e ideve dhe informacionit, dhe gjithashtu formën në të cilën ato përcillen.

Në këtë mënyrë, Gjykata u shpreh se, pavarësisht seriozitetit të rrethanave të çështjes dhe të rastit në fjalë, nuk është provuar nevoja e ndërhyrjes në ushtrimin e lirisë së shprehjes të kërkuesve, përveç aludimit për të kaluarën e babait të një prej gjyqtarëve në fjalë. Gjykata e mbështeti arsyetimin e saj duke konkluduar se një dënim ishte i arsyeshëm për shkak të këtij dyshimi, sepse është e papranueshme që dikush të jetë i ekspozuar ndaj kritikave për shkak të çështjeve që lidhen me një anëtar të familjes së tij. Megjithatë, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të ndryshuar përfundimin e rastit. Pra, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10.

Neni 6

Kërkuesit u ankuan edhe për shkelje të nenit 6. Ata argumentuan se gjykatat vendase kishin refuzuar pranimin si provë të dokumenteve të përmendura në artikujt e kontestuar apo dëgjimin dëshmitarëve të tyre, duke rezultuar në këtë mënyrë, në një pabarazi të armëve ndërmjet kërkuesit dhe gjyqtarëve dhe Avokatit të Përgjithshëm. Më tej, në argumentat kundër Z. De Haes dhe Z. Gijssels në bazë të artikullit të tyre të datës 14 tetor 1988, Gjykata e Apelit të Brukselit ishte shprehur se gjyqtarët e kritikuar në këtë artikull nuk ishin palë në rastin para Gjykatës së Apelit. Ata gjithashtu argumentuan se termat poshtëruese të përdorura në Gjykatën e Apelit të Brukselit tregonin se ka pasur një mungesë të paanshmërisë subjektive.

Gjykata u shpreh se refuzimi plotë i kërkesës së kërkuesit përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Brukselit dhe Gjykatës së Apelit për të studiuar opinionin e tre profesorëve, hulumtimet e të cilave kishin nxitur kërkuesit të shkruanin artikujt e tyre duke i vënë gazetarët në disavantazh të konsiderueshëm vis-à-vis me paditësit. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të parimit të barazisë së armëve.

Gjykata konstatoi se ky zbulim i vetëm përbënte shkelje të nenit 6 dhe për rrjedhojë e pa të panevojshme shqyrtimin e kërkesave të tjera të ngritura nga kërkuesit sipas kësaj dispozite.

¹³⁰ Kjo çështje është gjithashtu pjesë e kësaj përmbledhjeje.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 113,101 franga belge (2,804 euro) në lidhje me dëmin material dhe 851,697 franga belge (21,113 euro) në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

Nuk ka pasur shkelje të nenit 10 kur dënimi për shpifje i një avokati ishte i nevojshëm për të mbrojtur dinjitetin e të tjerëve dhe garantimin e autoritetit të pushtetit gjyqësor

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN PERUZZI k. ITALISË

(Kërkesa nr. 39294/09)

30 qershor 2015

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Piero Antonio Peruzzi, ka lindur në 1946 dhe jeton në Sant'Angelo In Campo, Itali. Në kohën e ngjarjeve ai ishte avokat.

Në shtator të vitit 2001 Z. Peruzzi i shkroi Këshillit të Lartë të Gjyqësorit duke u ankuar për sjelljen e gjyqtarit X të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Luccas. Më pas ai u dërgoi një "letër qarkulluese" disa prej gjyqtarëve të së njëjtës gjykatë, duke kopjuar përmbajtjen e letrës, por pa iu referuar me emër X. Pjesa e parë e letrës përmbante detajet e vendimeve të dhëna nga gjyqtari në fjalë në kontekstin e procesit të trashëgimisë, ndërsa në pjesën e dytë trajtohej fakti që kërkuesi i konsideronte të papranueshme sjelljet nga ana e gjyqtarëve, ku midis të tjerash fliste për "gabime të kryera me dashje ose me dashakeqësi apo për shkak të neglizhencës ose mosangazhimit".

Gjyqtari X parashtroi një ankesë kundër Z. Peruzzi, për veprën penale të shpifjes. Më tej, Z. Peruzzi u akuzua për fyerje, pasi gjyqtari X kishte marrë edhe një kopje të letrës në qarkullim. Në një vendim të datës 3 shkurt 2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Genoas e dënoi Z. Peruzzi me katër muaj burg për veprën penale të shpifjes dhe fyerjes. Gjykata konsideroi se Z. Peruzzi i kishte tejkaluar kufijtë e të drejtës së tij për të kritikuar, duke pretenduar se X kishte kryer gabime "me dashje"; kjo përbënte një fyerje të rëndë të nderit të gjyqtarit në fjalë.

Z. Peruzzi e ankimoi çështjen dhe në një vendim të 12 marsit të 2007, Gjykata e Apelit të Genoas arsyetoi se, në mungesë të një akuze, nuk mund të fillojë ndjekja për veprën penale të fyerjes. Dënimi me burg i dhënë ndaj kërkuesit në shkallë të parë, u zëvendësua nga një gjobë prej 400 euro. Gjithashtu, kërkuesi u urdhërua të paguante shumën prej 15,000 euro për dëmin jomaterial ndaj gjyqtarit X. Në nëntor të vitit 2008 Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë një ankesë në paragrafët e ligjit për çështjen individuale të paraqitur nga Z. Peruzzi.

Vendimi i Gjykatës

Duke ju referuar nenit 10 të Konventës, kërkuesi ankohej se dënimi i tij për shpifje shkelte të drejtën e tij për lirinë e shprehjes.

Palët nuk kanë pasur mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën e një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit sipas nenit 10. Megjithatë, një ndërhyrje, në mënyrë që të përmbushë qëllimet e Konventës, duhet të jetë “e parashikuar me ligj”, duhet të jetë në ndjekje të një qëllimi legjitim dhe duhet të jetë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Gjykata vuri në dukje se diskutimi nuk qëndronte nëse ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj. Më tej, ajo pranoi se ndërhyrja kishte për qëllim “mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve” dhe garantimin e “autoritetit dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor”.

Në vendimin e saj nëse ndërhyrja mund të konsiderohej se ka qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata vërejtë se ajo nuk mund të pranonte argumentin e kërkuesit se kritikën e përfshira në letrën qarkulluese nuk drejtohej kundër gjyqtarit X, por më tepër kundër sistemit gjyqësor italian në përgjithësi. Prandaj, Gjykata u shpreh se ajo duhej të konstatonte nëse ankesat në lidhje me gjyqtarin X ishin brenda kufijve të kritikës lejueshme në një shoqëri demokratike. Gjykata gjithashtu deklaroi se ajo duhej të shqyrtonte nëse arsyet parashtruara për ndërhyrjen ishin “të rëndësishme dhe të mjaftueshme”, dhe nëse dënimi i dhënë ishte “proporcional” me qëllimin e synuar.

Sipas Gjykatës, kritika e parë ndaj gjyqtarit nga Z. Peruzzi, lidhur me faktin se ai kishte marrë vendime të padrejta dhe arbitrare, nuk përbënte kritikë të tepruar për sa kohë që vërejtjet përbënin gjykime me vlerë - e vërteta e të cilave, sipas praktikës së mëparshme të Gjykatës, nuk prekej nga faktet - pasi kishte një bazë faktike, duke pasur parasysh se kërkuesi kishte përfaqësuar një nga palët në procesin e trashëgimisë në rastin në fjalë.

Megjithatë, Gjykata vërejtë se kritika e dytë, cila kishte pasur si qëllim shprehjen e “njëanshmërisë” së gjyqtarit dhe se kishte kryer gabime “me dashje ... me dashakeqësi ose neglizhencës së madhe ose mungesës së angazhimit”, linte të kuptohej se gjyqtari X kishte nënvlerësuar detyrat e tij etike si gjyqtar apo kishte kryer edhe një vepër penale. Z. Peruzzi nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar një element të dashakeqësisë për vendimet të cilat ai u ankuar. Për më tepër, ai kishte shpërndarë kudo letrën pa prituri rezultatin e rastit që kishte paraqitur kundër gjyqtarit X para Këshillit të Lartë të Gjyqësorit.

Gjykata mbajti parasysh faktin se kërkuesi ishte avokat dhe se faktet e çështjes në fjalë lidheshin me veprimet e ndërmarra në cilësinë e tij si avokat. Gjykata riafirmoi nga jurisprudenca se avokatët kanë të drejtë për tu shprehur në lidhje me funksionimin e gjyqësorit, por për këtë ka dhe kufij në atë që mund të shprehen. Megjithatë, ai gjithashtu vuri në dukje se gjyqtari X ishte një gjyqtar i një shkalle

të ulët dhe se kufijtë e asaj që konsiderohet si kritikë e pranueshme mund të konsiderohen se janë më të gjera në rastin e një gjyqtari se sa të një qytetari të zakonshëm. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se kritikën e Z. Peruzzi nuk ishin bërë gjatë seancës gjyqësore ose në rrjedhën e procesit mbi trashëgiminë, dhe se letra ishte dërguar ndaj Gjyqtarit X dhe shumë gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Luccas në një kontekst që nuk lidhet në ndonjë pikë të procesit; ajo ka pasur për qëllim të dëmtojë dinjitetin dhe imazhin profesional të Gjyqtari X. I njëjti fakt vihet re dhe në çështjen *Nikula k. Finlandës*¹³¹. Si përfundim, Gjykata vërejti se dënimi me burg i vendosur fillimisht ndaj Z. Peruzzi ishte zëvendësuar në apel nga një gjobë e vogël prej 400 euro. Në mënyrë të ngjashme, masa e shpërblimit të drejtë dhënë për gjyqtarin X prej 15,000 eurosh, nuk mund të konsiderohet si e ekzagjëruar.

Gjykata, arriti në përfundimin se dënimi i Z. Peruzzi për shënimet shpifëse të bëra në letrën e tij të shpërndarë kudo, dhe dënimi i caktuar ndaj tij, nuk ishin në proporcion me ndjekjen e qëllimit legjitim dhe se arsyet e dhëna nga gjykatat italiane ishin “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” për të justifikuar marrjen e këtyre masave. Ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes të Z. Peruzzi, në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohet “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për të mbrojtur dinjitetin e të tjerëve dhe për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor në kuptim të nenit 10 (2). Për rrjedhojë, nuk ka pasur asnjë shkelje të kësaj dispozite.

131 Kjo çështje është pjesë e kësaj përmbledhje vendimesh.

Agjencia e Inteligjencës Serbe duhet të garantojë akses në informacionin që merret përmes vëzhgimit elektronik për të mbrojtur lirinë e shprehjes së një OJF-je

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS¹³²

k. SERBIË

(Kërkesa nr. 48135/06)

25 qershor 2013

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi është një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2003, me seli në Beograd. Ajo monitoron zbatimin e ligjeve tranzitore me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetin e së drejtës.

Më 31 tetor 2005 kërkuesi i ka kërkuar Agjencisë së Inteligjencës së Serbisë për të marrë informacion lidhur me faktin se sa njerëz i ishin nënshtruar vëzhgimit elektronik nga kjo agjenci në vitin 2005. Më 4 nëntor 2005, agjencia e refuzoi kërkesën, duke u mbështetur argumentin e saj në seksionin 9 § 5 të Ligjit për të Drejtën e Informimit të 2004.

Më 17 nëntor 2005, kërkuesi u ankua tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit, një organ i brendshëm i ngritur në kuadër të Ligjit për të Drejtën e Informimit të vitit 2004 për të siguruar respektimin e këtij ligji.

Më 22 dhjetor 2005, Komisioneri konstatoi se agjencia e inteligjencës kishte shkelur ligjin dhe urdhëroi që informacioni i kërkuar ti vihej në dispozicion kërkuesit brenda tri ditëve. Agjencia e ankimoi kërkesën, por më 19 prill 2006, Gjykata e Lartë e Serbisë u shpreh se nuk ishte e bazuar dhe hodhi poshtë ankimin e saj.

Më 23 shtator 2008, agjencia e inteligjencës njoftoi kërkuesin se ajo nuk e kishte ruajtur informacionin e kërkuar nga ana e organizatës.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua, se në bazë të nenit 10 të Konventës, Agjencia e Inteligjencës së Serbisë u kishte mohuar aksesin për informacionin e kërkuar në lidhje me vëzhgimet elektronike, pavarësisht vendimit përfundimtar dhe detyrues të Komisionerit të së Drejtës për Informim në favor të saj.

¹³² Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata vuri në dukje se refuzimi për dhënien e informacionit të kërkuar ndaj kërkuarit, i cili ishte i përfshirë dukshëm në mbledhjen e ligjshme të informacionit me interes publik me qëllim dhënien e këtij informacioni për publikun dhe duke kontribuar në debatin publik, përbënte një ndërhyrje në të drejtën për tu shprehur lirish.

Ndërsa ushtrimi i lirisë së shprehjes mund të jetë subjekt i kufizimeve, në mënyrë të tillë që këto kufizime të jenë në përputhje me ligjin. Megjithatë, Gjykata vërejti se kufizimet e vendosura nga agjencia e inteligjencës në rastin në fjalë nuk e plotësonin këtë kriter. Organi i brendshëm i ngritur pikërisht për të garantuar respektimin e Ligjit për të Drejtën për Informim të vitit 2004, kishte marrë rastin në shqyrtim dhe kishte vendosur për dhënien e informacionit për kërkuarin. Ishte e vërtetë se si përfundim agjencia e inteligjencës ishte përgjigjur se nuk e kishte ruajtur këtë informacion, por përgjigja nuk ishte bindëse në funksion të natyrës së këtij informacioni (numri i njerëzve që i ishin nënshtruar vëzhgimit elektronik nga kjo agjenci në vitin 2005) dhe reagimit fillestar i agjencisë.

Gjykata arriti në përfundimin se ngurrimi i pabzuar i agjencisë së inteligjencës të Serbisë në përputhje me urdhrin e Komisionerit të së Drejtës për Informim ishte në kundërshtim me të drejtën e brendshme dhe e barazvlefshme me arbitraritet.

Neni 6

Duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme shqyrtimi të njëjtës kërkesë sipas nenit 6.

Neni 46

Ajo nuk ishte në çmim të Gjykatës për të përcaktuar se çfarë masa korigjuese mund të jenë të përshtatshme pas një vendimi. Megjithatë, shkelja në rastin konkret, për shkak të natyrës së saj, nuk ka lënë asnjë zgjedhje të vërtetë për marrjen e masave të nevojshme për korigjimin e saj. Prandaj, mënyra më e natyrshme për të zbatuar vendimin e saj në këtë rast do të ishte dhënia e informacionit të kërkuar nga OJF prej agjencisë lidhur me faktin se në vitin 2005 njerëzit i ishin nënshtruar vëzhgimit elektronik.

Neni 41

Gjykata konsideroi se konstatimi i shkeljes dhe urdhri i dhënë në bazë të nenit 46, përbënin në vetvetë shpërblim të drejtë dhe të mjaftueshëm për çdo dëm jomaterial që mund ti jetë shkaktuar kërkuarit.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN KOPRIVICA k. MALIT TË ZI

(Kërkesa nr. 41158/09)

22 nëntor 2011

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Veseljko Koprivica, është shtetas malazez, i cili ka lindur në vitin 1948 dhe jeton në Podgoricë. Ai ishte kryeredaktori i një reviste javore opozitare në Malin e Zi e quajtur “Liberal”.

Më 24 shtator 1994, “Liberal” botoi një artikull me titull “16”, i cili ishte shkruar nga korrespondenti i saj i veçantë në Hagë. Artikulli raportonte se shumë gazetarë, 16 prej të cilëve erdhën nga Mali i Zi, do të përpiqeshin të nxitnin luftën nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY). Dy zyrtarët e ICTY u identifikuan si ata që kishin përgatitur dosjen dhe një listë të 16 gazetarëve të Malit të Zi.

Në tetor 1994, një nga 16 gazetarët, një kryeredaktor në një media të madhe shtetërore, inicioi një proces civil të brendshëm kundër kërkuesit, duke pretenduar se artikulli ka dëmtuar dinjitetin e tij dhe për rrjedhojë ka kërkuar kompensim.

Në maj të vitit 2002, ICTY e informoi Gjykatën e Shkallës së Parë në Podgoricë se nuk kishte asnjë lloj informacioni në lidhje me gazetarin, i cili inicioi procesin lidhur me artikullin e Z. Koprivica.

Z. Koprivica dëshmoi në gjykatë se ai e kishte mbështetur artikullin e tij në informacionin e ofruar nga korrespondenti special i revistës në Hagë. Duke komentuar deklaratën e ICTY-së, ai tha se nuk ishte i interesuar në përmbajtjen e letres së ICTY apo nëse gazetari në fjalë ishte në këtë listë, pasi ai kishte parë personalisht punën e atij gazetari në të kaluarën.

Në maj të vitit 2004, gjykata e shkallës së parë vendosi pjesërisht në favor të gazetarit. Ajo urdhëroi Z. Koprivica që së bashku me themeluesit e “Liberal”, të kompensojnë gazetarin në shumën prej 5.000 euro. Gjykata arriti në përfundimin se konstatimi i bërë në botim ka qenë i pavërtetë dhe se Z. Koprivica nuk kishte ivestiguar mbi vërtetësinë e saj. Në nëntor të vitit 2009, gjykata qartësoi se Z. Koprivica duhet të paguante dëmet përmes kësteve të rregullta, ku secila prej tyre arrinte në shumën e gjysmës së pensionit të tij. Me 14 tetor 2011, shumata e mbetur pa paguar nga Z. Koprivica ishte 853 euro.

2. Vendimi i Gjykatës

Z. Koprivica në bazë të nenit 10 ankohej se, e drejta e tij për lirinë e shprehjes ishte shkelur si pasojë e dënimit të dhënë ndaj tij për pagimin e dëmeve në botimin e artikullit të 1994.

Neni 10

Pranueshmëria

Gjykata konstatoi se, në kundërshtim me kërkesën e Qeverisë së Malit të Zi, Z. Koprivica nuk ishte i detyruar të kërkonte dëmshpërblim në Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi. Edhe pse në tetor të vitit 2007 ka qenë mundësia për një ankese kushtetuese, ankesat të cilat ishin paraqitur para kësaj gjykate ishin refuzuar vazhdimisht ose hedhur poshtë. Në mënyrë të veçantë, deri më 31 korrik 2009, datë në të cilën Z. Koprivica paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë, ankimi kushtetues nuk ishte lejuar ndonjëherë. As ndonjë vendim i dhënë nuk është vënë në dispozicion të publikut. Si rrjedhojë, kërkesa e Z. Koprivica ishte e pranueshme pasi ai i kishte shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike në dispozicion.

Themeli

Gjykata vuri në dukje se vendimi përfundimtar gjyqësor civil pa dyshim që ka ndërhyrë në të drejtën e Z. Koprivica ndaj lirisë së shprehjes. Ndërhyrja ka qenë në përputhje me ligjin dhe kishte ndjekur qëllimin legjitim për mbrojtjen e dinjitetit të të tjerëve, siç parashikohet nga Neni 10.

Më tej, Gjykata shqyrtoi nëse vendimet e gjykatave të brendshme ka qenë “të nevojshme në një shoqëri demokratike”. Ajo vuri në dukje se artikulli i revistës në fjalë qartazi mund të provohej përmes kërimit. Informacioni i publikuar për bënte një akuzë të rëndë kundër gazetarit, i cili u zmadhua akoma më tepër për shkak të ndjeshmërisë së çështjes në Ballkan në atë periudhë. Rrjedhimisht, kryeredaktori duhej të kishte qenë veçanërisht i kujdesshëm në lidhje me verifikimin e informacionit para botimit.

Z. Koprivica ishte mbrojtur me pretendimin se ai nuk mund të verifikonte informacionin e dhënë se në atë kohë nuk kishte pasur interneti apo kontakte zyrtare ndërmjet Republikës Federale të Jugosllavisë dhe ICTY. Gjykata konsideroi se këto arsye nuk mund të justifikojnë atë që as nuk ishte përpjekur të përdorte mjete të tjera për tu lidhur me ICTY dhe as të kishte bërë kontroll të dyfishtë mbi vërtetësinë e informacionit që vetë ai e ka publikuar në fund të fundit. Në fakt, Gjykata pranoi se lajmi ishte një produkt i përkohshëm dhe vonimi i botimit të

tij rrezikonte humbjen e vlerës dhe interesit ndaj tij. Megjithatë, artikulli në fjalë ishte botuar në një revistë javore, jo në një gazetë të përditshme, kështu që Z. Koprivica kishte pasur mundësinë për të verifikuar informacionin e tij. Përveç kësaj, ai kishte deklaruar haptazi para botimit se nuk shqetësohej për verifikimin e së vërtetës ose besueshmërinë e informacionit.

Gjykata konstatoi se Z. Koprivica kishte dështuar në verifikimin e informacionit, botimi i të cilit u paraqitet si një fakt. Në të njëjtën kohë, gjykatat malazeze kanë refuzuar të dëgjojnë dëshmitarët e propozuar nga Z. Koprivica, veçanërisht korrespondentin special të revistës i cili në fakt kishte shkruar artikullin.

Në secilin rast, Gjykata arriti në përfundimin se ajo nuk kishte nevojë për të mbante një qëndrim të ashpër në të dhënat se dëmet që duhej të paguante Z. Koprivica ishin joproportionale, veçanërisht krahasuar kjo me pensionin e tij. Ndërsa Qeveria e Malit të Zi kishte argumentuar se pensioni i tij nuk ishte e ardhura e tij të vetme, por ata nuk kishin paraqitur prova për të mbështetur pretendimet e tyre. Përveç kësaj, edhe kur bëhet krahasimi me të ardhurat më të larta në Malin e Zi, dëmet dhe shpenzimet për të cilat Z. Koprivica kishte qenë i detyruar ti paguante, sërisht kanë qenë të tepruara. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 10.

Neni 41

Gjykata u shpreh se nuk ishte ende gati për të dhënë një vendim në lidhje me nenin 41 të Konventës.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ŠABANOVIĆ k. MALIT TË ZI

(Kërkesa nr. 5995/06)

31 maj 2011

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Zoran Šabanović, është shtetas malazes dhe jeton në Herceg Novi.

Më 6 shkurt 2003, një gazetë e përditshme malazeze botoi një artikull duke pretenduar se uji në zonën e Herceg Novit ishte “plot me baktere”, bazuar në një raport i cili ishte hartuar me kërkesën e Inspektorit të Ujit të Shtetit. Z. Šabanović, drejtor i kompanisë publike të ujësjellësit dhe anëtar i partisë politike opozitare në atë kohë, mbajti menjëherë një konferencë për shtyp në të cilën mohoi akuzat, duke thënë se të gjitha rubinetat e ujit ishin të filtruara dhe të sigurta për konsum publik. Ai theksoi më tej se inspektori i ujit favorizonte dy kompani private të ujit, duke u përpjekur në zbulimin e burimeve shtesë të ujit dhe se ai ishte nën urdhërat e Partisë Social-Demokrate, partneri kryesor në koalicionin qeverisës të kohës.

Si rezultat i kësaj, inspektori për ujërat nisi procesin për shpifje kundër Z. Šabanović dhe më 4 shtator 2003 ai u shpall fajtor për deklarata të pavërteta dhe të dëmshme ndaj nderit dhe dinjitetit të inspektorit. Ai u dënua me tre muaj burgim me kusht. Gjykatat vendase nuk pranuan kërkesën e Z. Šabanović për të lexuar artikullin e gazetës në të cilin ishin ngritur akuzat për ndotjen e ujit të pijshëm pasi konsideroi se kjo nuk ishte e rëndësishme dhe se një hap i tillë do të vononte procesin. Ky vendim u la në fuqi në apel në nëntor 2005.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 10, Z. Šabanović ankohej në lidhje me dënimin e tij për shpifje për shkak të deklaratave që ai kishte bërë në konferencën për shtyp në shkurt të 2003.

Neni 10

Duke pasur parasysh se procesi penal kundër Z. Šabanović ishte kryer plotësisht nga gjykatat malazeze, Gjykata vendosi të refuzojë një pjesë të kërkesës së tij në lidhje me Serbinë.

Ndërhyrja në lirinë e shprehjes të Z. Šabanović, në bazë të Kodit Penal të Republikës së Malit të Zi, ka qenë “e parashikuar me ligj” dhe ka ndjekur një “qëllim legjitim” në mbrojtje të dinjitetit të të tjerëve.

Megjithatë, ishte mjaft e kuptueshme se Z. Šabanović, si drejtor i kompanisë së ujësjellësit publik, kishte ndër të tjerë se ishte detyra e tij t’i përgjigjej akuzave në shtyp se uji i pijshëm në zonën e Herceg Novit është i kontaminuar, me qëllim informimin e publikut se uji i pijshëm ishte i filtruar dhe i sigurt për t’u përdorur. Vërejtjet e tij ishin një sqarim i rëndësishëm për një çështje me interes të madh publik dhe nuk ishin një sulm i panevojshëm ndaj jetës private të inspektorit të ujit, por kritikë ndaj tij i drejtoreshin në cilësinë e zyrtarit. Në fakt, gjykatat kanë pasur një qasje tepër të kufizuar për këtë çështje, duke mos arritur të bënin vërejtje në një kuadër më të gjerë të debatit të përgjithshëm në shtyp lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm në atë zonë.

Gjykata u shpreh se ka pasur pak hapësirë për kufizime të tilla në debatet me interes publik dhe për këtë arsye ka vendosur se ndërhyrja në lirinë e shprehjes të Z. Šabanović nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe po ashtu në shkelje të nenit 10.

Më tej, Gjykata theksoi me shqetësim faktin se Z. Šabanović i ishte dhënë një dënim me burg për shpifje, një sanksion i cili edhe pse nuk ishte zbatuar, duhet të shfuqizohej në bazë të rekomandimeve të Këshillit të Evropës.

Neni 41

Gjykata hodhi poshtë pretendimin e Z. Šabanović për shpërblim të drejtë në bazë të nenit 41 pasi kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit përfundimtar.

VENDIMI NË ÇËSHTJEN LEPOJIĆ K. SERBISË

(Kërkesa nr. 13909/05)

6 nëntor 2007

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Zoran Lepojić, shtetas serb i cili ka lindur në 1975 dhe jeton në Babušnica, Serbi. Ai ishte kryetar i degës lokale të Partisë Demo-Kristiane në Serbi.

Rasti kishte të bënte me dënimin e kërkuesit përveprën penale të shpifjes në artikullin e tij në lidhje me Kryetarin e Bashkisë së Babušnica, shkruar në prag të zgjedhjeve të vitit 2002.

Në gusht të vitit 2002, artikulli i kërkuesit, me titullin “Kryebashkiaku Despotik”, u shpërnda në buletin “Narodne novine lužnicke”. Në artikullin e tij, Z. Lepojić fillimisht argumentonte se Z. P.J. nuk mund të jetë më Kryetari i Bashkisë së Babušnic-s për shkak se ai ishte dëbuar nga partia e tij politike dhe për rrjedhojë, me ligj nuk mund të vazhdonte të qëndronte më në këtë post. Këtë opinion ai e bazonte në informacionin e marrë nga Ministria e Drejtësisë dhe Vetëqeverisjes Lokale. Së dyti, në bazë të informacionit të dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë Publike të Republikës së Serbisë, Z. Lepojić akuzonte kryebashkiakun për kryerjen e “shkeljeve ligjore që arrijnë deri në krime”, duke deklaruar se kundër tij ishin ngritur akuza penale dhe se ai kishte abuzuar me autoritetin e tij si Drejtor i Kompanisë Shtetërore, Lisca. Së fundi, kërkuesi e kritikonte atë duke e quajtur “thujse të çmendur” (sumanuto) duke shpenzuar paratë e bashkisë për sponsorizime dhe dreka solemne.

Në përgjigje të artikullit të botuar, kryebashkiaku paraqiti një kërkesë penale kundër kërkuesit i cili, më 11 qershor 2003, u shpall fajtor për veprën penale të shpifjes, duke ju referuar deklaratave të tij “thujse i çmendur” për sponsorizimet dhe drekat solemne me fondet e bashkisë. Atij iu akordua një gjobë prej 15.000 dinarësh dhe ju akordua vlera për pagimin e 11,000 dinarëve për shpenzimet, e cila ishte në atë kohë ishte afërsisht e barabartë me 400 euro. Gjykata arsyetoi se kërkuesi nuk kishte provuar vërtetësinë e deklaratës në fjalë, apo të kishte arsye për të besuar se kjo ishte e vërtetë. Termi “thujse i çmendur”, gjithashtu linte të kuptohej se kryetari i bashkisë kishte aftësi të kufizuara mendore. Vendimi u la në fuqi në apel.

Më 8 shkurt 2005, kryebashkiaku paraqiti një ankesë të veçantë civile për dëmet që i ishin shkaktuar, duke pretenduar se ndaj tij ishte shkaktuar ankth mendor si

pasojë e botimit të atij artikulli. Më 18 mars 2005, kërkuesi u urdhërua të paguajë 120,000 dinarë për shpërblim të drejtë plus interesin dhe shpenzimet ligjore në masën prej 39,000 dinarë, e cila ishte ekuivalente me rreth 1,970 euro. Gjykata në fjalë arsyetoi se nderi i kryetarit ishte më i rëndësishëm se sa ai i një individi të zakonshëm. Në apel, vlera për shpenzimet u reduktua në masën e 24,200 dinarë, shumë e barabartë me rreth 295 euro.

2. Vendimi i Gjykatës

Z. Lepojić ankohej për vendimin penal dhe civil kundër tij lidhur me nenin 10 dhe me nenin 6 § 1 të Konventës.

Neni 10

Gjykata vuri në dukje se vendimet përfundimtare penale dhe civile për rastin në fjalë padyshim që përbën një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes, të cilat ishin “të parashikuara me ligj” dhe të pranuar në ndjekje të një qëllimi legjitim, përkatësisht “për mbrojtjen e dinjitetit” të një tjetri.

Për sa i përket faktit nëse dënimi penal dhe kompensimi i dhënë ishin në përpjesëtim me të ndjekjen e qëllimit legjitim, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi e kishte shkruar artikullin në fjalë në prag të zgjedhjeve dhe në cilësinë e tij si një politikan. Në qendër të kritikave të kërkuesit ishte kryetari i bashkisë, një figurë publike, dhe fjala “thuaje i çmendur” natyrisht që nuk është përdorur për të përshkruar gjendjen mendore të kryetarit të bashkisë, por më tepër për të shpjeguar mënyrën sesi ai dyshohej të kishte shpenzuar paratë e taksapaguesve vendorë. Edhe pse kërkuesi nuk ishte në gjendje të provonte para gjykatave të brendshme se pretendimet e tjera të tij ishin të vërteta, edhe nëse prezumohej se të gjitha deklaratat ishin të vërteta dhe në këtë mënyrë të pranuar si prova, ai qartazi kishte disa arsye për të besuar se kryetari i bashkisë mund të jetë përfshirë në aktivitete kriminale dhe, po ashtu, se mandati i tij ishte i paligjshëm. Në çdo rast, edhe pse artikulli i kërkuesit përmbante gjuhë të fortë, ai ishte i fokusuar në çështjet e interesit publik dhe nuk ishte një sulm i panevojshëm personal që i drejtohej jetës private të kryetarit të bashkisë. Arsyetimet e vendimeve të gjykatave penale dhe civile kundër kërkuesit, nuk kanë qenë “të mjaftueshme”, duke pasur parasysh shumën e kompensimit dhe shpenzimeve të dhëna (ekuivalente me rreth tetë paga mesatare mujore në Serbi në atë kohë) si dhe gjoha me kusht të cilat në rrethana të caktuara, mund të ishin konvertuar në burgim.

Duke pasur parasysh masën e dënimit penal, si dhe arsyetimin e dyshimtë të gjykatave të brendshme, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 10.

Gjykata konsideroi se nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi më vete i kërkesës së kërkuarit lidhur me faktin se ai nuk kishte pasur një proces të rregullt gjyqësor.

Neni 41

Gjykata i akordoi Z. Lepojić 3,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 250 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

Dënimi për veprën penale të mohimit të krimeve të gjenocidit të kryera ndaj popullit Armen në vitin 1915 ishte i pajustificuar

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN PERIŇÇEK k. ZVICRËS
(Kërkesa nr. 27510/08)
15 tetor 2015

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Doğu Perinçek, është shtetas turk, i cili ka lindur në 1942 dhe jeton në Ankara, Turqi.

Si një ekspert ligjor dhe të Kryetar i Partisë së Punës Turke, ai mori pjesë në një sërë konferencash të ndryshme në Zvicër në vitin 2005, gjatë të cilit mohoi publikisht se Perandoria Osmane kishte kryer krimin e gjenocidit kundër popullit Armen në vitin 1915 dhe vitet në vijim. Ai e përshkroi idenë e gjenocidit armen si një “gënjeshtër ndërkombëtare”. Më 15 korrik 2005, Shoqata “Zviceriono-Armene” ngrit një padi penale kundër tij.

Më 9 mars 2007, Policia Gjyqësore e Lausanës e shpalli fajtor Z. Perinçek për diskriminim racor brenda kuptimit të nenit 261bis, paragrafi 4 i Kodit Penal Zviceran, duke arsyetuar se motivet e tij kishin tendence raciste dhe nuk kontribuonin në kuadër të debateve historike. Ai detyrua të paguante për 90 ditë një gjobë prej 100 frangash zvicerane secila (përafërsisht 93 euro), një gjobë prej 3000 frangash zvicerane (përafërsisht 2,794 euro), të cilat mund të zëvendësoheshin me 30 ditë burg, dhe 1,000 franga zvicerane (përafërsisht 931 euro) për kompensimin e Shoqatës Zviceriano-Armene për dëmin jomaterial.

Z. Perinçek e apeloj vendimin, i cili u hodh poshtë nga Nga Dhoma Penale e Gjykatës së Kasacionit të Kantonit Vaud. Sipas vlerësimit të gjykatës, gjenocidi armen, ashtu dhe gjenocidi hebre, ishte një fakt historik i provuar. Për rrjedhojë, Gjykatat nuk kanë arsye që ti referohen punës së historianëve për të pranuar ekzistencën e tij. Gjykata Federale hodhi poshtë një apel tjetër të ngritur nga Z. Perinçek në vendimin e 12 dhjetorit 2007.

2. Vendimi i Gjykatës

Më 12 nëntor 2013 Dhoma e Gjykatës konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Më 2 qershor 2014, Dhoma e Madhe pranoi kërkesën e qeverisë për referimin e çështjes asaj.

Kërkuesi, duke u mbështetur në nenin 10 - e drejta e lirisë së shprehjes, u ankua

se Gjykatat Zvicerane i kishin shkelur të drejtën për tu shprehur lirisht. Ai argumentoi se neni 261 bis, paragrafi 4, i Kodit Penal Zviceran nuk parashikonte mjaftueshëmrisht pasojat e tij, dhe se dënimi i tij nuk ishte i justifikuar për ndjekjen e qëllimit legjitim dhe se shkelja e pretenduar mbi lirinë e shprehjes nuk ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Neni 10

Gjykata deklaroi se nuk ishte detyra e saj për të përcaktuar nëse mohimi i krimeve të gjenocidit është i justifikuar, apo edhe për të përcaktuar nëse gjenocidi kishte ndodhur vërtet. Gjykata pohoi se roli i saj ishte vetëm shqyrtimi nëse zbatimi i nenit 261 bis § 4 të Kodit Penal Zviceran në rastin e kërkuarit ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”. Për këtë qëllim, Gjykata vërejti se nga të dy palët është pranuar se dënimi dhe ndëshkimi i Z. Perinçek përbënin një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së tij lidhur me lirinë e shprehjes në bazë të nenit 10. Megjithatë, për të qenë një ndërhyrje e justifikuar në bazë të Konventës, ndërhyrja gjithashtu duhet të jetë “e parashikuar me ligj”, të jetë në ndjekje të një qëllimi legjitim sipas nenit 10 § 2 dhe duhet të jetë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Dhoma e Madhe konstatoi se ndërhyrja në të drejtën e Z. Perinçek ndaj lirisë së shprehjes ka qenë parashikuar me ligj në kuptim të nenit 10 § 2. Gjykata konstatoi në mënyrë të veçantë se - pavarësisht nga parashtrimet e tij për të kundërtën - kërkuari ka mundur të parashikojë në mënyrë të arsyeshme se deklaratat e tij mund të rezultojnë në ngarkimin me përgjegjësi penale sipas ligjit zviceran.

Në lidhje me pyetjen nëse ndërhyrja kishte ndjekur një qëllim legjitim, Dhoma e Madhe konstatoi se ndërhyrja nuk mund të konsiderohet si e justifikuar nga dëshira për të parandaluar rrëmujat. Megjithatë, ndërhyrja mund të konsiderohet si e destinuar “për mbrojtjen e... të drejtave të të tjerëve” brenda kuptimit të nenit 10 § 2. Ai vuri në dukje se shumë nga pasardhësit e viktimave të ngjarjeve të 1915 dhe vitet në vijim, e ndërtuan identitetin e tyre rreth perceptimit se komuniteti i tyre kishte qenë viktimë e gjenocidit. Gjykata duke pranuar se ndërhyrja në të drejtat e Z. Perinçek kishte qenë me qëllim mbrojtjen e atij identiteti dhe për rrjedhojë dinjitetin e armenëve në ditët e sotme.

Lidhur me pyetjen nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” brenda kuptimit të nenit 10 § 2, Gjykata deklaroi se ajo do të shqyrtonte nëse neni 261bis § 4 i Kodit Penal zviceran gjente zbatim në rastin e Z. Perinçek dhe nëse ishte në përputhje me nenin 10. Gjykata vërejti se në dritën e jurisprudencës së saj, dinjiteti i armenëve ishte i mbrojtur në bazë të nenit 8 të Konventës. Në këtë mënyrë, Gjykata u përball me nevojën për gjetjen e një ekuilibri midis dy

të drejtave të Konventës, duke marrë parasysh rrethanat specifike të rastit dhe proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.

Gjykata shqyrtoi natyrën e deklaratave të kërkuesit. Ajo vuri në dukje se ai nuk kishte shprehur përbuzje apo urrejtje për viktimat e ngjarjeve të vitit 1915 dhe vitet në vijim. Ai nuk i kishte quajtur gënjeshhtarë armenët, apo të kishte përdorur terma abuzive në lidhje me ta, ose të ketë tentuar të stereotipizojë ata. Akuzat e tij të ashpra drejtoheshein kundër “imperializmit” dhe planeneve gjasme të fshehta në lidhje me Perandorinë Osmane dhe Turqinë.

Gjykata vuri në dukje faktet e këtij rasti duke ju referuar jurisprudencës së mëparshme për rastin e Holokaustit, dhe u shpreh se në këtë linjë nuk ka nevojë për të prezumuar se deklaratat e Z. Perinçek në lidhje me ngjarjet e vitit 1915 nxisinin një frymë raciste dhe antidemokratike. Në fakt, Gjykata konstatoi se duke lexuar tërësinë e deklaratave, ato nuk mund të shihen si një thirrje për urrejtje, dhune apo intolerance. Gjykata vendosi gjithashtu se deklaratat e tij gëzonin mbrojtjen sipas nenit 10, duke u bazuar në kontekstin në të cilën janë bërë (në ngjarje publike për njerëz që ndjanë të njëjtin mendim) çka tregonte se ai foli si politikan, dhe jo si një historian apo studiues i ligjit dhe në lidhje me një çështje të interesit publik.

Gjithashtu Gjykata vërejti se, ndryshe nga rastet që kishte trajtuar në lidhje me Holokaustin, ajo nuk kishte argumentuar se ka pasur një lidhje të drejtpërdrejtë mes Zvicrës dhe ngjarjeve që ndodhën në Perandorinë Osmane në 1915 dhe vitet në vijim. Për më tepër, nuk kishte asnjë provë që në kohën kur Z. Perinçek kishte bërë deklaratat e tij, situata në Zvicër ka qenë e tensionuar dhe mund të përfundonte në fërkime serioze mes turqve dhe armenëve atje.

Megjithatë, Gjykata konkludoi se ndërsa ai ishte i vetëdijshëm mbi rëndësinë që i jepej komunitetit armen lidhur me çështjen nëse ngjarjet tragjike të vitit 1915 dhe vitet në vijim do të konsideroheshin si gjenocid, Gjykata nuk mund të pranonte se deklaratat e Z. Perinçek kishin lënduar në këtë mënyrë dinjitetin e armenëve sa të kërkonin ndërmarrjen e masave ligjorsanksioneve penale në Zvicër. Ajo gjithashtu vuri në dukje se deklaratat e tij nuk thonë se armenët meritonin tu nënshtroheshin mizorive dhe po kaq ka kaluar një kohë shumë e gjatë nga ngjarjet respektive, çka nuk për bën një efekt aq shqetësues, atribuar ndaj tyre. Gjykata gjithashtu ripohoi se dënimi penal ishte një nga format më të rënda të ndërhyrjes në të drejtën e lirisë së shprehjes.

Gjykata konkludoi se “në një shoqëri demokratike”, nuk është e nevojshme, që Z. Perinçek ti nënshtrohet një dënimi penal me qëllim mbrojtjen e të drejtave të Komunitetit Armen. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Gjykata vlerësoi se konstatimi i shkeljes së nenit 10 përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë dhe të mjaftueshëm për çdo lloj dëmi jomaterial të shkaktuar nga Z. Perinçek. Me tej Gjykata hodhi poshtë njëzëri pjesën tjetër të pretendimit të tij për shpërblim të drejtë.

Arrestimi i fotoreporterit dhe dënimi për mosbindje ndaj policisë në kohën e mbulimit pa leje të një demonstrimi, ishte proporcional

**VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN PENTIKÄINEN
k. FINLANDËS
(Kërkesa nr. 11882/10)
20 tetor 2015**

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi, Z. Pentikäinen, ka lindur në 1980 dhe jeton në Helsinki. Ai është fotograf dhe gazetar i punësuar nga revista javore Suomen Kuvalehti.

Më 9 shtator 2006, kërkuesi u dërgua nga punëdhënësi i tij për të bërë fotografi në një protestë kundër takimit Azi-Evropë (ASEM) në Helsinki. Pas përshkallëzimit të dhunës, policia rrethoi zonën ku po kryhej demonstrata dhe urdhëroi shpërndarjen e turmës. Pas një bisede me punëdhënësin e tij, kërkuesi vendosi se ishte e nevojshme që ai të ishte brenda rrethimit të bërë nga policia së bashku me një numër të vogël demonstruesish. Ai u arrestua së bashku me ta dhe u mbajt në paraburgim nga ora 09:30 pasdite deri në lirimin e tij të nesërmen në orën 03:00 pasdite.

Në dhjetor 2007, kërkuesi u dënua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Helsinkit për mosbindje ndaj policisë. Si Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e vitit 2009. Nuk u vendos gjobë për shkak se shkelja ishte e lehtë, për shkak të dyzimit që kërkuesi kishte pasur mes bindjes së urdhrit të ploidisë apo punëdhënësit të tij.

2. Vendimi i Gjykatës

Në vendimin e Dhomës të datës 4 shkurt 2014, Gjykata e vendosi se gjykatat vendase kishin gjetur një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese në rrezik dhe, dhe për rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 10. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi që rasti ti referohej Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43, u pranua.

Kërkuesi ankohej se i ishte shkelur e drejta në bazë të nenit 10 me ndalimin, arrestimin dhe dënimin e tij, e cila konsistonte në një “dekurajim” mbi të drejtat dhe punën e tij.

Neni 10

Gjykata pranoi se ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit lidhur me lirinë

e shprehjes. Ndërhyrja bazohej në ligjin finlandez dhe ndiqte qëllime legjitime, përkatësisht mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit.

Lidhur me vlerësimin nëse trajtimi i kërkuesit ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”, Gjykata vërejti se policia finlandeze, veçanërisht me përvojën e tyre të mëparshme të trazirave që kishin ndodhur në të njëjtin vit, kishte arsye dhe pritshmëri të forta se protesta mund të devijonte në dhunë. Në këtë mënyrë, urdhrat e policisë për shpërndarjen e turmës ishin të bazuara në vlerësime të arsyeshme të fakteve. Për më tepër, kërkuesi nuk ishte penguar në raportimin e ngjarjes. Ai kishte pasur mundësi të bënte fotografi gjatë gjithë demonstratës deri në momentin e ndalimit.

Kërkuesi u kap në zonën e rrethuar, ku ai kishte qëndruar me demonstruesit e mbetur. Gjykata vuri në dukje, nga video-regjistrimet e disponueshme, se kërkuesi nuk kishte veshur apo vendosur ndonjë simbol apo shenjë dalluese që ta identifikonte atë si gazetar apo njeri të shtypit. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk kishte bërë të qartë faktin se ai ishte gazetar para se të ndalohej.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Helsinkit konstatoi se kërkuesi kishte qenë në dijeni të urdhrave të policisë për t’u larguar nga vendi i ngjarjes, por vendosi të mos i zbatojë ato ato. Ndër të tjera kërkuesi telefonoi punëdhënësin e tij për të diskutuar nëse ai duhej të largohej nga zona. Duke mos iu bindur urdhrave të dhëna nga policia, kërkuesi rrezoikoi me vetëdije, duke u arrestuar. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje një fakt tjetër të rëndësishëm, se të gjithë gazetarët e tjerë në këtë fazë u larguan nga vendi i ngjarjes. Asgjë nuk do ta kishte penguar kërkuesin që ti bindëj urdhërit, dhe të mund të vazhdonte ushtrimin e detyrës së tij profesionale në afërsi të zonës së rrethimit.

Për sa i përket ndalimit të tij, Gjykata vërejti se kërkuesi ka qenë një nga të parët që është ndaluar për t’u marrë në pyetje dhe është liruar për shkak të statusit të tij si gazetar. Edhe pse kërkuesit ju morën aparati dhe materialet fotografike gjatë kohës së mbajtjes së tij në arrest, ato iu kthyen të gjitha dhe të paprekura.

Për sa i përket dënimit të tij, Gjykata vërejti mungesën e dënimit të vendosur ndaj kërkuesit. Gjykata theksoi se sjellja për të cilën ai u dënua nuk ishte për shkak të funksionit të tij si gazetar, por refuzimi për tu larguar nga zona pas urdhërit të policisë. Për më tepër, çdo ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së tij gazetareske ishte e një shkalle të kufizuar, duke pasur parasysh mundësitë e vëna në dispozicion të tij për mbulimin e ngjarjeve në mënyrën e duhur.

Prokuroria akuzoi 86 të pandehur. Gjykata përsëriti se gazetarët nuk mund të përjashtohen për shkak të detyrës së tyre për t’ju bindur urdhrat ligjor vetëm mbi

bazën se neni 10 parashikon mbrojtje të lirisë së shprehjes. Gjykata pranoi se gazetarët shpesh përballen me një konflikt mes detyrës së përgjithshme të respektimit të ligjit penal dhe detyrës së tyre profesionale për të marrë dhe shpërndarë informacion. Megjithatë, ai theksoi se koncepti i gazetarisë së përgjegjshme kërkon që kur një gazetar bën zgjedhjen që mos ju bindur urdhrit ligjor, ai ose ajo duhet të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e të qenit subjekt i sanksioneve ligjore. Duke pasur parasysh në veçanti mungesën e pasojave materiale negative të kërkuarit, Gjykata vlerësoi se praktikisht dënimi i tij ishte në proporcion me qëllimet legjitime të ndjekura.

Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendase i kanë bazuar vendimet e tyre mbi arsye të rëndësishme dhe të mjaftueshme dhe kanë gjetur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese në fjalë. Kërkuari nuk ishte penguar në kryerjen e punës së tij si gazetar gjatë ose pas demonstratës. Për rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 10.

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN SELMANI DHE TË TJERËT K. ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË¹³³

(Kërkesa nr. 67259/14)

9 shkurt 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, Naser Selmani, Toni Angelovski, Biljana Dameska, Frosina Fakova, Snežana Lupevska, dhe Nataša Stojanovska, ishin gjashtë shtetas maqedonas, të cilët jetonin në Shkup dhe punonin si gazetarë të akredituar.

Më 24 dhjetor 2012, kërkuesit ishin duke raportuar nga selia e Parlamentit, zona e caktuar për gazetarët e autorizuar për të raportuar mbi punën e Parlamentit. Ata ishin duke ndjekur debatin për miratimin e buxhetit të shtetit për vitin 2013, i cili kishte qenë një burim tensioni mes deputetëve të opozitës dhe partisë në pushtet dhe kishte tërhequr vëmendje të madhe të publikut dhe medias.

Gjatë punimeve, deputetët e opozitës iu afruan Kryetarin e Parlamentit dhe filluan të godisnin tryezën e tij. Më pas, oficerët e sigurisë nxorrën me forcë deputetët e opozitës dhe larguan dhe gazetarët nga selia. Disa gazetarë e respektuan urdhrin, por kërkuesit, duke besuar se publiku ka të drejtë të jetë i informuar, nuk pranuan të largohen. Kjo rezultoi në largimin e tyre me forcë. Në të njëjtën kohë dy grupe kundërshtarë njerëzish po protestonin para ndërtesës së Parlamentit.

Kërkuesit parashtruan një kërkesë kushtetuese duke pretenduar se e drejta e tyre për lirinë e shprehjes në bazë të nenit 10 të Konventës ishin shkelur pasi ata u ndaluan të raportonin mbi një temë që i përkiste interesit publik. Ata gjithashtu i kërkuan Gjykatës Kushtetuese që të mbajë një seancë publike për rastin e tyre.

Në prill të vitit 2014, seanca u mbajt në mungesë të palëve, ku Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesat e kërkuesve. Ajo konstatoi se largimi nga selia kishte qenë i nevojshëm për arsye sigurie, dhe kjo nuk i drejtohej kufizimit të lirisë së shprehjes të tyre.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit, duke u mbështetur në nenin 10 dhe nenin 6 të Konventës, u ankuan

¹³³ Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara nga neni 44 § 2 i Konventës.

për largimin e tyre nga selia e Parlamentit dhe për mungesën e një seance publike në procesin vijues në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 6

Kërkuesit u ankuan se mosmbajtja e një seance publike nga Gjykata Kushtetuese përbënte shkelje të nenit 6 të Konventës.

Së pari, Gjykata rikonfirmoi se në proceset para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, siç ishte rasti konkret, e drejta për një “seancë publike” nënkupton të drejtën për një “seancë verbale” sipas nenit 6 § 1 të Konventës, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.

Më pas Gjykata vërejt se çështja në fjalë - nëse largimi me dhunë i kërkuesve nga selia e Parlamentit kishte shkelur të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes - përbënte më shumë se thjesht një çështje ligjore, siç është argumentuar nga qeveria. Nga ana tjetër, çështja e proporcionalitetit të masës së kontestuar mbështetej në rrethanat e rastit, të cilat Gjykatës Kushtetuese i ishte kërkuar ti verifikonte. Faktet e kontestuara përfshinin edhe arsyt nëse kërkuesve ju ishte shpjeguar arsyeja e largimit; niveli i forcës së përdorur nga punonjësit e sigurisë; nëse një punonjës i sigurimit ishte plagosur gjatë incidentit; rreziku i sigurisë që pretendohet se duhej kërkuar largimi i tyre; dhe nëse kërkuesit ishin në gjendje të ndiqnin zhvillimet në dhomën parlamentare pas largimit të tyre. Gjykata deklaroi se, e drejta e kërkuesve për një seancë dëgjimore, prevalonte ndaj argumenteve të Qeverisë.

Për më tepër, Gjykata vërejt se, Gjykata Kushtetuese nuk kishte dhënë ndonjë arsye se pse e konsideroi të panevojshme mbajtjen e një seance të tillë.

Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur rrethana të jashtëzakonshme që mund të justifikojnë mosmbajtjen e një seance dëgjimore, dhe në përputhje me rrethanat, ajo konstatoi se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 10

Mes palëve nuk ishte kontestuar se largimi i kërkuesve nga selia e Parlamentit ku ata ishin duke raportuar procesin parlamentar dhe incidentet pasuese në dhomën e tij përbënin një “ndërhyrje” në të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes në bazë të nenit 10 § 1 të Konventës.

Duke shkuar më tej nëse masa t e marra ishin “të parashikuara me ligj”, Gjykata rikonfirmoi se në këtë rast kërkohej të dihej nëse masa që ishte marrë ka pasur një bazë ligjore në të drejtën e brendshme, dhe se parashikonte shtrirjen e efekteve të

saj ndaj personit në fjalë. Këtu, Gjykata vërejtë se masa bazohej në nenin 43 të Ligjit Parlamentar dhe nenet 91-94 të rregullave të procedurës parlamentare. Sipas opinionit të Gjykatës, largimi i gazetarëve nga punonjësit e sigurisë nga selia, nuk ka qenë një kërkesë e paarsyeshme, arbitrare apo e paparashikueshme sipas këtyre dispozitave. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se masa ishte “parashikuar me ligj”.

Më tej Gjykata pranoi se ndërhyrja ndiqte një qëllim legjitim në garantimin e sigurisë publike dhe mbrojtjen e rendit dhe kështu vijoi me shqyrtimin nëse ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Gjykata përsëriti rolin vendimtar të mediave si një “monitorues” i publikut në një shoqëri demokratike, dhe veçanërisht në situata të tilla si në rastin e kërkuësve, ku autoriteteve u duhej të stabilizonin sjelljen e pahijshme të deputetëve gjatë një seance parlamentare. Mediat, brenda kufijve të caktuar, ka për detyrë dhënien e informacioneve dhe ideve për të gjitha çështjet me interes publik, për shembull, mbrojtjen e rendit në dhomën parlamentare. Për më tepër, publiku ka të drejtë të marrë këtë informacion. Si rezultat i kësaj, çdo përpjekje për të penguar gazetarët në përmbushjen e misionit të tyre duhet të jenë subjekt i shqyrtimit të rreptë.

Gjykata pranoi se autoritetet vendase kanë për detyrë balancimin mes dy grupe të interesit, grupe të cilat i përkisnin sferës publike, përkatësisht interesat e shërbimit të sigurimit në ruajtjen e rendit në Parlament dhe në garantimin e sigurisë publike, dhe interesat e publikut në marrjen e informacionit mbi një çështje me interes të përgjithshëm publik. Në vlerësimin nëse ishte gjetur një ekuilibër i përshtatshëm midis këtyre dy interesave konkurruese, Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja e kontestuar, marrë si një e tërë, bazohej në arsye relevante dhe të mjaftueshme dhe ishte në proporcion me ndjekjen e qëllimit legjitim.

Në këtë aspekt, Gjykata vërejtë se lidhur me protestat jashtë ndërtesës së Parlamentit, Gjykata Kushtetuese nuk shkoi më tej deklaratave se “disa njerëz u plagosën” në to. Pas denoncimit të këtyre protestave Gjykata Kushtetuese nuk kishte ndjekur në baza faktike dhe se në çfarë mase, nëse kishte, ato kërcënonin sigurinë e tyre brenda ndërtesës, duke përfshirë dhe kërkuësit. Në lidhje me ngjarjet brenda dhomës parlamentare, nuk është kontestuar se kërkuësit nuk përbënin një kërcënim për sigurinë publike. Gjykata vërejtë se Gjykata Kushtetuese nuk ka dhënë asnjë vendim lidhur me pretendimin se një oficer i sigurisë ishte plagosur në grindje e sipër me një nga kërkuësit. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se largimi i kërkuësve nga selia nuk ishte si pasojë e refuzimit të tyre në përputhje me urdhërat e shërbimit të sigurisë të parlamentit apo rezistencën e tyre, por rezultat i vlerësimit të rrezikut të bërë nga i njëjti shërbim se prania e kërkuësve në seli përbënte një kërcënim për jetën dhe integritetin e tyre fizik. Megjithatë, Gjykata nuk gjeti asnjë tregues se sjellja e pamatur e deputetëve në parlament do të kishte vënë në rrezik jetën dhe integritetin fizik të kërkuësve. Së fundmi, Gjykata vuri

në dukje se largimi i tyre i pengoi ata në transmetimin direkt dhe marrjen dijoni drejtpërdrejt, bazuar kjo në përvojën e tyre personale nga ngjarjet që ishin duke u zhvilluar në parlament.

Gjykata arriti në përfundimin, se Qeveria kishte dështuar në faktin se largimi i kërkuarit nga selia ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” dhe në përmbushjen e kriterit të “nevojës së ngutshme sociale”. Prandaj, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi se Shteti duhet ti paguante kërkuarit shumën prej 5,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet gjyqësore, Gjykata vërejti se kërkuarit nuk kishin vërtetuar nëse shpenzimet për përfaqësimin kishin ardhur si pasojë e procedurave të brendshme ose procedurave para Gjykatës dhe për rrjedhojë nuk u akordoi asnjë dëmshpërblim.



Foreign &
Commonwealth
Office

Përgatitja e këtij botimi mbështet nga Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar dhe Komonuelthit. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë qëndrim zyrtar i Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar dhe Komonuelthit, por përgjegjësi e autorëve.



Regional Cooperation Council

Botimi i kësaj guide u mbështet nga Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë qëndrim zyrtar i Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal, por përgjegjësi e autorëve.

